

DITURIA ISLA ME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 405 • GUSHT 2024



FILOZOFIA E HIXHRETIT NË ISLAM
DREJT NJË VIZIONI TË RI

HUMANIZMI SI VIRTYT I
PËRSHPIRTSHËM I ISLAMIT

KRIZA E LEXIMIT DHE
"HEGJEMONIA" E TEKNOLOGJISË

Urimi i Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, me rastin e Vitet të Ri Hixhri 1446

*Të dashur vëllezër dhe motra
besimtarë!*

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçan-
të që në vigjilje të Hixhretit – Vitit
të Ri Hixhri, t'ju drejtohem me urimet
dhe përgëzimet më të thella e më të
sinqerta, duke e kujtuar Hixhretin si një
ndër ngjarjet më të rëndësishme në
historinë e botës myslimane, me të cilën
filloi njësimi i kalendarit hënor.

Hixhreti i Pejgamberit a.s. nga Meka
për në Medine, në vetvete është shprehje
e triumfit ndaj dhunës, urrejtjes e
mosdurimit, dhe në të njëjtën kohë
promovon lirinë, paqen, respektin dhe
mirëbesimin.

Kur kujtojmë Hixhretin, kujtojmë
Pejgamberin tonë, Muhamedin a.s., i
cili la vendlindjen e tij të bekuar –
Mekën, për të emigruar në Medine, me
qëllim që të realizonte misionin që qe
ngarkuar nga i Madhi Zot.

Me këtë veprim të të Dërguarit a.s., u
krijuan bazat themelore për përhapjen



e besimit, kulturës e të qytetërimit
islam, si dhe për themelimin e një
shoqërie të re, e cila do të jetonte e lirë,
në paqe e me mirëkuptim.

Edhe tani, kur njerëzimi po përballet
me luftë, konflikte, refugjatë e të zhve-
ndosur, mesazhet dhe mësimet e
Hixhretit duhen kuptuar drejt, në fun-
ksion të ndaljes së konflikteve, forcimit
të paqes, solidaritetit, dashurisë dhe
respektit të ndërsjellë.

Duke ju uruar e përgëzuar, lusim
Allahun xh.sh. që në këtë vit të ri hixhri
1446, të sjellë paqe, begati, mirësi për
mbarë njerëzimin, dhe të bëjë që të
mbretërojnë dashuria dhe toleranca në
zemrat tona.

Zoti na bekoftë të gjithëve!

Myftiu i Kosovës,

Naim ef. Tërnavë



EDITORIAL

- 4 Lëvrimi i cekët në tokën e pëlleshme të shkencave islame

FETARE

- 5 Mrekullia juridike e legjislacionit islam
Dr. Ejup Haziri
- 9 Specifikat e lingistikës së Kuranit
Prof. dr. Sulejman Topoljak
- 12 Filozofia e Hixhretit (shpërnguljes) në Islam drejt një vizioni të ri
Sufjan el Hatashenshir
- 16 Kënaqësia e adhurimeve në zemrën e besimtarit
Isa Tershani
- 19 Bashkëjetesa e Muhamedit a.s. me të tjerët
Hfz. Mehas Alija
- 24 Etika e pritjes së mysafirrit bazuar në mësimet islame
Mr. Vedat Shabani
- 27 Humanizmi si virtyt i përhspirtshëm i Islamit
Nada Dosti
- 30 "Tek ai do të më gjeje Mua..."
Bajram Zeqiri

FAMILJE & EDUKIM

- 33 Dashuria si rregullator i raporteve fëmijë-nënë
Merita Boroci
- 36 Konflikti në mes të gjeneratave dhe sfidat e edukimit të brezit të ri
Prof. ass. dr. Ferdi Kamberi



KULTURË

- 40 Kush i djeg librat?
Hajrudin S. Muja
- 45 Kriza e leximit dhe "hegjemonia" e teknologjisë
Imer Topanica



HISTORI CIVILIZIM

- 48 Dokumentet arabe në arkivat shqiptare (2)
Mr. Vehbi Shatri
- 52 Vështrim historik mbi ekonominë osmane në trevat shqiptare gjatë shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX
MA. Agon Krasniqi





AKTUALITET

- 56 Yjet e Evropianit, praktikues të Islamit
Kasim Gërbeshi

AKTIVITETE

- 60 Myftiu Tërnava priti në takim ministrin e Kulturës dhe Turizmit të Turqisë, z. Mehmet Nuri Ersoy i shoqëruar nga kryetari i DIJANET-it, dr. Ali ef. Erbashi



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore
Nr. 405 • viti 38 • Gusht 2024
• Muharrem 1446 - Sefer 1446
• çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
Mr. Muharrem Tërnava,
Mr. Vedat Shabani.
Sekretar & lektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net
Shtypi:
"IliriPrint", Prishtinë



“Kujt Allahu ia do të mirën, ia mundëson atij të kuptuarit e thellë të fesë së tij.”

(Buhariu: 71, Muslimi: 98)

Lëvrimi i cekët në tokën e pëlleshme të shkencave islame

Vizioni qytetëruës i Islamit që mëton të ofrohet në një botë të trazuar, duket një përgjegjësi tejet komplekse, mbase edhe një barrë e rëndë që apriori bie mbi supet e shkollarëve të dijeve e shkencave islame. Islami, duke qenë se është fe që ka shtrirje kulturore, civilizuese dhe historike, dhe rrjedhimisht opusi i tij shkencor është tejet i thellë e multidiciplinar, mbetet mëkat i pafalshëm gërvishtja formale mbi “koren” sipërfaqësore të disiplinave të tij. Studimi nxitimthi e mos gërmimi në thellësi për të hulumtuar në margaritarët e thesareve të tij, është privim i dhembshëm shkencor, por edhe varfëri intelektuale që pamundëson prezantimin e mozaikut të tij të përkryer.

Ne, brezi i sotshëm, bijtë e teknologjisë moderne, që rrugët e arritjes deri tek informacioni i kemi shkurtuar e përshpejtuar skajshmërisht, vuajmë nga “sindromi” i përtacisë së çuditshme për të thelluar leximet e gjurmimet tona në cilëndo fushë, s’do mend se në këtë rend edhe në ato fetare islame. Të ngazëllyer me shpejtësinë e arritjes deri të një përgjigje fetare, kemi filluar, me ose pa vetëdije, të braktisim atë trashëgimi të begatë të shkencave që na e lanë si amanet ajo plejadë e urtë e dijetarëve të hershëm, qofshin nga bota islame, apo edhe ata dijetarë të shquar të këtij nën qielli tonë. Ne s’po arrijmë as ta shfletojmë atë që ata e kanë shkruar, andaj as nga perlat e tyre, asgjë ne nuk po përfitojmë. Pos borxhit që ua kemi që t’ua ruajmë atë trashëgimi që e lanë për ne e te ne, jemi përgjegjës që thellësinë e tyre studimore si virtut e si vlerë, ta mbajmë të gjallë ndër ne, e ta bartim besnikërisht edhe te brezat në vijim.

I Dërguari i Allahut, Muhamedi a.s., i vinte pikat mbi shkronja kur rrëfente se shenjë e bekimit hyjnor ndaj njeriut është thellimi i tij në dijet islame. Ai në një hadith të njohur pat thënë: “Kujt Allahu ia do të mirën, ia mundëson atij të kuptuarit e thellë të fesë së tij”, (Buhariu, 71, Muslimi 98, etj.). E po s’është çudi, kjo fe nuk mund të prezantohet nga dikush tjetër, por vetëm nga ata që Allahu ua do të mirën, në këtë dhe në botën tjetër.

Ndryshe nga ç’mendohet, ky studim i thellë i përmendur në këtë kontekst, nuk duhet të ketë produkt final të vetin prezantimin e Islamit si një sistem kompleks, që do të duket e vështirë vënia e tij në praktikë. Në të vërtetë, ai do të duhej ta bënte të kundërtën. Ta thjeshtësonte e lehtësonte jetësimin e tij dhe ta masivizonte në shoqëri të kuptuarit e drejtë të tij.

Studimet konvencionale akademike islame nëpër institucionet e sotshme arsimore mbesin një standard e filtër solid, që në rrethana të mirëqena do të duhej të përgatisnin si më së miri, e pastaj edhe të filtronin kujdesshëm kuadrin predikues të tij. Si të tilla, ato edhe nuk do të duhej asnjëherë të lejonin që në emër të kësaj feje të flasë dikush që s’ka ndarë kohë për studime të thella në fushat e saj. Megjithatë, në mes të asaj që duhet bërë dhe asaj që nga këto institucione po bëhet e realizohet, lë vend tejet shumë për t’u dëshiruar.

Shumica dërmuese e pasuesve të Islamit, nuk gjejnë kohë që të thellohen e të studiojnë denjësisht fushat apo shkencat islame. Ata thjesht mjaftohen me pakon e informatave e diturive që iu ofrohen nga predikuesit fetarë, dhe bëjnë përpjekje që të njëjtat t’i vejnë në praktikë. E nëse atyre nuk ua kemi bartur në formë besnike platformën islame, e cila do të vinte si rezultat i studimeve tona të thella, ata praktikues nga naiviteti sigurisht se do ta gjymtonin e shpërfytyronin tejmasë atë.

Duhet ta kemi guximin e ta themi me keqardhje, atë që e kanë thënë shumë ideologë e mendimtarë myslimanë, se predikimet jo të denja që burojnë nga lexime të cekëta rreth fesë së Allahut, kanë ofruar para botës versionin e shpërfytyruar të një feje madhështore. Ato, jo rrallëherë kanë krijuar alibi për ata njerëz që për një kohë të gjatë mbanin njëren këmbë në truallin e Islamit e tjetren në truallin e ateizmit, që të tillët të stacionoheshin fatkeqësisht në truallin e brishtë të këtij të fundit.

Andaj, shtimi i etjes dhe zellit për dije e studime të thella e të mirëfillta islame, nuk është një luks e çështje zgjedhore, por mbetet detyrë mbi detyrat, që s’duhet ndarë mendjen asnjëherë prej saj.

Mr. Driton Arifi

Mrekullia juridike e legjislacionit islam

Dr. Ejup Haziri

HYRJE

Legjislacioni islam është nevojë dhe domosdoshmëri e jetës njerëzore, ngase përherë nevojitet rendi, siguria, drejtësia dhe barazia mes njerëzve, në mënyrë që njerëzimi të jetojë në harmoni, bashkëjetesë dhe paqe mes vete.

Njeriu sado që të arrijë në njohje dhe kuptim dhe sado që të jetë i privilegjuar, ai prapë mbetet në suaza të kufizimeve, ku për shumë gjëra nuk do të mund të mësojë e as të kuptojë dhe shumë gjëra do t'i mbesin atij enigma dhe asnjëherë s'do të jetë në gjendje t'i zbërthejë ato.

Përveç kësaj, ky njeri do të ballafaqohet me të mira dhe të këqija, me drejtësi dhe padrejtësi, qëllon dhe gabon, andaj shtrohet pyetja, një legjislacion prej një njeriu të tillë sa do të ishte efektiv?

Për këtë është e nevojshme për një legjislacion ndryshe, një legjislacion hyjnor, ku do të eliminohej mundësia e gabimit dhe neglizhencës, legjislacion që do të ishte gjithëpërfshirës dhe universal ndaj gjitha çështjeve të kësaj jete dhe asaj të përtejme, gjithëpërfshirës ndaj çdo segmenti të kësaj ekzistence dhe realist ndaj të gjitha çështjeve apo detyrimeve.

PËRKUFIZIMI I LEGJISLACIONIT

Fjala sher'un-شعر (prej së cilës rrjedh fjala shariatun-legjislacion) në kuptimin etimologjik ka kuptimin e rrugës së drejtë e cila shpie te uji, ajo gjithashtu ka kuptimin e

burimit të ujit që i bashkon njerëzit për të pirë dhe për t'iu dhënë ujë kafshëve, e arabët nuk e quajnë atë vend sher'un-شعر përveç nëse është i pandërprerë dhe i drejtë...¹

Ndërsa në kuptimin terminologjik ka këtë kuptim: "Atë që Allahu ua shfaqti robërve të Tij nga feja, e cila është rrugë e drejtë dhe e qëndrueshme, e Allahu është Ai i Cili e bëri legjitime këtë fe."² Sipas këtij kuptimi nënkupton shfaqjen e rrugës, sqarimin e saj dhe pasimin e saj.

Ndërsa definicioni i fjalës shariatun-شريعة në kuptimin etimologjik jep dy kuptime; e para: burim i ujit, dhe e dyta: rrugë e drejtë e cila nuk ka shtrembërime.³ Nga kjo rezulton se, legjislacioni islam për myslimanët është sikurse burimi i ujit, pa të cilin vetë ekzistenca e tyre s'mund të imagjinohet, ngase është elementi kyç për zhvillimin e jetës dhe, është një rrugë e drejtë, krejtësisht e qartë mes rrugëve të tjera të shtrembëruara, të cilat zakonisht çojnë në humbje e shkatërrim.

ÇKA SYNOHET ME MREKULLINË JURIDIKE TË LEGJISLACIONIT ISLAM?

Me këtë synohet të tregohet se legjislacioni islam është produkt hyjnor, e jo njerëzor; është universal për mbarë myslimanët, kudo qofshin ata; dhe gjithëpërfshirës për të gjitha çështjet e kësaj dhe botës së përtejme, gjegjësisht për tërë atë që i duhet njeriut, si në këtë botë, ashtu edhe në atë të përtejmen.

Legjislacioni islam për myslimanët është sikurse burimi i ujit, pa të cilin vetë ekzistenca e tyre s'mund të imagjinohet, ngase është elementi kyç për zhvillimin e jetës.



Islami nuk është vetëm besim sentimental i izoluar nga jeta njerëzore, por besimi është baza dhe esenca e fesë, prej saj rrjedh legjislacioni i cili organizon gjitha çështjet e jetës që i shërbejnë njeriut në jetën e tij. Shembulli i besimit i ngjan shembullit të pemës, ndërsa legjislacioni është degë e tij, kur përmirësohet besimi dhe ngulitet thellë në zemër, thellohet trunq i pemës, lëshon degët dhe jep frytet e saj në jetën njerëzore për ata që e pasojnë planprogramin e Zotit, qëndrojnë pranë kufijve të Tij, ndjekin ligjin e Tij dhe veprimet e Islamit.

Besimi (imani) luan rolin e brendshëm, e ligji atë të jashtëm, dhe se këto dy komponentë janë të domosdoshme për ngritjen e individit dhe shoqërisë. Me fjalë të tjera, Islami është besim dhe legjislacion, e legjislacioni nënkupton angazhimet (detyrat) praktike që i solli Islami në sferën e adhurimeve dhe raporteve të ndërsjella në mes njerëzve. Kurse besimi nuk është vetëm çështje praktike për të kryer një proces, por është edhe çështje teorike që kërkohet nga secili mysliman t'i besoj me zemër, ngase Allahu e ka informuar atë nëpërmjet librit të Tij, apo nëpërmjet shpalljes tek i dërguari i Tij.⁴

Mbi të gjitha, mrekullia e legjislacionit islam sfidon njeriun si krijesë, qoftë si individ apo edhe si grup, që të sjellin diç të ngjashme me atë çfarë solli Kurani nga dispozitat legjislative, qofshin ato që ndërlidhen me individin, familjen apo edhe me shoqërinë në të gjitha sferat. Ata as nuk mundën të sjellin të ngjashme e as të përballen apo ta sfidojnë një gjë të tillë! Një sfidë e tillë ishte pikërisht në kohën kur Kurani zbriste, duke i sfiduar ata të sillnin një kaptinë të shkurtë, apo të krijonin një krijesë qoftë të vogël, sfida të cilat mbeten të hapura edhe sot e kësaj dite.

LEGJISLACION I KOMPLETUAR

Ky legjislacion është i kompletuar dhe nuk ka nevojë për shtesa e as për heqje të ndonjë dispozite,⁵ nuk ka ardhur për një shoqëri, popull apo shtet të caktuar, por për gjithë njerëzimin, pa dallim orientimi, zakoni, vendi dhe kohe.⁶ Dispozitat dhe normat e këtij legjislacioni janë të pandryshuara, pa marrë parasysh rrethanat kohore dhe vendore.

Legjislacioni islam nuk kishte norma e rregullore të pakta që më vonë pas viteve apo shekujve u shumuan, as parime të shpërndara për t'u bashkuar më vonë, e as teori të ndryshme që më vonë pësuan ndryshime edukative, e as nuk i ngjan një fëmije të vogël që pastaj të pësojë ndryshime e të zhvillohet, por ky ligj lind si një i moshërritur, i plotësuar, zbriti ligj i plotësuar, i përgjithshëm, i tërësishëm nga ana e Zotit. Në të nuk ka shtrembërime dhe nuk shquhet për mangësi. Atë e zbriti Allahu nga qiejt e Tij në zemrën e të Dërguarit Muhamed a.s. për një kohë të shkurtër, e cila karakterizohet me dërgimin e tij si profet dhe përfundon me vdekjen e tij, apo mbaron atë ditë që Allahu i Madhërishtëm tha: "...Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju islam in fe..." (El Maide, 3).

Ky legjislacion nuk erdhi vetëm për një shoqëri të caktuar duke anashkaluar shoqërinë tjetër, as për një popull të caktuar duke shmangur një tjetër dhe as për një shtet duke mënjanuar një tjetër, mirëpo erdhi për mbarë njerëzimin; arab e të huaj, lindor e perëndimor, pa marrë parasysh adetet, zakonet dhe historinë e tyre. Ky është legjislacioni i çdo familjeje, fisit, shoqërisë dhe shtetit, madje legjislacioni botëror.⁷

Ky legjislacion erdhi i plotësuar, pa ndonjë mangësi, i përgjithësuar me akte gjykuese për secilën çështje,

gjithëpërfshirës për çështjet e individëve, shoqërive dhe shteteve, që rregullon kodin civil privat, marrëdhëniet e tyre dhe çdo gjë që lidhet me individët, gjithashtu rregullon edhe çështjet e sundimit (pushtetit), administratës, politikës dhe çështjeve tjera që (ndër)lidhen me shoqërinë, ashtu siç rregullon edhe marrëdhëniet e ndërsjella në mes shteteve në luftë, paqe dhe çështje të tjera.⁸

Si i tillë, nuk erdhi vetëm për një kohë të caktuar, për një shekull të veçantë apo për një periudhë të caktuar, por është legjislacioni për secilën kohë, shekull dhe periudhë.⁹ Nuk i lë gjurmë kalimi i kohës, nuk plakët freskia e tij, shtyllat e tij janë të pandryshueshme dhe nenet apo tekstet e tij nuk pësojnë ndonjë ndryshim e as ndërrim:¹⁰ "...Asnjë ndryshim nuk mund të ketë në Fjalët e Allahut..." (Junus, 64).

TEKSTET JURIDIKE HYJNORE SFIDOJNË NJERIUN

Tekstet e legjislacionit janë hyjnore, që nuk i përkasin njeriut dhe e sfidojnë atë në të gjitha fushat. Bërthama e tij nuk bazohet te dikush tjetër, përpos Allahut të Madhëruar, e kjo e dallon atë nga mendimet filozofike që i ka krijuar mendja njerëzore rreth së vërtetës hyjnore, të vërtetës së globit (gjithësisë), apo të vërtetës njerëzore, ashtu sikurse e dallon atë nga besimet e ndryshme pagane (politeiste) që i themeloi ndjenja, përfytyrimi, iluzioni dhe imagjinata njerëzore.¹¹

Ky legjislacion është i vetmi legjislacion hyjnor i mbetur origjinal nga legjislacionet paraprake, ku e vërteta e tij është hyjnorja qiellore, ashtu siç ishin edhe ato paraprake, por që më vonë i përfshiu shtrembërimi dhe falsifikimi i qëllimshëm nga persona dhe klane të caktuara, dhe kështu legjislacioni islam mbeti hyjnor dhe i vetmi legjislacion i paprekur, ashtu siç mbeti i pa ngatërruar në mes së vërtetës dhe të kotës, e në lidhje me këtë vjen konfirmimi i qartë ku thuhet: "Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kuranin dhe Ne gjithësesi jemi mbrojtës të tij." (Hixhr, 9).

Burimi i këtij legjislacioni është Allahu që e bën këtë legjislacion hyjnor, për dallim nga legjislacionet e ndryshme që burim kanë njeriun. E ky legjislacion është i pastër nga mangësia, saqë nuk ka lënë (gjë) të vogël e as të madhe përpos se ka bërë hulumtime rreth tyre dhe ka sqaruar dispozitën e tyre.¹²

Ky legjislacion nuk është bazuar në imagjinata e as përfytyrime, por në vërtetësi realiste, ku nënkuptohet gjithësisia si një ekzistencë e vërtetë, që Allahu e ka krijuar atë dhe çdo gjë ka caktuar e krijuar me masë, sikurse që nënkuptohet realizmi i jetës së

njeriut, i cili është i shoqëruar me të mira e të këqija, ashtu siç nënkuptohet realizmi i krijesës njeri, krijesë e çuditshme që gërshetohet brenda saj elementi qiellor me atë tokësor.

Ky realizëm vepron përherë me ekzistencën reale në jetën e njeriut, e në të njëjtën kohë është realizëm model apo model realist, ngase ka për qëllim ngritjen e shkallës apo përsosjen e njerëzimit drejt realizmit.¹³

Ky realizëm bashkëvepron me të vërtetën hyjnore, ashtu siç bashkëvepron me të vërtetën kozmike dhe të vërtetën njerëzore. Mjafton të përmendim disa prej teksteve që dëshmojnë se ky legjislacion sfidon njeriun dhe mendjen e tij:

LEGJISLACION REALIST NË ADHURIME

Legjislacioni islam në të gjitha çështjet është realist, ai edhe atëherë kur e ka obliguar besimtarin me diçka, e ka obliguar brenda mundësisë së tij, e në lidhje me këtë i Plotfuqishmi thotë: "Allahu nuk e obligon asnjë njeri përtej mundësisë së tij..." (El Bekare, 286.) Kjo nënkupton se obligimet janë përherë brenda mundësive të kufizuara të njeriut, e i Madhërishtmi ka respektuar mundësitë e njeriut: "...nuk ju obligoi në fe me ndonjë vështirësi..." (Haxh, 78).

Adhurimet apo obligimet që Krijuesi i ka përcaktuar janë të natyrave të ndryshme, por Krijuesi nuk ka përcaktuar që ne të jemi tërë kohën në adhurime, thënë ndryshe ta kalojmë tërë kohën në adhurime. Ka përcaktuar kohë për adhurim, por krahas kësaj ka përcaktuar që të jemi të lidhur me jetën, në punë, angazhim dhe gjëra të tjera, ashtu siç ka përcaktuar të jemi të lidhur me Krijuesin, ka përcaktuar të jemi të lidhur edhe me shoqërinë dhe me atë që na rrethon, nuk ka kërkuar vetëm të lidhemi me këtë botë, por edhe me botën tjetër, jo vetëm me anën materiale, por edhe me atë shpirtërore.

Enes ibën Maliku ka thënë: "Tre njerëz erdhën te shtëpitë e bashkëshorteve të të Dërguarit të Allahut, që të pyesin për adhurimin e tij¹⁴, e kur ata u njoftuan, atëherë thanë: "E ku jemi ne nga i Dërguari i Allahut, të cilit i janë falur mëkatet e mëhershme dhe të mëvonshme." Njëri prej tyre tha: "Sa më përket mua, do të falem gjatë gjithë natës", tjetri tha: "Unë do të agjëroj tërë kohën, e nuk do të prishi (asnjë ditë)." Përderisa i treti shtoi: "Unë do t'i largohem grave e nuk do të martohem asnjëherë." Më pas erdhi i Dërguari i Allahut dhe u tha: "Ju jeni ata të cilët keni thënë kështu e kështu, për Zotin, sa më përket mua, unë ia kam frikën Atij më së shumti dhe jam më i devotshmi ndaj Tij, mirëpo unë agjëroj dhe ha, falem e flejë dhe martohem, e kush largohet nga tradita ime ai nuk është prej meje."¹⁵

Ky legjislacion është i vetmi legjislacion hyjnor i mbetur origjinal nga legjislacionet paraprake, ku e vërteta e tij është hyjnorja qiellore.

LEGJISLACION REALIST NË LIGJVËNIE

Legjislacioni islam është shumë real në të gjitha përcaktimet e gjërave të lejuara dhe të ndaluara.

Ka lejuar gjërat e bukura që natyra e njeriut anon kah to, e ka ndaluar gjërat e urryera që janë në kundërshtim me logjikën dhe arsyen e vetë njeriut. Kështu, për ilustrim, ka ndaluar alkoolin, si sasinë e paktë të tij apo të shumë, ngase ai ka një efekt shumë negativ të mendja dhe logjika e personit që e përdor, sikurse që ka ndaluar bixhozin, fallin dhe veprat tjera djallëzore: “O ju që besuat, s’ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyta nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar.” (El Maide, 90).

Prej ushqimeve ka lejuar ato që janë të mira dhe që janë në natyrshmërinë e pastër të njeriut për përdorim, kurse ka ndaluar ato që janë të dëmshme dhe që sjellin efekte negative në vetë njeriun: “Juve u janë ndaluar (t’i hani): ngordhësit, gjaku, mish i dërrit, ajo që theret jo në emrin e Allahut, e furma, e mbytura, e rrëzuara, e shpuara (nga briri i tjetrës), ajo që e ka ngrënë egërsira, përveç asaj që arrini ta therni (para se të ngordhë), ajo që është therur për idhujt dhe (u është e ndaluar) ta kërkoni me short fatin...” (El Maide, 3).

Ka ndaluar prostitucionin si njëri ndër mëkatet më të turpshme dhe të pahijshme që cenon rëndë moralin, nderin dhe dinjitetin e njeriut. Për më tepër, ai bëhet shkak për shthurjen dhe prishjen e familjes, si edhe për përhapjen e degjenerimit dhe degradimit moral tek individët dhe te shoqëria njerëzore.¹⁶

Ka ndaluar edhe shpifjen për imoralitet ndaj burrave dhe grave të ndershme dhe të devotshme, ngase është mëkat i madh, sepse ajo bëhet shkak për prishjen e lidhjeve familjare. Kjo shpifje mund të shkaktojë ndarjen e burrit nga gruaja dhe shkatërrimin e bazave të familjes.¹⁷

Vjedhja nuk është gjë tjetër veçse dhunim dhe keqtrajtim i pasurisë, e cila është ndër gjërat më të shtrenjta për njeriun, ndaj edhe këtë e ndaloi Ligjvënisi në mënyrë të prerë.

Në anën tjetër, ka lejuar shumë gjëra që janë të nevojshme për njeriun, si stolitë e ndryshme, veshjet e bukura, rregullimin, disa lojëra,¹⁸ gëzime familjare, dasma, festat, të cilat janë brenda kornizave të këtij legjislacioni.

Ka lejuar për gratë bartjen e arit dhe rrobat e mëndafshit, duke marrë në konsideratë natyrën e gruas dhe dashurinë e saj pas stolive të ndryshme.

Ka lejuar martesën, ngase ajo është bërthama e familjes,¹⁹ prej së cilës rrjedh njerëzimi dhe ka ndaluar jetën e partnerëve jashtëmartesorë dhe të dashnorëve, ngase jeta e ndërrimit të partnerëve dhe dashnorëve është jetë pa moral dhe jo njerëzore, dhe e cila sjell të këqija të panumërta: “Dhe nga faktet (e madhërisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë.” (Er Rum, 21).

Ky legjislacion nuk preferon ndarjen (divorcin), tekstet e tij thërrasin me slogane kundër divorcit: “...Çoni jetë të mirë me to. Nëse i urreni ato, bëni durim pse ndodh që Allahu të japë shumë të mira në një send që ju e urreni.” (En Nisa, 19).

Divorci është një veprim i urryer dhe i padëshiruar, por kur jeta bëhet e padurueshme dhe kur shteren të gjitha mundësitë e pajtimit bashkëshortor, atëherë ai lejohet dhe në disa raste bëhet edhe ilaç efikas, megjithëse në esencë është akt i urryer. Nga Abdullah ibën Omeri transmetohet se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Gjëja e lejuar të cilën më së shumti e urren Allahu është divorci.”²⁰

Pra, ky legjislacion në tërësi dhe në çdo pikëpamje është real, ngase ka inkorporuar në tërësinë e vet elementet e arsyes për vetë njeriun, duke iu përshtatur natyrës së tij. (vijon)

- 1 Ibni Mendhur, Ebi-l Fadl Xhemaludin Muhamed ibën Mukrim el Efrikij el Misrij, Lisanul Arab, bot. III-të, Dar-us-Sadir, Bejrut-Liban, 1414h-1994m, vëll. VIII, fq. 176-177; Rrafii, Ahmed ibën Muhamed ibën Alij el Mukrij el Fejjumi, El Misbahu-l Munir fi Garibi-sh Sherhi-l Kebir, boton: Dar-ul Fikr, fq. 473.
- 2 El Bermuti, Muhamed Amimul Ihsan, Et Ta’rifat-ul Fikhijeh, bot.I-rë, Dar-ul Kutub el Ilmijetu, Bejrut-Liban, 1424h-2003m, fq. 121.
- 3 Bedran, Bedran Ebu-l Ajnejn, Esh-Sheriatu-l Islamijetu, Te’rihuha ve Nadhrijetu-l Milkijetu vel-Ukud, boton: Muessesetu Shebabu-l Xhemaah, Aleksandri-Egjipt, fq. 27.
- 4 Mehdeli, Muhamed Akil ibën Ali, Mukaddimetun fi-l Akideti-l Islamijeti ve Ilmi-l Kelam, bot. I-rë, Dar-ul Hadith, Kajro-Egjipt, 1993m, fq. 13.
- 5 Udeh, Abdulkadir, Et Teshriu-l xhenaj el Islamij..., mektebetu daru-t turath, Kajro-Egjipt, 1424h-2003m, vëll.I, fq. 14.
- 6 Kardavi, Jusuf, Med’hal Lidiraseti-sh Sheriati-l Islamijeh, fq. 26.
- 7 Udeh, Abdulkadir, Et Teshriu-l xhenaj el Islamij..., vëll.I, fq. 14.
- 8 Op, cit.: vëll.I, fq. 14.
- 9 Kjo është edhe akuza kryesore për këtë legjislacion, saqë të pa reformuarit dhe të paditurit kanë bindjen se ky legjislacion duhet vënë jashtë përdorimit, për shkak se sipas tyre e ka kryer misionin dhe nuk është praktik për kohën moderne.
- 10 Kardavi, Jusuf, Med’hal Lidiraseti-sh Sheriati-l Islamijeh, fq. 26-27.
- 11 Kutb, Sejid, Hasais-ut Tesavvur el Islamij ve Mukavimatuhu, bot.XII-të, Dar-ush-Shuruk, Kajro-Egjipt, 1413h-1992m, fq. 43.
- 12 Esh-Sherif, Muhamed Abdulgafar, Buhuth Fikhijeh Muasarah 1-10, bot. I-rë, Dar ibn Hazm, Bejrut-Liban, 1420h-1999m, fq. 113.
- 13 Kutb, Sejid, Hasais-ut Tesavvur el-Islamij ve Mukavimatuhu, fq. 163.
- 14 Sipas Ibni Haxherit (Fet’hu-l Bari) kanë pyetur për adhurimin e tij të fshehtë në shtëpinë e tij, ngase adhurimi i tij në xhami e vende të tjera ka qenë i njohur.
- 15 Buhariu në Sahih, nr. i hadithit 4675. Hadithi është autentik.
- 16 Sabik, Sejid, Fikhus-Suneh – Legjislacioni i Traditës së Profetit a.s., botoi: AHTC, Tiranë, 2007, vëll.II, fq. 431.
- 17 Op. Cit.:fq. 431.
- 18 Si garat me kuaj, garat në vrapim apo disa të tjera, por nuk duhet të jenë të shoqëruara me diçka të ndaluar.
- 19 Ata, Abdulkadir Ahmed, Hadha Halalun ve Hadha Haramun, Dar el-Fediletu, Kajro-Egjipt, fq. 204.
- 20 Ibni Maxhe në Sunen, nr. i hadithit 2008; Ebu Davudi në Sunen, nr. i hadithit 1863.

Specifikat e linguistikës së Kuranit

Prof. dr. Sulejman Topoljak

Nuk ka gjuhë, që është më e respektuar se arabishtja. Në Arabinë para islame, gjuha arabe ishte produkt i vetëm dhe shumë i zhvilluar kulturor, kurse poezia ishte formë e vetme e njohur e artit. Me lirikën e tyre arabët filluan që botën e tyre ta kthejnë në gjuhë. Qytetërimi i tyre ishte i natyrës tekstuale.

Rreth gjuhës në të cilën është shpallur Kurani, Allahu xh.sh., në Kuran thotë: “Në të vërtetë, ne e zbritëm atë Kuran arabisht, ashtu që ta kuptoni.” (Jusuf, 2). Si fjalë e Zotit, Kurani nuk është një formë letrare në ndonjë kuptim të zakonshëm, e as që mund të jetë, për shembull, kategorikisht e pa udhëzuar si “prozë e rimuar”. Megjithatë, Kurani është gjithashtu

i arritshëm vetëm për shkak se i ndjek ligjet e estetikës dhe gramatikës së arabishtes klasike. Në të vërtetë, nuk ka punë mjeshtërore - maestrale (chef d'oeuvre) e letërsisë botërore që i impresionon lexuesit aq thellë sikur që vazhdon ta bëjë këtë Kurani.

Thënë në mënyrë të përmbledhur, është e lejuar analiza e veçorive stilistike dhe gjuhësore të Kuranit. Në fakt, e vetmja gjë që i mbetet njeriut është që të veçojë dallimet, të tilla si ato në mes të gjuhës së lartë poetike, gjuhës intensive dhe të fortë të sureve të hershme dhe stilit të gjatë dhe të matur të sureve të mëvonshme (në Mekë ishte çështje e kontestueshme gjetja e besimtarëve, kurse në Medinë që të udhëzohen ata).

Kurani është i arritshëm vetëm për shkak se i ndjek ligjet e estetikës dhe gramatikës së arabishtes klasike.



PREJ SPECIFIKAVE TË LINGUISTIKËS SË KURANIT JANË:

- **Pasuria e vokabularit në Kuran**

Gjuha e Kuranit pak i përdor mbiemrat. Megjithatë, ai është i pasur me folje dhe i përdor ato në të gjitha tetë modalitetet e mundshme, shpesh në formën e gerundivit (emrit foljor, si p.sh. “dëgjimi”). Përdorimi i foljes substanciale “ata do të jenë ata që fitojnë” është mjaft e zakonshme, siç është rasti edhe me formën pasive të foljes.

Në përgjithësi, Kurani përdor disa kohë - kryesisht kohën e tashme dhe kohën e kaluar, të pakryer - dhe një vokabular të thjeshtë,¹ madje edhe tejet modest - dhe nuk është i stërmbushur me fjalë të sofistikuara, të rralla dhe intelektuale, që janë përdorur në poezinë arabe. Sidomos janë të rralla foljet rrënjë e të cilave (el masdaru) ka katër bashkëtingëllore. Të tilla janë identifikuar vetëm 15 në Kuran, edhe pse poetët para-islam e favorizonin përdorimin e tyre duke i përdorur në numër të madh. Natyrisht, thjeshtësia e dukshme e gjuhës kuranore është joshëse. Ajo në brendësinë e vetë fsheh shumë shtresa të kuptimit.

- **Dyfishimi në Kuran**

Në gjuhën arabe është retorikë efektive nëse e njëjta fjalë është përdorur më shumë se një herë në të njëjtën fjali (në gjuhët evropiane sugjerohet shmangia e një dyfishimi të tillë “jo estetik”). Për shembull: “Idha zulziletil-erdu zilzaleha” – “Kur të dridhet Toka me dridhjen e saj të fuqishme...” (Ez Zilzal, 1).

Gjuha arabe është, ndoshta, e vetmja gjuhë që përdor fjalë me kontradikta, kuptime reciprokisht ekskluzive. I njëjti term mund të nënkuptojë “muzgun” dhe “agimin”.

- **Onomatopeja**

Onomatopeja është figurë stilistike në të cilën tingujt nga natyra imitohen me fjalë, rrokje ose zëra. Kurani pëlqen të përdor fjalët, intonacioni i të cilave paralajmëron kuptimin e tyre.

- **Aliteracioni**

Përdorimi i përsëritur i shkronjave të njëjta ose tingujve, si në suren (En Nas, 4): “... vesvasil-hannas, el-ledhi juvesvisu fi sudurin-nas” - “nga e keqja e shejtanit i cili intrigon, i cili mendimet e këqija i fut në zemrat e njerëzve.” Vetë shpallja e parë veç ishte komplekse fonetiki duke i gërshtuar fjalët të tilla si: ‘alek/halek; ikre/ikram; dhe ‘al-lem/ja’lem.

- **Dialogu**

Në disa pasazhe fjalët duken si komentet për ato të cilat kanë paraprirë. Ky është rasti në 4:46, ku fjalja e parë shpjegohet me të dytën, siç është rasti i së tretës, e cila shpjegohet me të katërtën. Surja 16:101 gjithashtu korrespondon me këtë shemë a/b/ a/b:

(a) E kur Ne ajetin e abrogjëm me një tjetër

(b) – e Allahu di më së miri se çka shpall -

(a) ata thonë: “Ti vetëm shpik”

(b) E nuk është ashtu, por shumica e tyre nuk dinë.

- **Refreni**

Ka pasazhe në Kuran ku frazat e përsëritura sugjerojnë për një lloj dialogu. Prototip është rasti me suren 55, Err Rrahman (Mëshiruesi), në të cilën thirrja: “E, cilën të mirë të Zotit tuaj po mohoni!?” përmendet 32 herë.





• Patosi dhe theksi

Shumë nga frazat kuranore fillojnë me “ve” prekëse (“dhe” ose “por”), ose me “inna” ose “kad” (“në të vërtetë”, “vërtet”, “sigurisht”), e gjithë kjo me qëllim të vënies së theksit.

“Ve” dhe fjala arabe për “dhe” nuk përdoret vetëm për të nxjerrë në pah diçka

Në shumicën e rasteve, ajo thjesht lidh dy fraza. Kjo është aq e shpeshtë dhe bën që gjuha arabe mund të akuzohet se “vuan” nga va-vizmat. As ata që flasin gjuhën arabe nuk vërejnë ndonjë kontradiktë në ndërlidhjen “dhe” me “ose”. Dhjetëra fraza kuranore fillojnë me “ve lakin” (e, mirëpo).

• Ambivalenca (el-ibham)

Që fjalët të bartin disa kuptime është karakteristikë tipike e të gjitha gjuhëve. Ky është edhe rasti me konceptet kyçe kuranore siç është ajeti (vargu, shenjë), dhe din, i cili mund të paraqet fenë, besimin, bindjen, solidaritetin, të drejtën e opinionit, ritual apo mënyrë e jetës. Kështu, e njëjta fjalë nuk mund të përkthehet gjithmonë në të njëjtën mënyrë. Gjuha arabe është, ndoshta, e vetmja gjuhë që përdor fjalë me kontradikta, kuptime reciprokisht ekskluzive. I njëjti term mund të nënkuptojë “muzgun” dhe “agimin”. Në raste të tilla, ajeti kuranor mund të kuptohet në një mënyrë apo tjetër, ose në të dyja.

• Sinonime

Kurani u drejtohet kategorive si vijon: Gjinisë njerëzore (ejjuhen nas!); besimtarëve/muslimanëve (ejjuhel mu'minun, muslimun!); Muhamedit a.s. (ejjuhen nebijju!); jobesimtarëve (ejjuhel kafirun!); politeistëve (ejjuhel mushrikun!); hipokritëve (ejjuhel munafikun!)

Nuk ka konsensus në mesin e ekspertëve rreth ekzistimit të sinonimeve në Kuran. Në të vërtetë, ajo që në shikim të parë duket e këmbyeshme shpesh kështu nuk duket pas shqyrtimit të detajuar. Prandaj, nuk është e këshillueshme që vetëm të shpjegohet fjala kuranore me një tjetër.

• Vokabulari neutral i gjinisë

Koncepti i “Zotit” (el ilah, Allah) në gjuhën arabe është neutral gjinor. Edhe pse Allahu në Kuran shpesh e përmend Vetën si “Ai” (huve), mbetet e qartë se Zoti nuk mund të klasifikohet në mënyrë të qartë si gjini mashkullore (maskulin) ose femërore (feminin). Kjo gjithashtu merr të drejtën e përpjekjeve feministe myslimane që huve ta përkthejnë si “Ajo”.

• Adresatët

Adresatët - atyre që u drejtohem. Kurani u drejtohet kategorive si vijon: Gjinisë njerëzore (ejjuhen nas!); besimtarëve/muslimanëve (ejjuhel mu'minun, muslimun!); Muhamedit a.s. (ejjuhen nebijju!); jobesimtarëve (ejjuhel kafirun!); politeistëve (ejjuhel mushrikun!); hipokritëve (ejjuhel munafikun!).

Përktheu dhe përshtati nga gjuha boshnjake: Dr. Azmir Jusufi

1 Sulejman Topoljak, Osnovi tefsira (Uvod u nauku o Kur'anu), El Kalem, Novi Pazar, 2014, f. 142-152.

Filozofia e Hixhretit (shpërnguljes) në Islam drejt një vizioni të ri

Sufjan el Hatashenshir¹

Bota islame çdo vit e feston fillimin e muajit muharrem, vitin e ri hixhri, që shënon shpërnguljen² e të Dërguarit fisnik a.s. dhe shokëve të tij nga Meka në Medine. Kjo është ngjarje, përbënë një pikë kthese dhe një ndryshim të spikatur në historinë islame, meqë ajo mbarti Islamin si një besim, kulturë dhe opinion të ri në arenën e luftës civilizuese ndërmjet popujve. Atëbotë, i Dërguari a.s., vendosi gurthemelin e parë për ndërtimin e shtetit dhe shoqërisë, që më pas ai shtet do ta ketë fjalën e tij ndërmjet shteteve dhe perandorive, që sundonin në atë periudhë kohore. Pavarësisht nga dallimi ndërmjet Islamit si besim e fe hyjnore dhe ndërmjet historisë së myslimanëve si qenie njerëzore me

përvojat, gabimet dhe sukseset e tyre, hulumtimi në çështjen e shpërnguljes nga këndvështrimi islam kërkon një hulumtim bashkëkohor në aspektin e metodës dhe përmbajtjes, që tejkalon shumë korniza tradicionale në tezën islame, me një tendencë historike, që trajton ngjarjen e shpërnguljes të të Dërguarit a.s. nga Meka në Medine, me një qasje narrative, pa u kredhur në dimensionet e ngjarjes dhe filozofisë së saj historike.

Sipas mendimit tonë, mendësia tradicionale islame e ka mangësinë e pajisjes metodologjike shkencore, që do t'i mundësonte asaj të zbërtheje ngjarjen dhe të eksplorojë thellësitë e saj, dhe kjo nuk bie ndesh me Kuranin fisnik. Në



të gjejmë shumë simbolika dhe frymëzime, që i japin realitetit historik, dimensione ideore dhe filozofike, tejkalojnë thjesht përshkrimin, tregimin dhe narrativin në horizonte më të gjëra se mendimi filozofik dhe filozofia historike. Tashmë Kurani fisnik na e paraqet shpërnguljen si një ligj i thellë filozofik dhe shoqëror përtej pikëpamjes historike të shpërnguljes në historinë islame, si shpërngulje e myslimanëve nga Meka në Abisini apo Medine. Prandaj shpërngulja është një faktor nga faktorët e zhvillimit dhe qytetërimit. Kështu, qytetërimet që janë krijuar gjatë historisë, të gjitha ishin rezultat i shpërnguljeve, që kanë ndodhur më parë, si për shembull shpërngulja bashkëkohore në ShBA.

Meqë shoqëria beduine fisnore nuk zhvillohet për të formuar një qytetërim dhe një kulturë të re, për sa kohë ajo mbetet permanent në vendin e saj. Shoqëria që mbyllet në vetvete, nuk lejon që ajri të hyjë në shtëpinë e saj nga jashtë, që refuzon të presë ndonjë të huaj apo vizitor, dhe e cila përçmon këdo që nuk i ngjan në formë apo në përmbajtje të saj, atëherë ajo bëhet një shoqëri e prapambetur. Historiani më i shquar i botës bashkëkohore, Arnold Tojbeni,³ në studimin e tij të mrekullueshëm për analizën e historisë, tregon për një teori të quajtur origjina e shpërnguljes dhe e kthimit. Ai shprehet se: "Personalitetet e mëdha në historinë e njerëzimit, që i ndërtuan qytetërimet, krijuan besime dhe formuan shoqëritë, ata në fillim të fazës së parë të jetës tyre braktisen shtëpitë e tyre dhe dolën nga mjedisi i tyre shoqëror dhe nga toka e tyre. Mirëpo, ata pas një periudhe të mungesës, që u përgatiten për kryerjen e misionit të tyre të rëndësishëm, ata u kthyen në mjedisin dhe popullin e tyre, dhe filluan veprimtarinë e tyre!"

Këtij kthimi të jashtëzakonshëm dhe të rëndësishëm, në fakt, i parapriu një shpërngulje e qetë dhe e heshtur, e cila luajti një rol themelor në ndërtimin e shpirtit dhe gjenialitetit të atyre personaliteteve. Studimi i feve, shoqërive dhe qytetërimeve të hapura dhe të mbyllura në historinë e njerëzimit dëshmon të vërtetën shkencore siç vijon: "Njëmend shpërngulja është shkëputje e raportit të shoqërisë me tokën, që e ndryshon

vizionin e njeriut ndaj botës dhe e shndërron atë në një vizion gjithëpërfshirës!"

Kështu si rezultat, ajo,⁴ shkrin akullin e stagnimit, rënien sociale, intelektuale, emocionale dhe kështu shoqëria e klasifikuar dhe ndenjur arrijnë jetë dhe lëvizshmëri. Me fjalë të tjera, vërtet, në saje të ekzistencës së shpërnguljes dhe vetë lëvizjes së madhe njerëzore, ajo shpërndan në vizionin e shoqërisë frymën e lëvizjes. Dhe, si pasojë ajo përkund shoqërinë, e zhvendos atë nga korniza e saj e ngurtë në shkallët e ngritjes të sofistikimit dhe përsosmërisë. Nga këtu, pas shfaqjes së çdo qytetërimi fshihet ndonjë shpërngulje, dhe kur ne dëgjojmë historinë e ndonjë shoqërie të madhe, atëherë ne gjejmë gjuhën apo mitet e saj që tregojnë për një shpërngulje specifike.

Shpërngulja në historinë e Islamit është Kurani dhe jetëshkrimi i Pejgamberit a.s., e nuk është vetëm një fakt i kësaj historie, por ajo është një bazë kryesore shoqërore. Kështu, nëse e shqyrtojmë Islamit me një kujdes të përpiktë, atëherë do të gjejmë se çështja e kësaj trajte është se myslimanët u shpërngulen dy herë në Abisini me urdhër të Pejgamberit a.s.. Për herë të parë, shpërngulet një grup njerëzish arab, i cili jetonte në një luginë të tij, e rrethuar nga malet, ku gjendet fisi i tij në qytetin Meka, që braktisi tokën e tij, madje bëri shpërngulje kolektive në një vend të jashtëm. Ai grup përshkon detin dhe shkel në një kontinent tjetër, që të jetojë në një mjedis të ri shoqëror, politik dhe etnik dhe më pastaj është shpërngulja e madhe drejt Medinës. Kjo shpërngulje hapi dyert e mbyllura të Medinës për botën e jashtme, siç i njohu ajo me 'të shpërngulurit' nga Kurejshët në një shoqëri, mjedis dhe rrethana të reja.

Pejgamberi a.s. bëri përpjekje që të hapë horizonte për shoqërinë fisnore arabe dhe zhvillimin e vizionit të tij për botën. Ai nëpërmjet një politike që mbështetet në kontakte me fiset fqinje synoi zgjerimin e rrethit të ndikimit të tij deri në kufijtë më të largët të mundshëm, duke pranuar delegacionet, si dhe duke dërguar emisarë dhe ambasadorë në periferi të Gadishullit. Madje ai edhe përtej kufijve kishte kontaktet me persët, romakët lindorë, Egjiptin, Jemenin dhe vendet e tjera. Dhe, nuk dëftojnë vetëm

"Me të vërtetë ata që besojnë dhe të cilët shpërngulen dhe luftojnë në rrugën e Allahut, të tillët meritojnë të shpresojnë në mëshirën e Allahut. Dhe Allahu është Gjithëfalës dhe Mëshirëplotë!"

(El Bekare, 218).

këto fakte për të gjitha të dhënat në jetën e Pejgamberit a.s., por madje tekstet, fjalët e Pejgamberit a.s. dhe ajetet e Kuranit i konsideronin shpërngulje, veçmas formën më të mirë të tij ‘shpërngulja intelektuale dhe akaidore’⁵ si një origjinë e shenjtë, për më tepër një detyrim njerëzor. Kështu që, ajetet janë të qarta në këtë fushë: “Me të vërtetë ata që besojnë dhe të cilët shpërngulen dhe luftojnë në rrugën e Allahut, të tillët meritojnë të shpresojnë në mëshirën e Allahut. Dhe Allahu është Gjithëfalës dhe Mëshirëplotë!” (El Bekare, 218).

I shpërnguluri (المهاجر) në rrugën e vërtetë, sipas ajetit, ai nuk qëndron vetëm në rreshtin e luftëtarit (المجاهد), por ai i prinë atij, siç mund të vërejmë, meqë pas besimit vjen shpërngulja drejtpërdrejt si bazë praktike më madhore dhe veprimtari e shenjtë njerëzore. Kjo lëvizje përpara apo prapa është një dëshmi në kontekstin kuranor dhe meriton një qëndrim dhe meditim për të, andaj nuk është kot dhe rastësi absolutisht. “...Dhe atyre që u shpërngulen, u dëbuan nga shtëpitë e tyre, u munduan në rrugën Time, luftuan dhe u vranë, Unë do t’ua mbulojë veprat e këqija dhe do t’i shpie në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, si shpërblim nga Allahu. Dhe shpërblimi më i mirë është tek Allahu.” (Ali Imran, 195); “Ata që, pasi vuajtën të shtypur, u shpërngulën për hir të Allahut, Ne do t’i vendosim në vendbanime të mira në këtë botë! Vërtet shpërblimi që i pret në botën tjetër, është edhe më i madh, sikur ta dinin ata!” (Nahl, 41).

Shpërngulja në këto ajete është e qartë si një faktor në rrugën e jetës, që është më e parapëlqyer për të nëpërkëmburit dhe motiv për të drejtën e shfrytëzimit më të madh si dhe puih e jetës në këtë botë. Këtë të vërtetë dhe realitet e njeh historia më mirë se sa që e njeh ndonjë person tjetër. Andaj, ajeti në vijim për shembull, është thirrje për njerëzit, të cilët i binden realitetit dhe nuk merren me ndonjë motiv të përkatësisë së tyre për lidhje emocionale dhe tradita shoqërore apo zotërimin e vizionit politik konvergjent...

“Kur melaqet ua marrin shpirtat atyre që e kanë ngarkuar veten me faje, u thonë: “Ku ishit?” Ata përgjigjen: “Ishim të pafuqishëm në Tokë.” (Melaqet)do të thonë: “A nuk qe Toka e Allahut e gjerë që të shpërnguleni në të?” Këta janë ata, vendbanimi i të cilëve është Xhehenemi! Dhe sa i keq është vendbanimi! Me përjashtim të meshkujve të pafuqishëm, grave dhe fëmijëve, të cilët nuk kanë as fuqinë e as mundësinë të drejtohen në rrugë. Mbase Allahu i fal, se Allahu me të

vërtetë është Gjunaqfalës dhe Gjithëfalës. Kush shpërngulet për çështjen e Allahut, ai gjen shumë vendbanime dhe begati në Tokë. Kush lë shtëpinë e vet, duke u shpërngulur për tek Allahu dhe i Dërguari i Tij dhe ndodh që t’i vijë vdekja, atëherë Allahu me siguri do ta shpërblejë. Allahu është Gjithëfalës dhe Mëshirëplotë!” (En Nisa, 97-100).

Në dritën e persekutimit për stilin e Kuranit fisnik, atëherë gjejmë se kur ai flet për shpërnguljen e përshkruan atë me: “Ecje mbi tokë dhe dëbimi nga shtëpitë” etj..

Nga këtu shpjegohet qartë se Islami stimulon në braktisjen e vendlindjes, familjes, vatanit dhe shoqërisë për shpëtimin e nderit individual dhe të lirisë nëpërmjet besimit. Ngjarja e shokëve të shpellës (أصحاب الكهف) është tejet shprehëse e tërheqëse, e po ashtu edhe shpërngulja në Abisini, është arritje e potencialeve të reja, rrethanë mbështetëse jashtë mjedisit shoqëror dhe ekonomik. Janë zgjerim, freskim i mendimit dhe besimit në një vend dhe shoqëri të tjera për të

kryer mesazhin njerëzor dhe botëror është detyrë e çdo myslimani. Ai mban përgjegjësinë para njerëzimit në vetëdijesimin, emancipimin, lumturinë e tyre dhe dërgimin e mësimdhënësve jashtë Medinës dhe vendeve islame. Studimin e botës dhe njohjen e saj me një njohje shkencore që përfshinë natyrën, veçmas gjeografinë natyrore, humane, ekonomike, gjeologjinë, botanikën, hidraulikën, aerologjinë...po kështu edhe antropologjinë.

Është detyrë njohja e popujve, mileteve dhe origjinës racore, shoqërive, stileve të jetës shoqërore, politike dhe ekonomike, zakoneve, traditave dhe feve, me një ilustrim të përgjithshëm. Po ashtu çdo gjë që ka të bëjë me njohurinë e njeriut dhe shoqërinë e tij, me shprehje përmbledhëse dhe të përpiktë ai vetë nxjerrë përfitim nga Kurani fisnik: “Ne do t’u tregojmë atyre shenjat Tona në hapësirën tokësore dhe qiellore, sikur që është detyrë njohja e natyrës dhe jetës.” (Fusilet, 53).

Andaj, Ku’ani fisnik nuk e kufizon propozimin e studimit të shkencave humane, madje edhe historinë, që ende është shumë larg çështjeve thjesht nga shkencat, bile është detyrë fetare studimi për ndonjë shpërngulje shkencore: “...Vallë, a nuk kanë udhëtuar ata nëpër botë për të parë se si ka qenë fundi i popujve, që ishin para tyre?” (Ali Imran, 137).

Çështja është shumë e rëndësishme mbi tezën ‘e shpërnguljes’, në një dritë siç na qartëson Kurani fisnik, ku koncepti i

Në këtë dritë, Islami synon lëvizjen e shoqërisë, por nuk ndalet në ndonjë pikë dhe të mbarojë. Ai synon po ashtu lëvizjen e individit, andaj njeriu thërret për lëvizje nga jashtë dhe për revolucion nga brenda, që ta ruajë atë nga ndërprerja e ndonjë veprimi, rënie morale dhe ngrirje që zgjat vazhdimisht.



shpërnguljes është i pambarim, dhe zgjerimi i fushës së tij është, se kjo fjalë është përdorur në Kuranin fisnik me një kuptim të përgjithshëm e të pa përkufizuar. Kurse në gjuhën e sociologjisë, njëmend shkalla e kuptimit të kësaj fjale arriti apogjenë, që është ngritur mbi nivelin tokës.

Shpërngulja nga një pikë në tjetrën, është lartësuar në nivelin e frymës së lartë, në kulmin e spirtualitetit dhe moralit, revolucionet ideore dhe shpirtërore. Në këtë dritë ne ballafaqohemi në fillim me një origjinë të madhe, të thellë dhe serioze që quhet shpërngulje. Në parim, mund të kuptojmë dimensionin dhe vlerën e saj, nga do që mund të marrim dije, andaj myslimani që e kupton Kuranin, pas besimit, ai do ta gjejë veten i ballafaquar ndaj një origjinë të madhe dhe urdhër të prerë: Të shpërngulet ai nga jashtë dhe të shpërngulet nga brenda! Që ai të udhëtojë nëpër tokë dhe udhëtim në thellësi të shpirtit. Të shpërngulet nga ai vendi që nuk ka mbetur ndonjë gjendje e stabilizuar, dhe të largohet prej tij atëherë kur nuk është i aftë të marrë ndonjë nismë. Shpërngulja nuk kufizohet në largimin nga vendlindja, por ajo përfshin po ashtu edhe largimin nga vetvetja.

Në këtë dritë, Islami synon lëvizjen e shoqërisë, por nuk ndalet në ndonjë pikë dhe të mbarojë. Ai synon po ashtu lëvizjen e individit, andaj njeriu thërret për lëvizje nga jashtë dhe për revolucion nga brenda, që ta ruajë atë nga ndërprerja e ndonjë veprimi, rënie morale dhe ngrirje që zgjat vazhdimisht. Ai e shtyn atë në lëvizje, ngritje dhe revolucion permanent. Andaj, Islami e bën këtë nëpërmjet mrekullisë

shkencore që është shpërngulja. Shpërngulja horizontale dhe shpërngulja tokësore. Vërtet përcjellja e veprave shkencor të shpërnguljeve me dy dimensionet e saj në dritën e sociologjisë dhe psikologjisë nuk na mundësohet dhe nuk mund që me një artikull të këtillë të shpjegohen vlerat e mëdha të kësaj origjine.

Por ajo që nuk mund të neglizhohet këtu është se, Islami e përmend shpërnguljen me vëmendje shkencore të përpiktë mbi veprat e shpërnguljes të mahnitshme në ngritjen e personaliteteve të mëdha dhe qytetërimet kolosale. Emërtimi i pasuesve dhe përkrahësve të parë të Pejgamberit a.s. me të shpërnguluri (بالمهاجرين), vetë dëshmon për këtë orientim, nga vetë emërtimi i Pejgamberit a.s.: “Të parët e mëdhenj nga shokët e tij ishin të shpërngulurit!”

Nga të gjitha vetitë, që mund t’i quante ata, ai e zgjodhi vetinë “i shpërngulur”. Sikur të mos ishte shpërngulja me një rol të madh në mendimin islam, atëherë ajo nuk do të printe ndaj të gjitha vetive të tjera, dhe e cila mund t’i përshkruajë ata. Këto veti janë që luajtën një rol në ndërtimin e rilindjes islame, si të parët dhe përkrahësit e Pejgamberit a.s., veçmas në ditët e vështira, andaj ai i përballoi lëndimet, ndëshkimet fizike dhe përballjen e rreziqeve.

Po ashtu, rol në ndërtimin e rilindjes islame ishte çiltëria, altruizmi, flijimi dhe adhurimi ndaj të Vërtetit Absolut. Kështu anashkalimi i pasurisë, vetes, familjes, konsideratës shoqërore, sigurisë, rehatisë dhe kënaqësisë, dëshmon për këtë orientim në një formë të përkryer, dhe vetë ai përfaqëson një karakteristikë dhe veçori të Islamit. Zgjedhja e shpërnguljes së parë të myslimanëve nga Meka në Medine si një fillim i historisë. Kjo zgjedhje meriton meditim të thellë, meqë zakoni historik përherë zgjedh lindjen e liderit për rilindje apo fenë, apo zgjedh fitoren e madhe fillim i historisë. Kurse në Islam nuk e zgjodhën asnjërën prej tyre, as lindjen e Pejgamberit a.s., as çlirimet e mëdha, madje as çlirimin e Mekës, që ka qenë dashur të zgjedhin ato si fillim të historisë. Në dritën e zakonit dhe traditës së historisë, madje është e çuditshme se ata nuk e zgjodhën as shfaqjen e misionit të Pejgamberit a.s., por hixhretin e konsideruan fillim i historisë. Ja këtu fshihet një rëndësi, madje edhe madhështia e hixhretit në vizionin e këndvështrimit islam!

Përktheu nga gjuha arabe: Mulaim Shehu

- 1 Sufjan el’Hatashenshir (ar. سفیان الحناتششر) Rrjeti “Delilu er’Rijf” 15.10.2015.
- 2 هجرة d.m.th. emigrim, migrim, migracion, dyndje, shpërngulje, kurse ne gjatë përkthimit e kemi përdorur vetëm fjalën shpërngulje
- 3 Arnold Tojbani (ar. أرنولد تويبنى).
- 4 D.m.th. shpërngulja
- 5 Shpërngulja intelektuale dhe akaidore’ (الهجرة الفكرية و العقائدية)

Kënaqësia e adhurimeve në zemrën e besimtarit

Isa Tershani

Islami kur urdhëroi me adhurim ndaj Allahut, në fakt me këtë synoi që ta çlirojë njeriun nga skllavëria e cila e kishte përcjellë atë për shumë vite nga mbretërit e tokës dhe liderët despotë.

Kënaqësinë e ushqimeve e ndjenë trupi, e kënaqësinë e adhurimeve e përjeton zemra dhe shpirti. Allahu xh.sh., e ka krijuar njeriun në formën më të bukur dhe gjithçka në gjithësi e ka ofruar në shërbim të tij. Njeriun, të cilin e ka caktuar si udhëheqës në tokë, e ka pajisur me aftësi të larta të cilat nuk i janë dhënë asnjë krijese tjetër, siç janë shfrytëzimi-përdorimi i mendjes, logjika, meditimi dhe vullneti i lirë. Nga njeriu të cilit i janë dhënë këto veti ka kërkuar vetëm t'i dorëzohet Atij. Në lidhje me këtë duhet thënë se nënshtrimi ndaj Allahut nuk duhet kuptuar me logjikën e zotërisë dhe të skllavit, pra ta adhurosh Atë, pa pasur të drejtën e lirë të zgjedhjes. Përkundrazi, robëria ndaj Allahut do të thotë që, duke shfrytëzuar lirinë e

zgjedhjes, pra në bazë të dëshirës së lirë, të respektosh vullnetin-urdhërat e Allahut xh.sh.; të braktisë dëshirat dhe kërkesat e epshit (nëfsit) dhe të jetosh në përputhje me porositë e Allahut të Madhëruar. Ibadeti-adhurimi si e drejtë e Allahut mbi robërit e Tij përmban kërkesën që njeriu të jetojë gjithnjë me vetëdijen e falënderimit ndaj Allahut, i Cili i fali njeriut gjithçka posedon.¹

Është një pyetje që i lind njeriut në kokë në kohën e kthjelltësisë së trurit, edhe në gjendjen e meditimit të tij me vetveten, e ajo është: Pse jam krijuar? Çfarë është synimi i krijimit tim? Kjo pyetje ka qenë pikë hulumtimi dhe mendimi i filozofëve, por ata s'arritën që të gjejnë një mendim konstant për zgjidhjen e sekreteve të këtyre pyetjeve.



Filozofi gjerman Kanti, mendon se çështjet më madhështore e më të ndërlikuara të filozofisë janë tri:

E para, çfarë mund të njohim ne?;

E dyta, çfarë duhet të veprojmë ne?;

E treta, çfarë shpresojmë dhe në çka i kemi të lidhura shpresat tona?

Kurani iu përgjigjet këtyre problemeve dhe qartëson se qëllimi i krijimit të njeriut është adhurimi-ibadeti ndaj Allahut. Për këtë i Lartëmadhërishtmi ka thënë: “Unë nuk krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër, pos që të më adhurojnë Mua.” (Edh Dharijat, 56).

Nga ajeti i lartpërmendur kuptojmë se ardhja e njeriut dhe jeta e tij në këtë botë është për ta adhuruar Zotin xh.sh.. Adhurimi-ibadeti është nënshtrueshmëria dhe përlësia e skajshme me bindshmëri të plotë vetëm ndaj Allahut, e kjo nënkupton mosnënshtrimin ndaj asnjë qenie tjetër që jeton në këtë tokë, sepse që të gjitha janë vetëm krijesa të Allahut, dhe kjo është ajo që e ka proklamuar Kurani: “...vendimi (në çështjen e adhurimit) nuk i takon kujt, pos Allahut, e Ai urdhëroi të mos adhuroni tjetër vetëm Atë...” (Jusuf, 40). Pastaj ajeti tjetër: “Ky është Allahu, Zoti juaj, nuk ka të adhuroar përveç Tij, Krijues i çdo sendi, pra adhurojeni Atë; Ai është mbikëqyrës ndaj çdo sendi.” (El En'am, 102).

Islami kur urdhëroi me adhurim ndaj Allahut, në fakt me këtë synoi që ta çliroj njeriun nga skllavëria e cila e kishte përcjellë atë për shumë vite nga mbretërit e tokës dhe liderët despotë, si dhe nga klerikët fetarë të hyjnizuar, dhe dëshiroi që t'ua hiqte nga koka atë iluzion se ata (të hyjnizuarit) janë të krijuar prej një elementi më të dalluar, dhe se në dorën e tyre është edhe dobia e edhe dëmi.² Zoti i Lartmadhërishtëm thotë: “Thuaju: A adhuroni pos Allahut atë që nuk mund t'ju sjellë as dëm e as dobi? Allahu është që dëgjon (ç'thoni) që di (ç'veproni).” (El Maide, 76).

Adhurimi i Allahut xh.sh., mund të bëhet përmes çdo veprë të njeriut, e cila ka për synim kënaqësinë e Allahut. Kështu që çdo veprë që myslimani e bën, mund të llogaritet veprë e adhurimit, nëse qëllimi është i pastër vetëm për hir të Zotit xh.sh..

Vepra më e rëndësishme e adhurimit për myslimanët është përpjekja për ta jetësuar rendin dhe ligjin e Allahut në tokë dhe për ta pasuar mënyrën e jetesës që Ai e ka caktuar, kështu derisa Islami të udhëheqë me jetën e individit, familjes dhe shoqërisë. Ky është një

mision, që i jep myslimanit ndjenjën e vërtetë të përkatësisë së tij në Islam dhe është e vetmja gjë që do ta bëjë t'i bashkohet radhëve të myslimanëve besimtarë dhe të zellshëm dhe do t'i japë jetës së tij kuptim, siç i përshtatet rolit të tij si mëkëmbës në tokë, atë të cilin Allahu i Madhëruar e ka preferuar para krijesave të tjera.³ Zoti xh.sh., në Kuran thotë: “Ne vërtet nderuam pasardhësit e Ademit (njerëzit), u mundësuam të udhëtojnë hipur në tokë e në det, i begatuam me ushqime të mira, i vlerësuam ata (i lartësuam) ndaj shumicës së krijesave që Ne i krijuam.” (El Isra, 70).

Adhurimet ndahen në dy pjesë: adhurimet që kryhen me gjymtyrë dhe adhurimet që kryhen me zemër. Adhurimet që kryhen me gjymtyrë janë si: namazi, agjërimi, haxhi etj., kurse ato që kryhen me zemër janë: falënderimi, sinqeriteti, lutja, pendimi etj.. Pejgamberi a.s., na tregon në shumë hadithe se sjelljet e mira dhe qëndrimet korrekte të cilat reflektohen në dimensione të ndryshme të jetës, mund të vlerësohen si adhurime, siç janë, gjykimi me drejtësi ndërmjet njerëzve, urdhërimi për punë të mira dhe ndalimi nga të

këqijat, përhëndetja me selam e atij që e takon, largimi i pengesave nga rruga që i pengojnë kalimtarët etj.. Gjithashtu, ibadet konsiderohet edhe bamirësia ndaj prindërve, fshirja e lotëve nga sytë e një të ngrati, përkëdhelja e kokës së një jetimi, respekti ndaj të moshuarit dhe buzëqeshja me besimtarin që e takon e shumë e shumë të tjera.⁴


Përmes këtyre veprimeve që u përmendën e shumë të tjera që nuk i kemi cekur, Pejgamberi a.s., po na tregon se Zoti i Madhëruar dëshiron që robi i Tij ta kalojë jetën me një vetëdije-ndërgjegje të këtyllë të adhurimit, duke na thënë me një hadith kudsij: “O biri i Ademi? Në çdo situatë më adhuro Mua që të ta pastroj shpirtin dhe të t'i plotësojë nevojat! Nëse nuk vepron kështu, të preokupojë me gjëra të tjera dhe nuk do të plotësohen nevojat tua.”⁵

Adhurimet që kryhen me gjymtyrë kanë një kohë të caktuar dhe shpërblehen vetëm për atë kohë që e ke kryer adhurimin, kurse adhurimet e zemrës nuk kanë kohë dhe vend, shpërblimi i tyre shtohet në vazhdimësi.⁶

NDIKIMI I ADHURIMIT TE BESIMTARI

Ibadeti si e drejtë e Allahut mbi robërit e Tij, përmban kërkesën që njeriu të jetojë gjithnjë me vetëdijen e falënderimit ndaj Allahut, i Cili i fali njeriut gjithçka që posedon.

Ibadeti si e drejtë e Allahut mbi robërit e Tij, përmban kërkesën që njeriu të jetojë gjithnjë me vetëdijen e falënderimit ndaj Allahut, i Cili i fali njeriut gjithçka që posedon.



mund të vendosë lidhje komunikimi me Zotin. Është shprehje-prezantim i gjendjes së njeriut, pa ndonjë mjet apo ndërmjetësim të Krijuesi i Madhëruar, për çka njeriu gjithnjë ka nevojë. Mu për këtë shkak besimtari në çdo namaz lexon ajetet e sures El Fatiha: “Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve,... Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje kërkojmë ndihmë! ...”

Në këtë mënyrë myslimani e fillon punën duke e lavdëruar Allahun e Madhëruar dhe duke kërkuar ndihmë prej Tij. Ai me këtë e pranon pafuqinë e vet, i përulet Zotit të vet, kërkon ndihmë prej Tij dhe i lutet Atij që në vazhdimësi ta përforcojë udhëzimin dhe adhurimin ndaj Tij. Pikërisht kjo është vetëdija e ibadetit, ndërgjeshmëria e robërisë dhe kënaqësia e përjetimit të adhurimit.⁷ Nga kjo që u tha më lartë kuptojmë se të gjitha adhurimet, si dhe të gjitha veprimet dhe sjelljet e tjera që bëhen me qëllim të adhurimit, nuk mbeten vetëm me rregullimin e raporteve mes Allahut dhe robit të Tij, por ato përcaktojnë qëndrimet psiko-sociale të individit si dhe ndërtojnë strukturën e shoqërisë.

MYZHDEJA E MUADH B. XHEBELIT

Muadh b. Xhebeli r.a., ishte njëri nga sahabët e të Dërguarit e Allahut a.s., i cili kishte udhëtuar shumë herë me të. Në një rast, gjatë një prej këtyre udhëtimeve qëndronte në ulësen e prapme të shalës së kafshës së të Dërguarit të Allahut a.s.. Ky rast ishte njëri ndër momentet kur Muadhi fizikisht ishte më afër të Dërguarit të Allahut. Mes tyre gjendej vetëm pjesa e prapme (vetulla) e shalës. Muadhin, i cili qëndronte pas tij, i Dërguari i Allahu e thirri: “O Muadh!” Ai u përgjigj: “Urdhëro o i Dërguar i Allahut!” Pas pak i Dërguari i Allahu e thirri edhe njëherë në të njëjtën mënyrë, edhe Muadhi iu përgjigj njësoj. “Urdhëro o i Dërguar i Allahut!” Pasi ecën edhe pak i Dërguari i Allahut sikur dëshironte t’ia tërhiqte vëmendjen e bashkëbiseduesit në një temë të rëndësishme, edhe njëherë e thirri: “O Muadh!” Përsëri përgjigja e Muadhit ishte:

“Urdhëro o i Dërguar i Allahut!” Me këtë rast i Dërguari i Allahut e pyeti: “A e di të drejtën e Allahut mbi robërit e Tij?” Muadhi i Përgjigjet: “Këtë më së miri e di Allahu dhe i Dërguari i Tij”, Pejgamberi a.s., i tha: “E drejta e Allahut mbi robërit e Tij është që ata ta adhurojnë - t’i bëjnë ibadet dhe të mos i përshkruajnë shok asnjë send.” Pas një kohe të shkurtër përsëri thirri: “O Muadh!” Nuk e kishte përfunduar atë që kishte për të thënë. Por Muadhi iu përgjigj njësoj: “Urdhëro o i Dërguar i Allahut!” i Dërguari i Allahut vazhdoi: “Nëse veprojnë kështu a e di të drejtën e robërve ndaj Allahut?” Muadhi i përgjigjet: “Këtë më së miri e di Allahu dhe i Dërguari i Tij.” Atëherë ai tha: “E drejtë e robërve ndaj Allahut është që Ai të mos i dënojë ata.” Muadhi u emocionua nga këto që dëgjoji e pyeti: “O i Dërguar i Allahut, a t’i përgëzoj njerëzit për këtë lajm?” Kurse i Dërguari fisnik iu përgjigj: “Jo, mos i përgëzo, sepse (duke i besuar kësaj myzhdeje) mund të lirohen (neglizhojnë).”⁸

Ky hadith i Pejgamberit a.s., dhe shumë të tjerë që nuk i kemi përmendur janë sihariqe që e nxisin besimtarin në kryerjen adhurimeve dhe përjetimin e kënaqësisë së tyre. A mos të jemi falënderues ndaj Zotit për këtë fe dhe të mirat e saj!? Pa dyshim se po. Falënderimi i qoftë Allahut!

- 1 Islami nëpërmjet haditheve, Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, V. 2. f. 28.
- 2 Afif Abdul Fetah Tabbareh, Shpirti i fesë islame, Përktheu dhe përshtati nga arabishtja, mr. Driton Arifi, Prishtinë, 2020, f. 260.
- 3 Dr. Muhamed Ali el Hashimi, Muslimani ideal, Prishtinë, 2008, f. 34.
- 4 Islami nëpërmjet haditheve, Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, V. 2, f. 33.
- 5 Sunen et Tirmidhij, Mektebetu el Mearife lineshri ve tevzi, Botimi i tretë, Riad, 2008, 2466.
- 6 Amër Halid, Përmirësimi i zemrave, Furkan ISM, 2010. f. 119.
- 7 Islami nëpërmjet haditheve, Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, V. 2. f.29.
- 8 Sahih el Buhari, Daru el Gadi el Xhedid, Kajro, 2013, Kapitulli i xhihadit, 2856.

Bashkëjetesa e Muhamedit a.s. me të tjerët

Hfz. Mehas Alija

Një nga aspektet e udhëzimit pejgamberik, që sot i duhet secilit mysliman, pavarësisht se ku jeton dhe vepron, është sjellja dhe raporti me tjetrin, që beson dhe mendon ndryshe nga ai. Biografë të ndryshëm, myslimanë dhe jomyslimanë, duke e analizuar jetën e Muhamedit a.s. dhe të bashkësisë së parë myslimane, e ndajnë atë në rrethana apo mjedise të ndryshme jetësore, gjegjësisht në Meke si minoritet, në Abisini si emigrantë, dhe në Medinë, si qytetarë qeverisës dhe shtetformues.

Diversiteti shoqëror që përshkon këto periudha, varësisht vendit dhe rrethanës, dallon me sfidat dhe problemet, por edhe me zgjidhjet karakteristike. Duke analizuar periudha të caktuara të veprimtarisë së Muhamedit a.s., organizimit shoqëror në mjedise multikonfesionale e multinacionale, vihet në pah se në momente të caktuara, bashkëjetesa, ndërtimi i paqes dhe sigurisë në shoqëri apo edhe ndërmjet popujsh, kërkon jo vetëm ide dhe mendim, por edhe veprim praktik në përputhje me realitetin dhe aktualitetin.

Muhamedi a.s. gjatë njëzet e tre vjetëve të jetës së tij pejgamberike, veprimi ashtu siç e ka përshkruar Allahu xh.sh. në ajetin fisnik: “Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët.” (El Enbija, 107).¹

Ai ishte mishërimi i mëshirës, drejtësisë, bashkëjetesës paqësore dhe tolerancës. Me “mandatin” e tij pejgamberik, ai demonstroi vlerat shoqërore dhe njerëzore të Islamit. Pejgamberi a.s. i dha çdo njeriu të drejtën dhe lirinë e tij, pavarësisht fesë dhe origjinës, ndërsa raportet ndërnjerëzore i ndërtoi mbi bazën e besimit të ndërsjellë dhe të nderimit të dinjitetit njerëzor.

Në këtë punim paraqitet bashkëjetesa dhe strategjia e Muhamedit a.s., me bashkësinë e parë myslimane, në tri periudha të ndryshme kohore, në mjedise me shoqëri pluraliste, dhe me sfida të cilat nuk i ngjasonin njëra-tjetrës.

DIVERSITETI SHOQËROR NË MEKE DHE MYSLIMANËT SI MINORITET

Mjedisi i parë ishte Meka, vendlindja e Muhamedit a.s. dhe e sahabëve të tij të parë. Në të, myslimanët ishin pakicë, minoritet, brenda një mjedisi armiqësorë. Qyteti i Mekës banohej dhe sundohej nga fisi arab kurejshitë. Ky ishte një qytet ku sundonte një oligarki prej dhjetë familjeve më në zë. Në mesin e tyre, si dy klanet më kryesore ishin familjet, Benu Umejje dhe Benu Hashim.² Muhamedi a.s. i takonte fisit Benu Hashim, që njëherësh ishte edhe familja që kishte në dorë pushtetin fetar.³ Sado që ta kishin ruajtur idenë për Zotin, fiset dhe banorët e Mekës ishin idhujtarë, pasi

Bashkëjetesa, ndërtimi i paqes dhe sigurisë në shoqëri apo edhe ndërmjet popujsh, kërkon jo vetëm ide dhe mendim, por edhe veprim praktik në përputhje me realitetin dhe aktualitetin.



krahas idesë për Zotin Një, ata besonin në idhuj që u shërbenin si ndërmjetës ndërmjet tyre dhe Zotit.⁴ Përveç organizimit fisnor, në shoqërinë mekase ishte e zhvilluar theksueshëm edhe rendi klasor, ku shoqëria ndahej në zotërinj dhe skllëvër.⁵ Në këto rrethana shoqërore, sociale dhe gjeopolitike, paraqitja e bashkësisë së parë myslimane, me në krye Muhamedin a.s., si Pejgamber i Zotit dhe bartës i kauzës islame, nxiti indignatën dhe reagimet e ashpra të parisë së Mekës, kështu që u krijua një mjedis armiqësorë në qytet. U ndërmorën iniciativa të ndryshme kundër besimtarëve të rinj myslimanë, përfshirë përndjekjet, burgosjet, sulmet, vrasjet, bojkotin, internimin, etj.⁶ Ndonëse në një ambient armiqësorë dhe të papërshtatshëm për paqe dhe liri fetare, Muhamedi a.s., dha shembullin ideal për ruajtjen e harmonisë dhe bashkëjetesës ndërqytetare, ndërfetare dhe ndërfisnore në qytetin e tij të lindjes dhe të rrethinës së Mekës.⁷ Këtë do ta ilustrojmë me dy shembuj vijues:

Nga qëndrimet madhështore të sjelljes së lartë dhe mëshirës së tij ishte qëndrimi që pati kur u kthye nga Taifi. Pejgamberi a.s. shkoi ta ftojë popullin e atij qyteti në fe, por në vend që ta pranonin fenë e Zotit, apo së paku të rrinin indiferentë, ata u tallën me të, madje, për më tepër, edhe e përdoqën. Nuk u mjaftuan vetëm të rriturit, e sidomos të fisit Thekif, por me të dalë Pejgamberi a.s. nga Taifi, ata i nxitën fëmijët që ta gjuanin me gurë, saqë ia gjakosën edhe këmbët e tij. Megjithatë torturë të talljes, nënçmimit dhe armiqësisë që treguan ndaj tij, ai a.s. përsëri ishte zemërgjerë, dhe sillej ndaj tyre si prindi ndaj fëmijës. Prandaj nga mëshira dhe dhembja që pati ndaj tyre, megjithatë tmerr që përjetoj nga ata, ai përsëri atyre ua fali dhe u lut për ta: “Unë më tepër shpresoj se Zoti do të nxjerr nga pasardhësit e tyre njerëz të tillë që do

të adhurojnë vetëm Allahun Një, duke mos i bërë rival me asgjë tjetër Atij!”⁸

Gjithashtu, një qëndrim tjetër madhështor i faljes kolektive ishte veprimi i Pejgamberit a.s. me banorët e Mekës me rastin e çlirimit të saj. Ata më parë e kishin dëbuar nga vendlindja, e kishin torturuar, persekutuar e përndjekur në mënyrat më mizore, dhe shumica e tyre ishin ende gjallë, dhe akoma e luftonin me të gjitha mjetet dhe mënyrat, deri në momentet e çlirimit të Mekës. Pejgamberi a.s., pasi e bëri tavafin rreth Qabesë, u ndal në derën e saj, ndërkohë mekasit ishin tubuar aty, të cilët ende ishin idhujtarë. E mbajti një fjalim të shkurtër, me çrast iu drejtuar të pranishmëve: “O fisi Kurejsh! Çka mendoni, si do të veprojnë unë me ju?” I thanë: “Do të veprosh me të mirë, ti je një vëlla fisnik, i biri i një fisniku!” Ai iu tha: “Unë po u them ashtu siç u tha Jusufi a.s. vëllezërve të tij: Nuk ka qortim për ju sot. Shkoni, ju jeni të lirë!”⁹

Pra, çfarë mund të mësojmë tjetër nga përvoja dhe trashëgimia profetike e periudhës së Mekës, dhe si arriti Muhamedi a.s. ta ruajë paqen dhe kohezionin shoqëror brenda këtyre përplasjeve? Në radhë të parë, për arritjen e këtij qëllimi, duhej fokusuar te konceptimi i disa parimeve morale dhe edukative, duke i dhënë rëndësi të madhe, fillimisht, vëllazërisë dhe bashkëpunimit të ndërsjellë midis myslimanëve. Në këto rrethana, për herë të parë, filloi të respektohej e drejta e individit mbi shoqërinë.¹⁰ Brenda kushteve të këtyre bashkëjetesës dhe Pejgamberit a.s. me të tjerët në Meke, ndonëse me tensione, vazhdoi të jetojë për trembëdhjetë vite me radhë, deri në shpërnguljen e tij në Medinë.

Për të jetuar në një shoqëri të këtyre, ku aty bëjnë pjesë njerëz me besime dhe bindje të ndryshme, besimtarë dhe

jobesimtarë, myslimanë dhe jomyslimanë, sidomos kur myslimanët janë pakicë, duhet të ndiqet vija e edebit dhe moralit islam, si dhe principet e shëndosha për kontakte të mira me të tjerët. Myslimani i vërtetë nuk i shpërfill vlerat morale, madje edhe kur luftohet dhe është në armiqësi me dikë, apo edhe në rastet kur i bëhet padrejtësi. Është një fakt i njohur që tregon për besnikërinë e Muhamedit a.s., se, edhe në ditët e fundit të qëndrimit të tij në Mekë, ai vazhdonte t'i ruante gjësendet e mekasve që ia kishin lënë si amanet.¹¹

Për kohën tonë, një mysliman që jeton në një vend a shtet jomysliman, nuk guxon t'ia lejojë vetes që ta shkatërrojë apo ta vjedh pasurinë e jomyslimanit, apo të tradhtojë besimin e tyre që kanë në të, me pretekstin se është jomysliman apo armiqësor ndaj Islamit. Përkundrazi, midis tyre duhet të ketë momente reflektimi, ku do të tregojë mirësjellja e lartë e njerëzve të virtytshëm, të pastër në shpirt dhe në vepra.¹²

Për një bashkëjetesë të mirë dhe të qëndrueshme ndërmjet feve, kulturave dhe etnive të ndryshme, bazuar në përvojën dhe veprimtarinë e bashkësisë së parë myslimane në periudhën e Mekës, myslimani nuk duhet të jetojë i distancuar dhe i izoluar, porse të tregohet shembullor në veprim, integrim dhe në bashkëpunim me të tjerët në të mirë të shoqërisë dhe të vendit, e assesi në dëm dhe në mëkate. Besimtari mysliman është aktiv në shoqëri dhe, gjithnjë, mundohet ta shfrytëzojë mundësinë dhe lirinë për ta prezantuar fenë dhe mësimet e saj, pavarësisht se ku jeton e ku vepron, pa ofenduar dhe pa dëmtuar askënd.

MYSLIMANËT NË TRUALL TË HUAJ (MIGRIM)

Represioni u rrit dukshëm në Mekë dhe sprovat për myslimanët bëheshin të rënda e më të rënda, ndërkohë Muhamedi a.s. me shokët mendonin rrugëdaljen. Si mundësi të vetme shpëtimi e panë shpërnguljen, fillimisht, në Abisini, e më pas në qytetin e Jethribit. Për grupin e parë që bënë hixhret në Abisini, Muhamedi a.s. kishte një porosi: "Në këtë vend është një mbret që është i drejtë, ku askujt nuk i bëhet padrejtësi në prani të tij. Shkoni atje dhe bëni durim derisa Allahu xh.sh. të bëjë rrugëdalje për ju."¹³

Edhe pse pa Muhamedin a.s., myslimanët në Abisini shfaqën edukatën e fituar për disa vite në Meke nga edukatori më i mirë i njerëzimit, Pejgamberi a.s.. Në lidhje me raportet dhe marrëdhëniet që kishin myslimanët me mbretin abisinas, Nexhashiun, Ummu Seleme r.a., tregon: "Derisa ne ishim në Abisini, u paraqit një njeri i cili ishte ngritur kundër mbretit. Pasha Zotin, na kaploi trishtimi dhe frika, se mos, vallë, ky njeri i rebeluar do ta rrëzojë mbretin dhe pastaj do të na mohoheshin të drejtat tona që na i kishte ofruar Nexhashiu."¹⁴ Ajo tregon më tej se e kishin lutur Allahun xh.sh. që ta ndihmonte Nexhashiun kundër këtij kryengritësi, ndërkohë që kur ishin informuar se fitorja i kishte takuar mbretin

Nexhashi, myslimanët kishin përjetuar një gëzim të madh dhe kishin falënderuar Zotin e Gjithësisë për këtë fitore. Sahabët, shokët e Pejgamberit a.s., të cilët ishin rreth tetëdhjetë veta,¹⁵ jetuan me Nexhashiun dhe qytetarët abisinasë në harmoni të plotë, me dashuri dhe respekt të ndërsjellë. Sjellja e mirë dhe prezantimi i drejtë i fesë islame nga ana e myslimanëve ndikoi që Nexhashiu, më në fund, ta pranojë edhe Islamin.¹⁶

Këtë më së miri na e dëshmon diskutimi dhe paraqitja shembullore e Xhafer bin Ebi Talibit r.a., i cili foli para masës dhe përpara mbretit Nexhashi, ku tregoi për fenë islame, për besimin islam mbi Isain a.s. dhe nënën e tij, hz. Merjemen, etj.. Ndër të tjera, Xhaferi r.a. tha: "O mbret! Ne ishim një popull injorantë... Kështu ishim derisa Allahu e dërgoi te ne Pejgamberin nga mesi ynë... Ai na thirri që ta besojmë e ta adhurojmë Allahun si një dhe të vetëm... Na urdhëroi që ta flasim të vërtetën, ta kryejmë amanetin dhe ta afrojmë fafesisin. I besuam dhe iu bindim atij. Kur na nënçmuan, na bënë padrejtësi dhe na shtrënguan, dolëm për në vendin tënd dhe shpresuam se te ti nuk do na bëhet padrejtësi."¹⁷ Më pas vazhdoi që t'i flas për Isain a.s. dhe për hazreti Merjemen, referuar shpalljes, respektivisht ajeteve që flasin në lidhje me këtë temë, derisa mbretit iu zbut zemra dhe i rrodhën lotët,¹⁸ ndërsa ndaj myslimanëve e shtoi përkrahjen, u siguroi strehim dhe u dha mbështetje.¹⁹

Së këndejmi, nëse e krahasojmë performancën dhe qëndrimin e Xhafer ibën Ebi Talibit dhe të sahabëve të tjerë që ndodheshin në Abisini, me performancën dhe qëndrimin e disa individëve të cilët sot shkojnë në Perëndim dhe kërkojnë azil, vendstrehim dhe siguri, do të shohim një ndryshim të madh midis tyre. Këta individë komunikojnë me jomyslimanët dhe qytetarët e shteteve ku ata shkojnë në mënyrë të ashpër, me kryelartësi dhe nënçmim, duke e lartësuar veten dhe duke mos dashur të bashkëjetojnë me ta. Ata insistojnë në dallime, mohojnë vlerat e të tjerëve dhe flasin kundër tyre, duke besuar kështu se në këtë mënyrë e ruajnë Islamin dhe vlerat e tyre fetare dhe nacionale!²⁰

DIVERSITETI SHOQËROR DHE BASHKËJETESA NË MEDINË

Me shpërnguljen e myslimanëve dhe të Muhamedit a.s. në qytetin e Medinës, ndryshuan sfidat, ndërsa mjedisi i ri solli probleme të reja dhe kërkesat e shoqërisë ishin ndryshe nga ato të Mekës dhe Abisinitë.

Për shkak të diversitetit dhe dallimeve sociale dhe shoqërore në shoqërinë medinase, çështja e bashkëpunimit dhe bashkëjetesës qytetare ishte sfidë në vete dhe provë e madhe. Ky diversitet u paraqit për shkak se në Medinë erdhën myslimanët mekasë dhe u bashkuan me myslimanët e rinj medinasë, pastaj në qytet u shfaqën mynafikët, hebrenjtë dhe politeistët. Po ashtu, në këtë mjedis të rinj kishte edhe grupe

të tjera etnike: arabë, abisinas, persian dhe jehudi. Madje dallimet shkonin edhe më tej, ku shoqëria ishte e ndarë në klasa, që do të thotë se disa qytetarë ishin zotërinj, kurse disa të tjera ishin skllëvër të tyre. Vetëm mund ta imagjinojmë se sa të vështirë e pati Muhamedi a.s. t'i bashkonte të gjithë këta grupe! Por, vallë, si veproi Pejgamberi a.s.?

Ndër fjalët e para të Muhamedit a.s. në Medinë ishin: "O njerëz! Përhapeni selamin! Ushqeni të uriturit!"²¹ Ky ishte një sinjal i paqes për banorët e Medinës, ndërkohë që aty jetonin në armiqësi e luftëra dy fise, Evs dhe Hazrexh, të cilët, për gjëra edhe shumë të vogla dhe të parëndësishme, nisnin luftën dhe vrisnin njëri-tjetrin.²²

Në fakt, Muhamedi a.s., fillimisht, u fokusua në formimin e ekipeve të punës, u përgatit strategjia e veprimtarisë dhe insistoi që t'i bashkojë grupet rreth një qëllimi, e që ishte ndërtimi i xhamisë.²³ Me këtë rast i bashkoi radhët e myslimanëve dhe si objektiv kryesor ngriti ndërtimin e institucionit, të quajtur xhami. Ndërtimi i xhamisë u paraqit si një projekt nacional, i cili do t'i shkrinte dallimet ndërmjet myslimanëve, muhaxhirëve dhe ensarëve, si dhe të fiseve medinase, që deri në këtë kohë, kishin qenë në armiqësi të vazhdueshme. Për ta forcuar edhe më tepër këtë lidhje bashkimi, Pejgamberi a.s. bëri vëllazërimin e ensarëve (medinasve) dhe muhaxhirëve (mekasëve), proces ky i cili i afrooi edhe më shumë.²⁴ Vëllazërimi apo binjakëzimi ishte një ide inovative në rrugën drejt tejkalimit të problemeve ekonomike dhe sociale.

Me bashkimin e myslimanëve u arritën dy kushte themelore për formimin e qytet/shtetit të parë, përkatësisht u arrit organizimi i qytetarëve dhe sigurimi i territorit.²⁵ Në fazën tjetër u nënshkrua Karta e Medinës,²⁶ që i përfshinte të gjithë banorët e Medinës, e cila i rregullonte të drejtat dhe detyrimet e tyre, ndërsa përfaqësimi i komunitetit iu dha Muhamedit a.s. Me këtë akt u arrit kushti i tretë për krijimin e shtetit, e që është ekzistimi i një qeverisjeje të organizuar politike, mbi bazën e një marrëveshjeje qytetare.²⁷

Me kohë, qyteti i Medinës u shndërrua në një qytet/shtet, ku dallimet shoqërore u reduktuan dhe qytetarët jetonin me të drejtat e tyre të garantuara me Kartën e përpiluar. Kjo është koha kur myslimanët përfaqësonin shumicën dhe luanin rolin e garantuesit të të drejtave dhe lirive të pakicave jomyslimane në qeverinë islame.²⁸ Raportet ndërmjet myslimanëve dhe të tjerëve, në këtë rrethanë,



ndërtoheshin mbi bazën e dialogut, bashkëjetesës dhe drejtësisë.

**Muhamedi a.s.
mbeti
shembulli më i
mirë për
gjenerata dhe
sisteme të tëra
më vonë,
mbase edhe
sot e kësaj dite,
sidomos për
myslimanët që
jetojnë në
Evropë.**

Dy grupet më të dalluara në Medinë ishin mynafikët dhe hebrenjtë. Këta të fundit posedonin tregjet e tyre, administronin zejet dhe financat e tyre,²⁹ dhe jetonin në harmoni me myslimanët. Vetë Muhamedi a.s. kishte kontakte të hapura me ta, madje, thuhet se edhe në momentet e fundit të jetës së tij kishte pasur një borxh të një jahudi, të cilit i kishte lënë si garanci parzmoren e vet.³⁰

Hebrenjtë në këtë fazë të zhvillimit të Medinës nuk dalloheshin si grupe të pavarura, të marginalizuara, që jetonin në kështjella apo lagje të ndara, porse si qytetarë që jetonin dhe lëviznin lirshëm në rrugët e qytetit.

Imam Buhariu e ka shënuar ngjarjen që flet për vizitën e Muhamedit a.s. te një djalë i ri hebre, i cili ishte i sëmurë. Kur Pejgamberi i Zotit i propozoi djaloshit që ta pranojë Islamin, prezent ishte edhe babai i të riut, i cili, pa hamendje, i kërkoi të birit që ta përqafojë fenë islame. Njeriu i tha të birit që ta pranojë Islamin, ndërkohë vetë mbeti në bindjet dhe fenë e tij.³¹ Ky, pra, është një argument se Muhamedi a.s. nuk ka shtrënguar dhe nuk ka detyruar askënd për ta pranuar Islamin.

Krahas hebrenjve, në qytetin e Medinës jetonin edhe grupe të tjera, siç ishin mynafikët dhe dezertorët. I ndihmuar nga shpallja, Muhamedi a.s. i njihte dhe i dinte mirë emrat

e tyre, mirëpo asnjëherë nuk i zbuloi dhe as i turpëroi përpara njerëzve. Ata vazhduan të jetojnë në Medinë edhe pas vdekjes së Pejgamberit a.s. dhe askush nuk mori iniciativë për t'i persekutuar apo larguar nga vendi.³²

Mynafikët e Medinës ishin një grup i veçantë shoqëror, veprimtaria e të cilit ishte shumë e rrezikshme dhe problematike, sidomos e prijësit të tyre, Abdullah ibën Ubej ibën Selul.³³ Ky njeri bëri shumë vepra të këqija, mirëpo raporti i Pejgamberit a.s. ndaj tij ishte shumë njerëzor dhe i mirësjellshëm. Mjafton të theksohet fakti se Muhamedi a.s. e vizitonte gjersa ai ishte në shtratin e vdekjes, dhe kur vdiq, ia fali namazin e xhenazes dhe e mbështolli me këmishën e tij në vend të qefinit.³⁴

Kështu i trajtoi i Dërguari i Allahut a.s. banorët që jetonin së bashku me myslimanët në qytetin e Medinës, duke i dhënë botës shembullin ideal të një bashkëjetese paqësore me të gjithë qytetarët, pa provokime armiqësore dhe pa nxitje të trazirave. Shembujt e tillë janë frymëzim për të gjithë kohët se si jetohet në harmoni me tjetrit dhe të ndryshmin, për një jetë më të bukur dhe bashkëjetese paqësore.

Ky ishte Pejgamberi i Zotit, i fundit në zinxhirin e pejgamberisë, dhe këta ishin myslimanët e parë, të cilët, si qytetarë të ndershëm, ofruan shembullin më të mirë ideal të bashkëjetesës dhe mirëkuptimit shoqëror me të gjithë qytetarët, pa provokuar dhe pa nxitur asnjëherë armiqësi. Mëshira e tij nuk përfshiu vetëm myslimanët, por edhe secilin njeri, pavarësisht besimit, bindjes, etnisë, kulturës dhe racës. Në secilin vend që shkoi dhe jetoi, dëshmoi se ishte në gjendje të bashkojë fraksione të ndryshme, duke krijuar një standard shembullor për bashkëpunim me të tjerët. Ai kaloi pa probleme nga gjendja e një të përndjekuri në gjendjen e një drejtuesi me shumë përgjegjësi administrative dhe ligjore. Modeli i bashkëjetesës së Pejgamberit a.s. shënon rregullat e jetës në një shoqëri pluraliste, është një model që duhet studiuar dhe që botës moderne do t'i shërbente shumë sa i përket një ambienti dhe mjedisi shoqëror multikulturor, multinacional dhe multifetar.

Muhamedi a.s. mbeti shembulli më i mirë për gjenerata dhe sisteme të tëra më vonë, mbase edhe sot e kësaj dite, sidomos për myslimanët që jetojnë në Evropë, duhet të kthehet në stil jete në raport me të tjerët.

1 Sipas: Sherif Ahmetit, Kur'ani – përkthim me komentim në gjuhën shqipe, versioni elektronik: <https://kuran-index.com/>.

2 Muhamed Hamidullah, Muhamedi a.s., jeta pj. I., (Logos-A, Shkup, 2011), fq. 34.

3 Po aty, fq. 34.

4 Po aty, fq. 33.

5 Yücel Men, "Përpjekjet e Profetit Muhamed a.s. kundër skllavërisë", Portali Bota Islame, në: <https://bota-islame.com/perpjekjet-e-profetit-muhamed-a-s-kunder-skllaverise/> (parë së fundmi më 02.02.2023).

6 Ibën Hisham, Biografia e Pejgamberit s.a.v.s., (Logos-A, Shkup, 2017), fq. 78-88.

- 7 Dr. Zija Abdullahi, Koncepti i perceptimit të tjetrit nga muslimani, kapitulli: "Koncepti pejgamberik ndaj tjetrit", (versioni elektronik, pa vit botimi), fq. 1-2.
- 8 Sahihu i Muslimit, nr. 3353, cituar sipas: dr. Zija Abdullahi, op.cit., fq. 1-2.
- 9 Muhamed Gazali, Fikhu Sira, analizë e jetës së Profetit a.s., (Furkan ISM, Shkup, 2011), fq. 458-470.
- 10 Sikur që ishte ndihma dhe kontributi i hz. Ebu Bekrit r.a., i cili u ndihmonte të dobëtëve, i blinte robërit dhe ua falte lirinë, etj. Muhamed Gazali, op.cit., fq. 118.
- 11 Shih më shumë: dr. Zija Abdullahi, Koncepti i perceptimit të tjetrit nga muslimani, kapitulli: "Koncepti pejgamberik ndaj tjetrit", (versioni elektronik, pa vit botimi), fq. 2.
- 12 Grup autorësh, Vesatijja – suvremena islamska apologetika, (Qendra për Studime të Avansuara, Srajevë, 2018), fq. 216.
- 13 Muhamed Hamidullah, Muhamedi a.s., jeta pj. I., (Logos-A, Shkup, 2011), fq. 97.
- 14 Vesatijja..., op.cit., fq. 216.
- 15 Ibën Ishaku thotë se numri i burrave ishte 83, ndërsa burime të tjera theksojnë se numri i grave ka qene rreth 12 apo 18. Shih më gjerësisht: Dr. Bashkim Aliu, Muhamedi, pishtari ndriçues, (CICRA, Prishtinë, 2021), fq. 181. Po ashtu: Safijurrahman el Mubarekfuri, Nektari i vulosur i xhenetit, (Prishtinë, 2004), fq. 110.
- 16 Dr. Bashkim Aliu, op.cit., fq. 184.
- 17 Dr. Muhamed Seid Ramadan el Buti, Fikhu Sire, (Shkup, 2018), fq. 125.
- 18 Ibën Hisham, op.cit., fq. 94.
- 19 Dr. Muhamed Seid Ramadan el Buti, op.cit., 125.
- 20 Vesatijja..., op.cit., fq. 217.
- 21 Dr. Kenan Music, U susret Resulullahu, (Sarajevë, 2015), fq. 117. Po ashtu: Ibën Hisham, op.cit., fq. 150.
- 22 Ibën Hisham, op.cit., fq. 150.
- 23 Safijurrahman el Mubarekfuri, op.cit., fq. 215-216.
- 24 Kenan Music, op.cit., fq. 120-121. Po ashtu: Muhamed Hamidullah, op.cit., fq.15-159. Po ashtu: Safijurrahman el Mubarekfuri, op.cit., fq. 216.
- 25 Vesatijja..., op.cit., fq. 218.
- 26 Karta e Medinës (ar. Sahifetu-l-medineh), në literaturën islame e njohur edhe si "Kushtetuta apo Statuti i Medinës", është një akti që, Muhamedi a.s., me gjasë në vitin e dytë të hixhretit, e ndërmoi për konstituimin e rendit shoqëror, i përbërë nga 52 nene, që trajtojnë myslimanët dhe jomyslimanët, të drejtat dhe detyrimet e përgjithshme, të veçanta dhe individuale. Kjo Kushtetutë i njohu hëmbënjhtë dhe komunitet e tjera, si pjesë përbërëse të bashkësisë, në aleancë me myslimanët, por duke ua ruajtur autonominë fetare dhe kulturore. Shih: John L. Esposito, Fjalor i Oksofidit për Islamin, (Logos-A, Shkup, 2017), fq. 194; Nexhat Ibrahim, Fjalor enciklopedik islam, (Logos-A, Shkup, 2017), fq. 457.
- 27 Muhamed Hamidullah, op.cit., fq. 161.
- 28 Safijurrahman el Mubarekfuri, op.cit., fq. 224.
- 29 Muhamed Hamidullah, op.cit., fq. 158.
- 30 Musnedi i Ahmedit, nr. 3334. Cituar sipas: dr. Zija Abdullahit, Koncepti i perceptimit të tjetrit nga muslimani, kapitulli: "Koncepti pejgamberik ndaj tjetrit", (versioni elektronik, pa vit botimi), fq. 15.
- 31 Buhariu në Sahih, nr. 1268. Cituar sipas: dr. Zija Abdullahi, Koncepti i perceptimit të tjetrit nga muslimani, kapitulli: "Koncepti pejgamberik ndaj tjetrit", (versioni elektronik, pa vit botimi), fq. 13.
- 32 Vesatijja..., op.cit., fq. 219.
- 33 Abdullah ibën Ubej ibën Selul, ishte prijës i fisit Hazraj dhe një ndër kandidatët potencial për t'u bërë udhëheqës i qytetit të Medinës, por me ardhjen e Muhamedit a.s., kjo ëndërr e tij mbeti e perealizueshme. Tradita islame thotë se ky, edhe pse publikisht kishte pranuar Islamin, fshehurazi lobonte kundër Pejgamberit a.s. dhe bashkësisë myslimane. Njihet edhe si kryemunafiku i Medinës. Vdiq në vitin 631 miladi. Më gjerësisht: "Abd Allah ibn Ubayy", në: https://en.wikipedia.org/wiki/Abd_Allah_ibn_Ubayy. (Parë së fundmi më 04.02.2023).
- 34 Ibën Kethir, El Bidaje ve Nihaje, vëll. IV, fq., 345.

Etika e pritjes së mysafirit bazuar në mësimet islame

Mr. Vedat Shabani

Nuk ka dyshim se respektimi, nderimi dhe mirëpritja e mysafirit është prej virtyteve të moralit të mirë, si dhe argument i qartë për fuqinë e imanit – besimit të tij.

Nëse vështrojmë me kujdes frymën e mësimave islame, vërejmë se ato në vazhdimësi ftojnë që njeriu të pajiset dhe të stilizohet me virtytet e moralit. Këto virtyte, Zoti xh.sh. i ka bërë sebeb që myslimani të futet në xhenet për shkak të respektimit të tyre. Kur është pyetur Pejgamberi a.s., se cilat janë veprat të cilat më së shumti ndikojnë për të hyrë në xhenet, ai a.s. ka thënë: “Frika-respekti ndaj Zoti xh.sh. dhe sjellja e mirë.”¹ Nuk ka dyshim se respektimi, nderimi dhe mirëpritja e mysafirit është prej virtyteve të moralit të mirë, si dhe argument i qartë për fuqinë e imanit – besimit të tij.

Prandaj, duke u bazuar në mësimet islame dijetarët kanë përmendur rregulla për mikpritjen e mysafirëve të cilat e ka për obligim çdo mysliman që t'i mësojë dhe zbatojë ato, për arsye se ato burimin e kanë nga shpallja hyjnore (Kurani dhe Suneti). Mikpritja e mysafirëve është prej veprave fisnike të cilat feja islame ka për qëllim t'i përmbush. Këtë e vërteton edhe hadithi i Pejgamberit a.s. ku ka thënë: “Vërtet jam dërguar për të përsosur moralin e mirë.”² Në vazhdim të këtij punimi do të përmendim disa rregulla të cilat ndërlidhen me mikpritjen dhe respektin ndaj mysafirit:

Nderimi, respektimi, përkujdesja ndaj mysafirit. Lidhur me këtë çështje kemi hadithin e Pejgamberit a.s. në të cilin ka thënë: “Kush beson në Zotin dhe Ditën e Gjykimit, le ta nderoj mysafirin.”³ Në bazë të

mësimeve islame, e drejta e mysafirit është tri ditë. Këtë e mbështesim edhe në hadithin të cilin e transmeton Ebu Shurejh el Adevij ku Pejgamberi a.s. ka thënë: “E drejta e mysafirit është tri ditë, pas tri ditësh ajo është mirësi vullnetare nga ana e mikpritësit.”⁴ Ndërsa në një hadith tjetër, Pejgamberi a.s. ka thënë: “Nuk i lejohet një burri mysliman që të qëndrojë te vëllai i tij derisa ta ngushtojë atë, d.m.th.: të qëndrojë mysafir derisa zoti i shtëpisë nuk ka çfarë t'i ofroj më.”⁵

Është e preferuar që kur të vjen një mysafir t'i shprehet mirëseardhje me zemërgjerësi dhe fytyrë të qeshur. Ibën Abasi r.a. tregon kur ka ardhur delegacioni i Abdulkajsit, Pejgamberi a.s. ju kishte drejtuar duke ju thënë: “Jeni të mirëseardhur, jeni të nderuar dhe të gëzuar.”⁶

Njëri prej dijetarëve mysliman, Ebu Lejth es Semerkandij ka thënë: “Mysafiri duhet t'u përmbahet katër gjërave; të ulet aty ku i caktohet vendi, të jetë i kënaqur me atë që i ofron dhe e respekton zoti i shtëpisë, të mos ngritët përveç pas marrjes së lejes nga zoti i shtëpisë, dhe të lutet për zotin e shtëpisë pasi të del nga shtëpia.”⁷

Ndërsa Ibën el Xhevzij ka thënë: “Prej edukatës së mysafirit është që mos të kërkojë ushqim të caktuar; e nëse i kërkohet të përzgjedh mes dy llojeve të ushqimeve, atëherë e udhës është që ta përzgjedh më të lehtë, përveç nëse e dinë se një gjë e tillë nuk e ngarkon aspak të zotin e shtëpisë.”⁸

Nëse ndonjëri shkon së bashku me mysafirin, atëherë është e udhës që në prezencë të zotit të shtëpisë të kërkoj leje për të. Kjo duke u mbështetur në transmetimin e Abdullah ibën Mesudit r.a., i cili tregon se një banor i Medinës i cili quhej Ebu Shuajb kishte një punëtor të cilin e porositi që ta përgatiste një darkë dhe ta ftonte të Dërguarin e Allahut së bashku me pesë persona të tjerë. Ai e ftoi Pejgamberin a.s. së bashku me pesë veta. Pejgamberit a.s. ju bashkëngjite një person tjetër. Kur arritën, Pejgamberi a.s. ju drejtua të zotit të shtëpisë duke i thënë: “Ti më ke ftuar mua së bashku me pesë persona, ky i gjashti na u bashkëngjite gjatë rrugës, prandaj, nëse donë i jep leje dhe nëse donë nuk e lejon.” I zoti i shtëpisë tha: “Ka leje gjithsesi.”⁹

I zoti i shtëpisë nuk duhet ta ngarkojë vetën jashtë mase për shkak të mysafirit. Kjo çështje ndërlidhet me shumë edhe me traditën e secilit popull. Kjo çështje mbështetet në hadithin të cilin e transmeton Imam Ahmedi, i cili tregon rastin kur një njeri kishte shkuar mysafir te Selman Farisiu. Selmani porositi familjen e tij që t’i sjellin ushqim, me atë rast ai iu drejtua mysafirit duke i thënë: “Sikur të mos na kishte ndaluar i Dërguari i Allahut që të mos bëhemi telashe, sigurisht se do të bënim përpjekje edhe më shumë.”¹⁰

Kërkimi i lejes me rastin e hyrjes në shtëpi dhe me rastin e daljes nga shtëpia. Është e udhës që mos ta ngarkojë zotin e shtëpisë, përveç në rast kur ai insiston që të qëndrojë ende. Lidhur me këtë Allahu xh.sh. ka thënë në Kuran: “O ju që besuat, mos hyni në shtëpitë e Pejgamberit ndryshe vetëm nëse u lejohet për ndonjë ngrënie e duke mos pritur përgatitjen e saj, por kur të thirreni, atëherë hyni, e kur të jeni ushqyer, atëherë shpërndahuni, duke mos hyrë në bisedë njëri me tjetrin...” (El Ahzab, 53).

Mysafiri duhet të lutet për të zotin e shtëpisë pas përfundimit nga ushqimi. Transmeton Enes ibën Maliku r.a., i cili tregon

se Pejgamberi a.s. shkoi te Sead ibën Ubade r.a., i cili i solli Pejgamberit a.s. bukë dhe vaj ulliri, ndërsa Pejgamberi a.s. e hëngri atë, dhe pasi përfundoi së ngrëni, ai tha: “Te ju bënë iftar agjëruesit, ngrënë ushqimin tuaj njerëz të mirë, dhe melaqet e Zotit u lutën për ju.”¹¹ Lidhur me çështjen e lutjes, kemi edhe një hadith tjetër të cilin e transmeton Abdullah ibën Busri r.a., i cili tregon se Pejgamberi a.s. me një rast kur kishte ngrënë ushqim te një familje, në fund ishte lutur duke thënë: “O Zoti im! Jepu bereqet në atë që i ke furnizuar, falu atyre mëkatet dhe mëshiroj ata.”¹² E në një tekst tjetër Pejgamberi a.s. ka thënë: “O Zoti im! Ushqeje atë që më ushqeua, dhe jepi për të pirë atij që më dha mua ujë.”¹³

Është e preferuar që mysafirit t’i jepet përparësi ndaj vetes dhe familjes së tij. Transmeton Ebu Hurejre r.a., i cili ka thënë: “Një njeri shkoi te Pejgamberi a.s. dhe iu drejtua atij duke i thënë: “Jam shumë i lodhur!” Me këtë rast Pejgamberi a.s. ju dërgoi porosi grave të tij (që të gjejnë diçka për të ngrënë), e ato të gjithat thanë: “Pasha Atë i Cili të ka dërguar pejgamber nuk kemi asgjë përveç ujit.” Me këtë rast Pejgamberi a.s. ju drejtua të pranishmëve duke ju thënë: “Kush i bënë konak sonte këtij person, Zoti e mëshiroftë!”. Një banor i Medinës tha: “Unë o i Dërguari i Allahut.” E mori mysafirin dhe e dërgoi te shtëpia e tij, kur arriti në shtëpi ju drejtua bashkëshortes së tij duke i thënë: “A ke ndonjë ushqim gati?” Ajo ju përgjigj: “Jo, përveç ushqimit të fëmijëve”. Atëherë ai i tha gruas: “Përgatite atë, e kur t’i servohet ushqimi mysafirit ndize fanarin që të na sheh se edhe ne jemi duke ngrënë, e kur të fillojë së ngrënë fike atë.” Atëherë ajo veprroi siç i tha bashkëshorti i saj dhe mysafiri u ngop së ngrëni. Në mëngjes i zoti i shtëpisë shkoi te Pejgamberi a.s., me atë rast Pejgamberi a.s. i tha atij: “Allahu është mahnitur me veprimin tuaj mbrëmë.”¹⁴

Është etike për zotin e shtëpisë që t’ju bëjë hyzmet mysafirëve. T’i pres ata me fytyrë të buzëqeshur, të tregohet i



mirësjellshëm dhe të shfaq gëzim me rastin e ardhjes së tyre. Duhet t'u bëjë atyre muhabet me ato biseda çfarë atyre ju pëlqejnë. Duhet të përgatis ushqim për ta me atë që ka mundësi, duke mos i neglizhuar ata. Allahu xh.sh. në Kuran na e tregon rastin e Ibrahimit a.s. kur e kishin vizituar melaqet ndërsa ai ju kishte drejtuar atyre duke ju thënë: “Dhe ai pa u vërejtur shkoi te familja e vet dhe solli një viç të majmë të pjekur. Atë ua afroi atyre e tha: “Përse nuk po hani?” (Dharijjat, 26-27). Duhet ta kemi të qartë se ushqimi nuk është qëllim në vete, mirëpo qëllimi esencial i ofrimit të ushqimit është bashkimi në një tryezë dhe socializimi me njëri-tjetrin, ashtu siç mësimet islame në shumë vende kërkojnë që të bashkohen njerëzit si në xhami ashtu edhe në namazet ditore. Ne e dimë se namazi me xhematë ka më shumë shpërblime se sa namazi individual, dhe kjo pikërisht për shkak që njerëzit të bashkohen dhe të shihen me njëri-tjetrin.

Përparësi në të gjitha çështjet duhet t'i jep atij që është më i moshuar, pastaj të vazhdojë me anën e djathtë. Pejgamberi a.s. lidhur me këtë ka thënë: “Filloni me atë që është më i moshuari.”¹⁵ E nëse mysafirët për nga mosha janë të njëjtë, atëherë preferohet që përparësi t'i jepet atij që është në anën e djathtë. Enës ibën Maliku r.a. transmeton dhe thotë: “Një ditë Pejgamberi a.s. erdhi në shtëpinë tonë dhe kërkoi për të pirë. Ne kishin një dele të cilën e molëm dhe ia sollëm qumështin, më pas piu edhe nga uji i bunarit. Në anën e majtë të Pejgamberit a.s. ishte Ebu Bekri r.a., përpallë Pejgamberit a.s. ishte Omeri r.a., kurse në anën e djathtë ishte një beduin. Kur përfundoi Pejgamberi a.s. së piri, Omeri ju drejtua duke i thënë: “Ja ku është Ebu Bekri”, ndërsa Pejgamberi a.s. atë që mbeti ia dha bedunit dhe tha: “Përparësi ka ana e djathtë, të djathtët, prandaj jepuni përparësi.” Ndërsa Enesi r.a. ka thënë: “Një veprim i tillë është sunet, duke e përsëritu tri herë.”¹⁶

Është e preferuar me rastin e daljes së mysafirrit nga shtëpia që të përcillet deri te dera e oborrit. Tregohet se një dijetar i quajtur Ebu Ubejd el Kasim e kishte vizituar Imam Ahmedin. Kur ai deshi të ngritët, atë e përcolli Imam Ahmedi. Ebu Ubejde kërkoi prej Imamit që të mos e përcjell, mirëpo Imami insistoi dhe e përcolli atë deri te dera e oborrit dhe i tha atij: “Është etike dhe e preferuar që mysafiri të përcillet deri te dera e oborrit, në mënyrë që të përfitosh nga bereqeti i tij.”

Ajo që bie në sy pas leximit të argumenteve fetare nga Kurani dhe hadithet e Pejgamberit a.s. është se ato janë në një linjë të ngjashme me traditën tonë të mirëpritjes së mysafirrit.

Zoti i shtëpi duhet të ftojë mysafirë të mirë dhe të ndershëm, e jo mysafirë të pandershëm. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Mos u shoqëro përveç se me një besimtar, dhe mos ta haj ushqimin tënd përveç njeriut të devotshëm.”¹⁷

Qëndrimi me mysafirët gjatë gjithë qëndrimit të tyre në shtëpinë tënde sa të kesh mundësi.

Të mos bëjë ndonjë veprim apo të flasë ndonjë fjalë e cila e dëmton mysafirin apo e rëndon atë.

Bazuar në rregullat të cilat u potencuan më sipër, vërejmë se çështja e mirëpritjes së mysafirrit në mësimet islame është vlerësuar në mënyrën më të mirë të mundshme. Gjeneratat e para të myslimanëve, po edhe ato pas tyre në mënyrë të vazhdueshme i kanë dhënë një rëndësi të veçantë kësaj çështje.

Edhe në mesin e popullit tonë, i cili mësimet islame i ka përqaftuar tash e sa shekuj, vërejmë se tradita e mirëpritjes së mysafirrit ka qenë prezentë dhe ende vazhdon, edhe pse mund të themi me një zbehje në këta dekadat fundit! Mirëpo ajo që bie në sy pas leximit të argumenteve fetare nga Kurani dhe hadithet e Pejgamberit a.s. vërejmë se ato janë në një linjë të ngjashme me traditën tonë të mirëpritjes së mysafirrit, gjë që jep të kuptohet se ato mbështetjen e kanë në mësimet e mirëfillta islame. Së këndejmi, ne lutemi që traditat tona të kamotshme të cilat

janë në përputhje me frymën islame të ruhen me xhelozë dhe të kultivohen edhe në të ardhme. E njëra prej këtyre traditave sigurisht që është edhe mirëpritja e mysafirrit.

- 1 Transmeton Imam Tirmidhiu, hadithi nr. 2004.
- 2 Transmeton Imam Buhariu.
- 3 Transmeton Imam Buhariu, hadithi nr. 6018, gjithashtu edhe Imam Muslimi, hadithi nr. 48.
- 4 Transmeton Imam Muslimi, hadithi nr. 48.
- 5 Transmeton Imam Muslimi, hadithi nr. 48.
- 6 Transmeton Imam Buhariu, hadithi nr. 6176
- 7 El Fetava el Hindije, (5/344)
- 8 Ibën Muflih, El Adab esh Sherijje, (3/208).
- 9 Transmeton Imam Buhariu, hadithi nr. 5434.
- 10 Transmeton Imam Ahmedi, hadithi nr. 23733.
- 11 Transmeton Imam Ebu Davudi, hadithi nr. 3854.
- 12 Transmeton Imam Muslimi, hadithi nr. 2042.
- 13 Transmeton Imam Muslimi, hadithi nr. 2055.
- 14 Transmeton Imam Buhariu, hadithi nr. 3798, dhe Imam Muslimi, hadithi nr. 2054.
- 15 Transmeton Ebu Ja'la në Musned, hadithi nr. 2425.
- 16 Transmeton Imam Buhariu, hadithi nr. 2571.
- 17 Transmeton Imam Tirmidhiu, hadithi nr. 2395.

Humanizmi si virtyt i përshepirtshëm i Islamit

Nada Dosti

Në kohë krizash, siç dhe po jetojmë aktualisht, rikthehet vëmendja te debati mbi disa nocione që deri dje i kemi marrë si të mirëqena dhe kishin nisur të humbitnin vlerë dhe peshë, si për shembull solidariteti dhe humanizmi. Me gjenocidin që ka ndodhur prej vitesh në Palestinë dhe i cili arriti kulmin në tetor të vitit të shkuar në Gaza, morën fund në praktikë të gjitha teoritë mbi humanizmin dhe solidaritetin. Dolën kështu në pah standardet e dyfishta jo vetëm të Perëndimit, por edhe të vendeve islame, të cilat godasin kraharorin kur vjen çështja e vëllazërisë dhe bashkimit të ymetit.

Vizionari kanadez, Marshall McLuhan, para shumë vitesh na prezantoi me parashikimin e tij të famshëm rreth asaj që sot njohim me globalizëm, sipas së cilit, kjo botë e madhe falë zhvillimit teknologjik, do të kthehej shumë shpejt në një shtat

të vogël. Në kuptimin që njerëzit do të jenë më afër me njëri-tjetrin, do të mundën kështu të komunikojnë dhe këmbejnë mes njëri-tjetrit më lirshëm dhe më me shpejtësi se më parë.

Por realiteti për të cilin po dëshmojmë sot, është shumë larg nga pamja dhe atmosfera e vërtetë e një fshati ku sundon harmonia, vëllazëria, shkëmbimi, ndihma e përbashkët etj.. Realiteti i sotëm i ngjanë më shumë një xhunglë, ku të gjithë janë në një luftë për mbijetesë dhe fiton më i forti dhe jo më i drejti apo më meritori.

Pikërisht për të shmangur këtë lloj realiteti kanë ardhur udhëzime hyjnore përmes shpalljes, të cilat synojnë humanizmin dhe solidaritetin në çdo aspekt të jetës dhe karshi çdo lloj krijese, jo vetëm mes njerëzve.

Por si janë përcaktuar këto udhëzime dhe çfarë synojnë?





Le t'i marrim të gjitha nocionet veç e veç dhe t'i analizojmë duke u përqendruar tek urtësia që qëndron pas tyre.

- **Së pari, nocioni “khalifetu fij-l erd (mëkëmbës në tokë)”.**

Në librin e tij “Njeriu në kërkim të kuptimit dhe Islami”, prof. dr. Mehmet Görmez, tregon se si ky nocion e bën njeriun njeri. “Sipas Kuranit, një nga vlerat që e bën njeriun njeri është se ai është kalifi i Zotit në tokë. “Zoti juaj u tha engjëjve: “Unë do të krijoj një kalif në tokë.” Kalifati në fjalë është realizimi i vullnetit të Tij në tokë. Ky vullnet është drejtësia, është mirësia që mbizotëron në tokë. Ky vullnet është dituri, shpresë, mëshirë. Është qenia që do t'i mishërojë emrat e Allahut në tokë.” Në bazë të kësaj, solidariteti dhe humanizmi e ka zanafillën pikërisht në këto vlera dhe parime, dhe është detyra jonë si mëkëmbës në tokë që të tregojmë humanizmin tonë ndaj çdo krijese të krijuar nga Zoti, duke filluar nga bimët, kafshët e deri te njeriu.

- **Së dyti, koncepti i bashkësisë dhe ymetit**

Globalizimi sjell bashkimin e shoqërive dhe komuniteteve të ndryshme në një shoqëri të vetme dhe në të njëjtën kohë fshin identitetet e ndryshme dhe diversitetin. Në të kundërt, ymeti islam synon bashkimin e njerëzve në një shoqëri të vetme, duke përqafuar identitetet e ndryshme dhe duke e promovuar diversitetin si një pasuri për të nxitur kështu këmbimin mes njëri-tjetrit.

Ajeti i mirënjohur “...Ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet jush...” (Huxhurat 13), i cili shpeshherë është keq përkthyer dhe

Nga ana tjetër, disa rituale në Islam si për shembull faljet kolektive në xhami (pesë vaktet, namazi i xhumasë, teravitë, Bajramet, etj.); umre dhe haxhi; janë në të njëjtën kohë procese individuale, por që kryhen në formë kolektive.

keqinterpretuar, nëse i referohemi përkthimeve të ndryshme të Kuranit, qoftë në gjuhën angleze, turke por edhe shqipe: “Që të njiheni/ لَتَعَارَفُوا”, në fakt nënkupton që të shkëmbeni mes njëri-tjetrit, të merrni më të mirën nga njëri-tjetri, të dalloheni mes jush me karakteristika të veçanta dhe unike për secilin fis apo komb, dhe jo të shkriheni në një identitet të vetëm. Për shembull ditët e sotme një fenomen i çuditshëm po vërehet, i cili buron ndoshta pak nga efekti i rrjeteve sociale, e ndoshta edhe pak nga lehtësimi i udhëtimit drejt vendeve të shenjta. Shohim të rinj të cilët vishen dhe sillen sipas kulturës arabe, duke e promovuar këtë si kulturë islame. Por, në fakt, kultura islame është në vetvete shumë e pasur dhe përbëhet nga identitete kulturore të shumta si ajo indoneziane, malajziane, turke, ballkanase, etj.. Të njohurit mes njëri-tjetrit shton dhe mirëkuptimin dhe solidaritetin, ndërsa në të kundërt, paragjykimet dhe urrejtja vijnë nga mosnjohja e tjetrit.

Nga ana tjetër, disa rituale në Islam si për shembull faljet kolektive në xhami (pesë vaktet, namazi i xhumasë, teravitë, Bajramet, etj.); umre dhe haxhi; janë në të njëjtën kohë procese individuale, por që kryhen në formë kolektive. Kjo lloj forme adhurimi na rikujton se ne jemi pjesë e një shoqërie, e një bashkësie dhe ymet, i cili vepron në grup. Si i tillë, i kundërvihet një nga karakteristikave më të dalluara të globalizmit dhe modernizmit që është individualizmi. Duke qenë pjesë e një ymeti, jo vetëm që promovon te njeriu ndjesinë e përkatësisë, por gjithashtu promovon dhe përgjegjësinë ndaj pjesëtarëve

të tjerë të komunitetit, përgjegjësi e cila përmbushet falë formave konkrete të solidaritetit si sadakaja, zekati etj..

- **Së treti, sadakaja dhe zekati**

Sadakaja dhe zekati, si një nga shtyllat e fesë islame, si nocion përmbajnë në vetvete urtësi të ndryshme, qoftë individuale qoftë shoqërore, të cilat kërkojnë një trajtim në një temë më vete, por këtu do të ndalemi më së shumti në aspektin socio-ekonomik të tyre.

Bamirësia në islam është një ndër elementët më të rëndësishëm që promovon solidaritetin, në këtë rast me ata që janë në nevojë. Teorikisht kjo lloj forme solidariteti lehtëson urinë, zbeh hendekun mes njerëzve shumë të pasur dhe atyre shumë të varfër, mjekon plagët e fatkeqësive natyrore dhe luftërave, ndihmon përhapjen e dijes dhe të fesë, të rinjve të martohen e të krijojnë familje, dhe shumë dobi të tjera.

Një aspekt i rëndësishëm i Islamit, që ia vlen të përmendet në këtë kontekst, është edhe ndalesa të meshkujt siç është për shembull floriri. Përtej kësaj ndalesë, ekzistojnë shumë urtësi, por këtu do të ndalemi tek analiza që i ndjeri shejh Jusuf el Kardavi i bën kësaj ndalesë: “Një ndër arsytet e ndalesës është luftimi i luksit, i cili nga pikëpamja e Islamit është shkak i dobësisë së kombeve dhe rënies së tyre eventuale. Kjo është për shkak se ekzistenca e luksit është shprehje e padrejtësisë sociale, pasi vetëm disa mund të përballojnë sende luksoze në dëm të masave të privuara të njerëzve.” “Thuaju robërve të Mi ta falin namazin dhe të japin nga ajo që Ne i kemi furnizuar, fshehtas dhe haptas, ...” (Ibrahim, 31).

Ajeti në fjalë na shpalos shumë aspekte të sadakasë, prej të cilave e para është se asgjë nuk meritojmë dhe nuk jemi në gjendje të fitojmë vetëm nëse do Zoti vetë. Pra, rrësku dhe furnizimi janë nga Allahu, dhe këtë e dëshmon shprehja “... nga ajo që Ne i kemi furnizuar...”, duke ia kujtuar njeriut se nuk po jep diçka nga vetja e vetë, por diçka me të cilën Zoti vetë ka dashur t’i falë. Ndërsa aspekti tjetër, “...fshehtas dhe haptas...”, shpalos dy dimensione të ndryshme të bamirësisë, që janë të dhënit fshehtas, dhe ky veprim përforcon sinqeritetin dhe shmangien e pritshmërive për lavdërime dhe mirënjohje nga të tjerët, si dhe bamirësinë haptazi, e cila gjithashtu ka dobitë e veta, sepse promovon një vepër të mirë duke mundësuar që dhe të tjerët ta ndjekin shembullin e njëjtë duke e përhapur kështu të mirën te të tjerët.

Nga ana tjetër, aspektet metafizike dhe jo materiale të sadakasë janë një tjetër element që promovojnë solidaritetin, si për shembull veprime dhe sjellje të ndryshme që përhapin mirësinë, dashurinë dhe tolerancën. Profeti Muhamed, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të, ka thënë: “Sadakaja është edhe kur një mysliman fiton dituri, dhe atë dituri ua mëson të tjerëve.” (Ibën Maxhe). Gjithashtu: “Fjala e mirë është sadaka!” (Muslimi). Buzëqeshja, llokma e ushqimit drejtuar gruas është sadaka.

Ebu Hurejra, përcjell se i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të, ka thënë: “Për çdo nyje të trupit, sa herë që lind dielli, njeriu duhet të japë lëmoshë. Të pajtosh dy persona është lëmoshë, ta ndihmosh njeriun të hipë në kafshën e tij a t’ia vësh barrën mbi të është lëmoshë, fjala e mirë është lëmoshë, për çdo hap që e bën për të shkuar në namaz ka lëmoshë dhe për heqjen e pengesës nga rruga ka lëmoshë.” (Buhariu dhe Muslimi).

Së fundmi, forma më madhështore e solidaritetit është përmbledhur në hadithin e famshëm të “ndryshimit”.

Nga Ebu Seid el Hudriu, përcillet se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të, duke thënë: “Kushdo që sheh ndonjë të keqe, le ta ndryshojë me dorën e tij, e, nëse nuk mundet, atëherë me gjuhën e tij, e, nëse nuk mundet as kështu, atëherë me zemrën e tij, por ky është imani më i dobët.”

Në ditët e sotme, sidomos në kohë krizash dhe lufte, ndryshimi i të keqes me gojë (përmes dënimit të saj, ngritja e zërit ndaj padrejtësisë përmes deklaratave, shkrimeve, opinionëve), si dhe ndryshimi me dorë (ndoshta përmes protestave, bojkoteve, fushatave etj.), janë format më të nevojshme të solidarizimit. Secili prej nesh, falë dhe internetit dhe rrjeteve sociale e ka një zë, e ka një platformë ku ta dënojë të keqen dhe të gjejë zgjidhje për zullumin. Sicili prej nesh e ka në dorë të ushtrojë presion ndaj politikave dhe qeverive, të refuzojë mallra përmes bojkotit, të qohet nëpër protesta si formë pozicionimi.

Edhe pse disa mund të mendojnë se të gjitha këto janë përpjekje të kota se nuk zgjidhin asgjë, efektet e veprimeve të tyre të ndërmarra nga një individ shumëzuar me miliona njerëz mund të sjellin ndryshimin. Edhe nëse ndryshimi nuk vjen, edhe nëse fitorja nuk vjen derisa ta ketë caktuar Allahu, të paktën secili prej nesh tregon pozicionim. Është në dorën tonë të zgjedhim mes të hedhurit gur së bashku me shpendët kundrejt elefantëve, të mbajturit ujë për të shuar zjarrin e Ibrahimit a.s., apo të pozicionohemi me zhapikun, i cili mbarte kashtë për t’i dhënë akoma më shumë forcë zjarrit?

Burimet:

1. Hadithi Sunan Ibën Maxheh
2. Mehmet GÖRMEZ. (2024), Njeriu në kërkim të kuptimit dhe Islamit, Logos – A, Shkup.
3. Sahihu i Buhariut.
4. Sahihu i Muslimit.
5. Qaradawy, Yusuf. The Lawful and Unlawful in Islam. Transl. Kamal El-Helbawi et al. United Kingdom. (1985). Shrouk International.

“Tek ai do të më gjeje Mua...”

Bajram Zeqiri

Shëndeti është një nga begatitë më të mëdha me të cilën është furnizuar besimtari nga Allahu Fuqiptotë. “Njerëzit nuk ua dinë vlerën dy mirësive: shëndeti dhe kohës së lirë”¹ – kishte thënë Pejgamberi a.s., duke e cilësuar atë, shëndetin, si një dhunti dhe mirësi parësore në jetën e njeriut. Besimtari është porositur që të ketë kujdes për shëndetin dhe mos ta dëmtojë atë në çfarëdo forme qoftë ajo. Ai duhet ta njoh shëndetin si një kapital të madh, dhe këtë duhet ta njoh edhe më mirë në saje të vizitës së të sëmurit. Por, pavarësisht kësaj, pavarësisht kujdesit dhe ruajtjes së shëndeti, tundimet e jetës bëjnë që njeriu edhe të sprovohet me humbje dhe me dëmtim të tij. Kur besimtarin ta ketë goditur sëmundja, ai obligohet që ta kërkojë shërimin, në format dhe mundësitë që janë të lejuara dhe të pranuar, ngase një gjë të tillë e kemi porosi nga i Dërguari a.s.: “Mjekohuni, sepse Allahu, i Lartmadhëruar qoftë, nuk ka lënë sëmundje të cilës nuk i ka lënë shërim, përveç një sëmundje, pleqërisë.”²

PRAKTIKA E TË DËRGUIARIT A.S.

I Dërguari a.s., ishte aq i brengosur për vizitën e të sëmurit, saqë bëri parime dhe rregulla për një vizitë të tillë, e të cilat më pas sahabët i regjistruan në librat e Sunetit. Myslimanët e ardhshëm e përcollën këtë traditë gjeneratë pas gjenerate, duke e bërë kështu një tipar të jetës së tyre shoqërore, shenjë të lidhjes shpirtërore, dashurisë, mëshirës dhe solidaritetit të ndërsjellë.³

“I Dërguari a.s., i vizitonte disa të afërm (të sëmurë) dhe i fërkonte me dorën e tij të djathtë duke thënë: “O Zoti i njerëzimit, largoja vuajtjen, shëroje pasi Ti je Shëruesi! Nuk ka shërim përveç shërimit Tënd, shërim, i cili nuk lë asnjë gjurmë të sëmundjes.”

Nga praktika e të Dërguarit a.s., ishte që të ulej te koka e të sëmurit, ashtu siç kishte vepruar me vizitën e djaloshit hebre: “... u ul pranë kokës së tij...”⁴ Ai, me mprehtësinë e thellë të tij, nuk e lë anash as thirrjen në Islam, duke ditur kështu efektet pozitive që mund t'i kishte kjo vizitë, pasi që të gjithë u befasuan për të mirë me bujarinë, mirësinë dhe qasjen e butë që tregoi i Dërguari a.s.

Aisheja r.a., transmeton se i Dërguari a.s., kur vizitonte një të sëmurë, e vendoste dorën e tij të djathtë mbi të dhe lutej: “I Dërguari a.s., i vizitonte disa të afërm (të sëmurë) dhe i fërkonte me dorën e tij të djathtë duke thënë: “O Zoti i njerëzimit, largoja vuajtjen, shëroje pasi Ti je Shëruesi! Nuk ka shërim përveç shërimit Tënd, shërim, i cili nuk lë asnjë gjurmë të sëmundjes.”⁵

Përveç lutjes për shërimin e të sëmurit, i Dërguari i Allahut a.s., ka sugjeruar që Allahun ta lut edhe i sëmuri: “Kur të hysh te një i sëmurë për vizitë, kërko nga ai që të lutet për ty. Lutja e tij është si lutja e melaqeve.”⁶

Duke parë vlerën dhe rëndësinë që ka vizita e të sëmurit, i Dërguari a.s., tregonte kujdes të veçantë ndaj sahabëve në këtë çështje. Ai i vizitonte ata kur sëmureshin pa marrë parasysh nëse ishin rëndë të sëmurë apo pak të sëmurë. Zejdi r.a., ka thënë: “Më vizitoi Pejgamberi a.s. kur kisha një dhembje në sy.”⁷ Vizitën ai a.s., nëse ishte nevoja e përsëriste disa herë, ngase me këtë ai freskonte zemrën e të sëmurit, siç ishte rasti me Sad ibën Muadhlin, i cili u plagos në ditën e Hendekut. “Pejgamberi a.s. e vendosi atë në një tendë në xhami, që ta vizitojë më shpesh.”⁸



“HURFEJA E XHENETIT”

S’ka dyshim se vizita e vëllait të sëmurë është një ndër detyrat më të rëndësishme për besimtarin mysliman. Ai e konsideron vizitën e të sëmurit si një detyrë të tij islame. Duke vepruar kështu, ai e çon në vend urdhrin e të Dërguarit a.s.. Pejgamberi a.s., ishte shndërruar në një shembull për ymetin e vet dhe e ka shprehur kërkesën e tij në mënyrë urdhërore drejtuar sahabëve që t’i vizitojnë të sëmurit: “Vizitoheni të sëmurin, ushqejeni të varfrin dhe paguani lirim të burgosurve të luftës.”⁹

Ai e kishte cilësuar këtë si një nga pesë obligimet që ky myslimani ndaj vëllait të tij mysliman. Në hadithin e transmetuar nga Ebu Hurejra r.a., Pejgamberi ynë, Muhamedi a.s., ka thënë: “Ekzistojnë pesë obligime të një myslimani ndaj myslimanit tjetër: kthimi i selamit, vizita e të sëmurit, përcjellja e xhenazes, përgjigjja ndaj ftesës dhe të përgjigjurit me lutje kur ai teshtinë.”¹⁰

Duke folur për rëndësinë e madhe të vizitës së të sëmurit, Pejgamberi a.s., thotë se Allahu atë vizitë e pranon sikur t’i ishte bërë Vetë Atij.¹¹ Ebu Hurejra r.a., transmeton një hadith Kudsij, në të cilin i Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: “Zoti i botëve do të thotë Ditën e Gjykimit: “O njeri, Unë isha i sëmurë, por ti nuk më ke vizituar.” Njeriu do të pyesë: “Si mund të të vizitojë, o Zot, kur ti je Zoti i botëve?” Ai do të thotë: “A nuk e dije se ky dhe ai rob Imi u sëmur dhe ti nuk e vizitove atë? A nuk e dinë se do të më kishe gjetur tek ai po ta kishe vizituar atë?”¹² Kjo me të vërtetë është

një vizitë e bekuar, për të cilën është dëshmitar edhe Vetë Zoti i Plotfuqishëm, dhe për të cilën ka premtuar shpërblime pa masë.

Nxitja e besimtarit për ta vizituar vëllain e tij të sëmurë ka ardhur në shumë hadithe të të Dërguarit a.s., të cilat promovojnë një gjë të tillë. Besimtari, përveç për hir të shpërblimit të premtuar nga Allahu i Madhëruar, e viziton një të sëmurë edhe për ta kryer një obligim që ka ndaj vëllait të tij, por edhe për ta përforcuar vëllazërinë dhe mirëkuptimin ndërmjet tyre. Pejgamberi a.s., në një hadith të transmetuar nga Thevbani r.a., ka thënë: “Ai që e viziton të sëmurin, gjendet në Hurfen e Xhenetit derisa të kthehet.” Të pranishmit i thanë: “O i Dërguari i Allahut, çfarë është Hurfeja e Xhenetit?” Ai i tha: “Kopshtet e tij të bujshme.”¹³

Përveç fitimit të Hurfes së Xhenetit, me vizitën e të sëmurit, besimtari fiton edhe përhëndetjen dhe lutjen e shtatëdhjetëmijë melaqeve ditën dhe natën, në varësi prej kohës se kur e viziton të sëmurin. Pejgamberi a.s., në një hadith tjetër ka thënë: “Nuk ka mysliman, i cili e viziton myslimananin e sëmurë gjatë ditës, e të mos e përshëndesin atë shtatëdhjetëmijë melaqe derisa të vijë nata. E nëse e viziton gjatë natës, atë e përshëndesin shtatëdhjetëmijë melaqe derisa të agojë dita dhe do të ketë një vend me kopshte të bujshme në Xhenet.”¹⁴

Kur besimtari e viziton vëllain e tij të sëmurë, ai nuk ndien vetëm se po e kryen një obligim, por ai në vetvete e ndien një gëzim shpirtëror dhe kënaqësi, të cilat nuk i ndien

Kjo me të vërtetë është një vizitë e bekuar, për të cilën është dëshmitar edhe Vetë Zoti i Plotfuqishëm



askush përveç atyre, të cilët i kuptojnë bukuritë, mirësitë dhe bekimet që sjell një vizitë e tillë.¹⁵

Ebu Hurejre r.a., transmeton se i Dërguari a.s., në një hadith ka thënë: “Ai që e viziton një të sëmurë, atë e thërret një thirrës nga qielli: “Të lumtë, punove mirë, të lumshin këmbët, vërtet ke përgatitur një vend në Xhenet.”¹⁶

DURIMI SHPËRBLEHET

Shpeshherë dhimbjet e sëmundjes janë aq të rënda, saqë nganjëherë bëhen edhe të papërbalueshme. Besimtari duhet ta ketë në mendjen e tij dhe të jetë i bindur se çdo gjë që e godet atë është në urtësinë e Allahut dhe se këto dhimbje lehtësohen kur përmenden shpërblimet për durimin e bërë. I Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: “Çfarëdo që e godet myslimanin, qoftë lodhje, pikëllim, brengë, hidhërim, mundim nga sëmundje a fatkeqësi, madje edhe të shpuarit e ferrës – me cilëndo prej këtyre, Allahu ia shlyen mëkatet.”¹⁷

“Jepu myzhde durimtarëve” (El Bekare, 155); “Allahu i do durimtarët” (Ali Imran, 146); janë vetëm disa ajete, të cilat kur besimtari i kujton, në të ngjallet ndjenja e durimit dhe pajtimit me përcaktimin e Allahut të Madhëruar, dhe se durimi i tillë është shkak për hyrje në Xhenet. Në lidhje me këtë, i Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: “Kur Allahu t’ia caktojë robit të tij një pozitë, të cilën ai nuk e arrin me punën e tij, e sprovon në trup, pasuri ose fëmijë, e pastaj e bën durimtar, derisa t’ia bëjë të mundshme ta arrijë pozitën që Allahu i Madhëruar ia ka caktuar.”¹⁸

Pejgamberi a.s., me një rast e vizitoi një grua të sëmurë, të cilën e përgëzoi me largimin e gjynaheve për shkak të sëmundjes së saj: “Përgëzime oj nëna e Alasë. Dije se

sëmundja e besimtarit i largon gjynahet ashtu siç i largon zjarri mbeturinat e arit dhe argjendit.”¹⁹ Ai e përgëzoi edhe robin që ankonte nga temperatura e lartë, duke ia kujtuar atij thënien e Allahut të Madhëruar: “Përgëzohu, sepse Allahu thotë: “Temperatura e lartë është zjarri Im, e bëj që robit Tim besimtar t’i bie në këtë botë që për të të jetë shpëtim në Ahiret nga zjarri i Xhehenemit.”²⁰

Personi i cili duron ndaj fatkeqësive që vijnë prej Allahut dhe e falënderon Allahun, kap mundësinë për falje të mëkateve të së shkuarës. Sheddad bin Evsi, njëri nga shokët e Pejgamberit a.s., gjatë vizitës së një të sëmuri, e përgëzoi me këto fjalë: “Gëzohu për faktin se sëmundja është pastrim i mëkateve dhe gabimeve tua. E kam dëgjuar të Dërguarin a.s., të ketë thënë se Allahu xh.sh. ka thënë: “Kur e sprovov një besimtar me një sëmundje dhe ai më falënderon, nga shtrati ku ka rënë ngrihet i pamëkate si ditën që e ka lindur nëna e vet.”²¹

Sëmundja nganjëherë mund të shndërrohet në dhunti, kjo me moralin që i jepet të sëmurit që ai ta mbledh veten dhe të tejkalojë sprovën e sëmundjes. Rikujtimi që i bëhet atij për punët dhe veprat e mira që mund t’i bëjë ai pas shërimit, mund t’i japin kahje tjetër jetë së tij të mëtejme. Është këshilluar nga i Dërguari a.s., që i sëmuri mos ta dëshirojë vdekjen. Kur ai a.s., e vizitoi xhaxhain e tij, Abasin, i tha: “O xhaxha! Mos e dëshiro vdekjen, se nëse je prej të mirëve dhe ty të zgjatet jeta, atëherë të shtohen veprat e mira, e kjo është mirë për ty. Por nëse je prej të këqijve dhe ty të zgjatet jeta, atëherë ndodh që të pendohesh nga e keqja jote dhe kjo është më mirë për ty. Pra mos e dëshiro vdekjen!”²²

1 Transmeton Buhariu.

2 Ebu Davudi.

3 Dr. Muhamed Ali el Hashimi, “Muslimani ideal”, Prishtinë, 2013, fq. 289.

4 Transmeton Buhariu – 1356.

5 Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

6 Transmeton Ibën Maxhe.

7 Transmeton Ebu Davudi – 3102.

8 Transmetojnë Buhariu – 4122 dhe Muslimi – 1796.

9 Transmeton Buhariu.

10 Muttefekun alejhi, Rijadus Salihin (Kopshti i të devotshmëve) – Imam Neveviu.

11 Kryesia e Çështjeve Fetare e Turqisë, “Islami nëpërmjet haditheve”, vëll. IV, fq. 394.

12 Transmeton Muslimi – 2569.

13 Transmeton Muslimi – 2568.

14 Transmetojnë Ebu Davudi – 3098, Tirmidhiu – 969 dhe Ibën Maxhe – 1442.

15 Dr. Muhamed Ali el Hashimi, “Muslimani ideal”, Prishtinë, 2013, fq. 285.

16 Transmetojnë Tirmidhiu – 2008 në “Sahih et Tirmidhi” dhe Ibën Maxhe – 1443.

17 Sahihu i Buhariut – 5641 dhe 5642 dhe Sahihu i Muslimit – 2573.

18 Transmeton Ebu Davudi – 3090.

19 Transmetojnë Ebu Davudi – 3092 dhe Taberaniu në “Muxhemul Kebir” (25/340).

20 Transmetojnë Ahmed (2/440), Ibën Maxhe – 3470 dhe Hakimi (1/345).

21 Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, “Islami nëpërmjet haditheve”, vëll. IV, fq. 396.

22 Shënon Hakimi (1/339).

Dashuria si rregullator i raporteve fëmijë-nënë

Merita Boroci

Termi dashuri është shprehje që shumë shpesh e hasim në rrethet tona dhe e përjetojmë nga dashamirët tanë. Por, çka në të vërtetë është dashuria dhe kush është më meritor ta përfitojë atë? Çfarë efekti do të arrijmë përmes këtij mekanizmi në raport me rrethin tonë? Gjatë këtij punimi do të përpiqemi të japim një pasqyrë rreth kësaj teme.

Dashuria në kontekstin gjuhësor, si fjalë, tregon për ndjenja të fuqishme dhe të thella: pëlqim, dashamirësi, adhurimi për dikë apo për diçka.¹ I gjithë ky shpjegim parqet besimin tonë në Allahun xh.sh. dhe në Islamit si program jete të përzgjedhur nga Krijuesi i Gjithëdijshëm. “Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë.” (Edh Dharijat, 56). Adhurimi nënkupton respektimin dhe madhërimin e Allahut xh. sh., përmbushjen e detyrave tona të përcaktuara nga Ai, si dhe falënderimin për begatitë e shumta që na i dhuroi. E nga begatitë më të mëdha që Allahu i dha njeriut padyshim është feja, përmes së cilës njeriu kupton qëllimin e krijimit të tij.

Besimi i drejtë i njeriut do të hapë një derë në zemrën e mendjen e tij, përmes së cilës do të arrijmë t'i perceptojmë gjërat drejt dhe t'i trajtojmë me prioritet disa karshi disa të tjerave. Allahu i Madhëruar përcaktoi një formë unike dhe të vetme për zhvillimin e llojit njerëzor në tokë, duke e krijuar një pjesë trupore – mitrën në trupin e femrës, aty ku do

të zhvillohet një brez i ri i llojit njerëzor. Aty është vendqëndrimi i foshnjës në trupin e nënës për nëntë muaj, dhe që nga aty fëmija krijon një lidhje me nënën e vet, lidhje kjo që nuk përfundon kurrë, duke e synuar shijimin e frutave të kësaj lidhje edhe në Xhenet.

Lidhjen ndërmjet tyre që është ekzistenciale, në atë fazë embrionale e mundëson ushqimin dhe absorbimin e ndjenjave dhe emocioneve që nëna përjeton gjatë kësaj periudhe. Po të përcaktohet se çka ka nevojë një fëmijë qysh në këtë fazë, padyshim se ofrimin i ndjenjave të dashurisë ndaj fëmijës është esencial për zhvillimin dhe formësimin emocional të tij.

Ardhja në jetë e një fëmije është momenti më i rëndësishëm dhe i veçantë për një prind e në veçanti për një nënë, e cila përjeton dhembjen më të madhe për të sjellë në jetë dashurinë më të madhe. Atë që ajo gjatë e ka ëndërruar. Të analizosh sakrificën që njeriu bën për njeriun, gjen se nuk ka sakrificë më të madhe se sa ajo e nënës për fëmijën e saj, dhe është interes personal dhe obligim fetar që kjo sakrificë të ketë qëllim, mision e vizion, si dhe kërkon nga fëmija të jetë mirënjohës për nënën e tij.

Qëllimi kryesor i një martesë të shëndoshë, sigurisht se duhet të jetë ruajtja dhe zhvillimi i llojit njerëzor, e ajo pra mund të bëhet vetëm përmes martesës së rregullt. Allahu xh.sh në Kuran na porosit: “Allahu krijoi për ju bashkëshorte nga vetë lloji juaj, e prej bashkëshorteve tuaja - fëmijë e nipa dhe ju

Të analizosh sakrificën që njeriu bën për njeriun, gjen se nuk ka sakrificë më të madhe se sa ajo e nënës për fëmijën e saj.

furnizoi me (ushqime) të mira...” (En Nahl, 72). Në një hadith të transmetuar nga Bejhakui dhe Abdurrezaku, na specifikon porosinë e të Madhëruarit, ku i Dërguari a.s., ka thënë: “Martohuni që të shtoheni! Unë do të mburrem para ymeteve të tjera.”

Shtimi i një anëtari të ri në familje nënkupton forcë për atë familje, shtet, e patjetër se shndërrohet edhe një kauzë, të cilën do ta mbështes në të ardhmen.

MISIONI

Familja është projekti jetësor i dynjasë dhe ahiretit. Në një hadith, i Dërguari a.s. duke qenë shëmbëlltyra dhe modeli më i kompletuar për pasim, na porositi: “Më i miri prej jush është ai që është më i dobishmi për familjen e vet, ndërsa unë jam më i miri ndër ju ndaj familjes sime.”² Nga kushtet e imanit është që ne të besojmë në botën tjetër, ringjalljen, llogaridhënien dhe Xhenetin e Xhehenemin. Allahu xh.sh. në Kuran na porositi që ta ngremë nivelin e përgjegjësisë që kemi karshi familjes e në mënyrë të veçantë ndaj fëmijëve: “O ju që besuat, ruani veten dhe familjen tuaj prej zjarrit, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë (zjarrin) e mbikëqyrin engjëjt të rreptë e të ashpër që nuk e kundërshtojnë Allahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë që janë të urdhëruara.” (Tahrim, 6). Pastaj në një hadith tjetër, i Dërguari a.s., ka thënë: “Të gjithë ju jeni bari-kujdestar dhe të gjithë jeni përgjegjës për tufën tuaj.”³ Këto porosi hyjnore ngrenë

Nuk ka dashuri më të sinqertë se ajo e nënës për fëmijën e saj. E manifestimi i kësaj dashurie duhet të shprehet me dhembshuri, kujdes e dashamirësi, duke u bërë udhërrëfyes për të dhe duke i treguar për qëllimin e krijimit dhe rrugën e vërtetë me stacionin e fundit të saj, me Xhenetin.

nivelin e përgjegjësisë që kemi, duke na alarmuar për përkujdesjen ndaj amanetit, stolisë së kësaj bote, por edhe të asaj që Zoti ynë e bëri të jetë prova më e madhe në këtë jetë.

Si prind, obligohemi që fëmijës t’ia mësojmë besimin e drejtë në Krijuesin e tij, mënyrat e kryerjes së obligimeve fetare dhe largimin nga punët e ndaluara që pasojat e veprimeve të tyre do të përjetohen në këtë dynja, në jetën në varreza dhe në ditën e gjykimit, atëherë kur secili do ta korrë atë që mbolli në dynja.

Nga metodat që duhet përdorur në rregullimin e raporteve të fëmijës me Zotin e tij, me familjen-rrethin dhe vetveten e tij është dashuria. Njeriu është i prirë që ta pasojë, ta dëgjojë, ta vlerësojë, e të sakrifikojë për atë që e do. Nuk ka dashuri më të sinqertë se ajo e nënës për fëmijën e saj. E manifestimi i kësaj dashurie duhet të shprehet me dhembshuri, kujdes e dashamirësi, duke u bërë udhërrëfyes për të dhe duke i treguar për qëllimin e krijimit dhe rrugën e vërtetë me stacionin e fundit të saj, me Xhenetin.

VIZIONI

Fëmija është fryt i dashurisë dhe butësisë, zbulim dhe përmbushje e dynjasë. Ai i jep kuptim jetës së çiftit bashkëshortor, dhe i tilli duhet trajtohet me mëshirë, kujdes e dashuri.

Prindërit për fëmijët janë edhe si mundësi e përfitimeve të shumta. Nga ta kërkohet që të sillen mirë me prindërit: “Zoti yt ka dhënë





urdhër të prerë që të mos adhuronit tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as “of - oh”, as mos u bë i vrazhdë ndaj tyre, po atyre thuaj fjalë të mira (të buta respektuese).” (El Isra, 23). Ky trajtim karshi prindërve do të jetë mirënjohja dhe falënderimi më i madh për sakrificën jetësore që ata bënë për të si fëmijë të tyre, që pastaj të arrihet shpërblimi e kënaqësia e Allahut në këtë sprovë që çdo fëmijë testohet.

Nëna meriton kujdesin dhe dashurinë e posaçme: “Ne e urdhëruam njeriun t’u bëjë mire prindërve të vet, ngase nëna e vet me mund e barti dhe me vështirësi e lindi.” (El Ahkaf, 15).

Nëna është më meritore për dashurinë tonë. Ebu Hurejra transmeton se: “Erdhi një njeri te Pejgamberi a.s. dhe e pyeti: “Kush ka më së shumti merita që t’i kushtohet kujdesi plotë?” “Nëna” - i tha Pejgamberi a.s.. “Mandëj kush vjen në radhë?”, “Nëna” - iu përgjigj Pejgamberi a.s.. “E pastaj kush?” pyeti prapë “Nëna, e mandëj babai” - iu përgjigj Pejgamberi i Allahu xh.sh..

Në një hadith tjetër kemi edhe një mesazh nga Allahu përmes së cilit kushtëzohet Xheneti: “Xheneti është nën këmbët e nënës.”

Ne, prindërit,
jemi arkitektë
të personalite-
teve të tyre,
duke u
siguruar atyre
plotësimin e
nevojave
jetësore me
hallall dhe
ofrimin e
dashurisë e
përkujdesjes së
pakufishme
për ta.

Askush me shumë se nëna nuk e di koston e sjelljes së një fëmije në jetë dhe si e tillë askush nuk ka dashuri më shumë se ajo. Të gjitha këto porosi duhet t’i mësohen dhe instalohen fëmijëve tanë në personalitete të tyre, sepse ne prindërit, jemi arkitektë të personaliteteve të tyre, duke u siguruar atyre plotësimin e nevojave jetësore me hallall dhe ofrimin e dashurisë e përkujdesjes së pakufishme për ta.

Ata do jenë pasardhësit tanë, burim i shpërblimeve për ne edhe pas vdekjes sonë, burim i krenarisë apo turpit, burim i gëzimit dhe ndonjëherë ndoshta edhe i mërzisë.

PËRFUNDIMI

Dashuria duhet të shihet si infuzion që në vete përmban gjitha vlerat që feja na thërrret t’i kemi e t’i praktikojmë. T’i rrisim fëmijët me dashuri do të thotë të mbjellim pemë dashurie në të, frutat e të cilit do t’i shijojnë edhe njerëzit e tjerë duke marrë “vitaminat” – këshillat e nevojshme për jetë. Dashuria na siguron kështjellë të lumtur familjare, fëmijë të qetë, të suksesshëm dhe përtej kësaj edhe shumë humanë.

1 Fjalorthi.com

2 Sahihu i Buhariut.

3 Transmetojnë Buhariu, Muslimiu dhe Tirmidhiu.

Konflikti në mes të gjeneratave dhe sfidat e edukimit të brezit të ri

Prof. ass. dr. Ferdi Kamberi

Shoqëria bashkëkohore karakterizohet për nga konsensusi, pajtimet, mospajtimet, dilemat, sfidat, besa edhe konfliktet e ndryshme, të cilat shpeshherë vijnë si rezultat i dallimeve esenciale apo botëkuptimeve në ide, qasje, resurse, apo polarizime. Konflikti në kontekstin sociologjik zakonisht është rrethanë sociale në të cilin duhet të jenë pjesëmarrës të paktën dy individë ose grupe me pole apo dallime të kundërta. Me fjalë të tjera, edhe pse sot ka një mori të përkufizimeve rreth konfliktit, ai shihet si “dukuri e moskuptimeve, mospajtimeve, kundërshtimeve, etj.”¹ Konflikti është “mosmarrëveshje e thellë ndërmjet dy individëve apo dy palëve që kanë synime të kundërta për të njëjtin objekt interesi. Konfliktet janë përcjellëse të pashmangshme të çdo shoqërie njerëzore. Nuk ekziston asnjë shoqëri, në të cilën nuk ka konflikte të caktuara shoqërore”² Konfliktet si të tilla mund të jenë të pranishme në nivele të ndryshme të shoqërisë, përfshirë nivelin e politikës, jetës sociale, kulturore, konfliktet në gjeneratë ndërmjet brezave të vjetër dhe të rinjve, si dhe në nivele të tjera të shoqërisë. Nga ky prizëm, sociologët ngrehin një paralele, duke theksuar se konfliktet mund të jenë të natyrave të ndryshme. Kësisoj, ato mund të jenë: konflikt interpersonal, grupor dhe brenda grupor, pastaj mbi bazën e kësaj konfliktet mund të jenë si rezultat i rrethanave,

Konflikti në kontekstin sociologjik zakonisht është rrethanë sociale në të cilin duhet të jenë pjesëmarrës të paktën dy individë ose grupe me pole apo dallime të kundërta.

nevojave, botëkuptimeve, keqkuptimeve të ndryshme. Një prej llojeve të konflikteve së fundi është parë edhe konflikti midis gjeneratave apo brezave, një lloj i konfliktit i cili ka ekzistuar edhe më parë, por që kryesisht ka qenë më shumë në formën latente. Zhvillimet dhe ndryshimet sociale, të cilat kanë ndodhur së fundi, përfshirë edhe shoqërinë shqiptare, kanë shpërfaqur edhe hendeqe në mes të gjeneratave të ndryshme. Kështu, si rezultat i dallimeve, botëkuptimeve, qasjes, ndryshimeve sociale, por edhe rrethanave të reja sociale, sidomos pas periudhës së COVID-19, shoqëria bashkëkohore është thelluar edhe më shumë në një stratifikim social. Për sociologët ky stratifikim social është një lloj shtrehëzimi social në mes të grupeve apo individëve të caktuara në kultura dhe shoqëri të ndryshme. Teoria e konfliktit është një perspektivë sociologjike që e sheh shoqërinë si një sistem të karakterizuar nga dinamika e pushtetit dhe prania e pashmangshme e konfliktit. Teoria thekson rolin e pabarazisë sociale, konkurrencës për burime dhe luftës së klasave në formësimin e rendit shoqëror. Sipas Teorisë së Konfliktit, strukturat sociale formohen nga dinamika e pushtetit dhe konfliktet që lindin nga shpërndarja e pabarabartë e burimeve dhe statusit social brenda shoqërisë. Sociologu i njohur Simmel-i ka nënvizuar se “një sasi e caktuar e disonancës dhe grindjes, e



divergjencës së brendshme dhe e kundërtisë së jashtme, janë të lidhura ngushtë me elementet që e mbajnë grupin të bashkuar”.³ Kështu, konflikti i gjeneratave është një lloj i konfliktit që ndodhë në mes të gjeneratave (brezave) të ndryshme, bazuar në moshën e tyre, ato mund të jenë në mes të brezit më të vjetër dhe më të ri, apo edhe në mes të të dy gjinive bazuar në moshë. Ky konflikt përcjellë të gjitha kulturat dhe shoqëritë, dhe ai manifestohet përmes formave apo mënyrave të ndryshme, të cilat paraqesin sfida për ecurinë e shoqërisë moderne. Në sociologji, koncepti i ‘brezave’ i referohet një grupi individësh që lindin dhe rriten gjatë një periudhe kohore specifike dhe ndajnë përvoja, vlera dhe qëndrime të përbashkëta. Brezat shpesh përcaktohen nga ngjarje të rëndësishme ose ndryshime shoqërore që formojnë botëkuptimin e tyre dhe ndikojnë në sjelljen e tyre”.⁴ Në këtë drejtim, brezat (gjeneratat) nuk janë etnitete fikse, por ato janë të ndërtuara dhe të përcaktuara në mënyrë shoqërore nga faktorë biologjik, historik, kulturor dhe social. Brezat janë ndërtuar mbi bazën e ndërveprimeve komplekse, duke përfshirë përparimet teknologjike, ngjarjet politike, kushtet ekonomike dhe normat shoqërore. Me kalimin e kohës dhe ndryshimet sociale, shpërfaqen edhe një mori e dallimeve ndërmjet brezave, të cilat paraqiten si fenomene në shoqëri. Padyshim se “brezat luajnë një rol vendimtar në formësimin e shoqërisë dhe ndikimin në ndryshimet shoqërore. Ato janë të rëndësishme në

Te shqiptarët konflikti i gjeneratave ka qenë ma shumë i formës latente (fshehur) sesa i cili është paraqitur, pasi sistemi patriarkal i familjes dhe konservator ka pasur një rol të rëndësishëm në respektin e brezave më të vjetër, megjithëse kohë pas kohe janë shfaqur edhe dallime esenciale, për shkak edhe të rrethanave të krijuara.

transmetimin e vlerave, besimeve dhe praktikave kulturore nga një brez në tjetrin. Çdo brez zhvillon identitetin e vet të veçantë dhe kontribuon në evolucionin e normave shoqërore, ideologjive politike dhe tendencave kulturore”.⁵ Te shqiptarët konflikti i gjeneratave ka qenë ma shumë i formës latente (fshehur) sesa i cili është paraqitur, pasi sistemi patriarkal i familjes dhe konservator ka pasur një rol të rëndësishëm në respektin e brezave më të vjetër, megjithëse kohë pas kohe janë shfaqur edhe dallime esenciale, për shkak edhe të rrethanave të krijuara. Sot, me zhvillimet dhe ndryshimet sociale, si duket janë shpërfaqur dallime në mes të gjeneratave dhe kjo është e evidente në shumë segmente të jetës shoqërore.

HENDEKU NË MES TË GJENERATAVE

Zakonisht kur flitet për konfliktet, ato supozohet se shpesh burojnë nga dallimet në vlera, besime, qëndrime dhe sjellje midis brezave të vjetër dhe të rinj. Ekziston një hendek në mes të gjeneratave të vjetra dhe të reja. Janë dy çështje të cilat duhet nënvizuar në këtë segment. Së pari, gjeneratat e reja i shohin si pengesë gjeneratat e vjetra drejt arritjes së tyre në karrierë ose drejt majave të suksesit, kjo madje vërehet edhe me rastin e përdorimit apo përshtatjes ndaj ndryshimeve në teknologji, ku brezat më të vjetër hezitojnë ose kanë frikë nga ndryshimet sociale, përderisa brezat e rinj tashmë janë adaptuar. Së dyti, gjeneratat e vjetra i shohin të rinjtë të pa përvojë dhe ambiciozë drejt arritjeve të tyre pa ndonjë mund. Lidhur me këtë, studiuesi Johan Gunther, kishte theksuar se “si rezultat i zhvillimeve të fundit në epokën e digitalizimit, njerëzit mund të ndahen në dy kategori: a) Vendasit digjital dhe b) Imigrantët digjital. Në grupin e parë hyjnë personat të cilët janë rritur me teknologjinë informative, sidomos me atë virtuale, ndërsa në të dytin ata me moshë më të vjetër, të cilët e kanë problem përshtatjen me zhvillimet rapide të kësaj teknologjie”.⁶ Kështu, të dy këto hendeqe krijojnë pabarazi sociale në shoqëri, duke kategorizuar shoqërinë, shpërfaqur stereotipa dhe krijuar paragjykime, të cilat edhe më shumë i thellojnë dallimet në mes të brezave.



Sot, të dy këto qasje janë prezentë edhe në shoqërinë shqiptare të cilat vetëm sa janë duke u thelluar.

SHKAQET DHE PASOJAT E KONFLIKTIT TË GJENERATAVE

Sociologët besojnë se konfliktet duhet të analizohen nga prizmi i rrethanave sociale, por edhe ndikimi i faktorëve të jashtëm dhe atyre të brendshëm. Konflikti i brezave mund të lindë “për shkak të perceptimeve të papajtueshmërisë midis individëve të brezave të ndryshëm, të tilla si dallimet në vlera, sjellje ose identitete. Këto konflikte mund të zgjidhen duke u fokusuar në arritjet, imazhin ose egon e dikujt. Të moshuarit shpesh janë kundër ndryshimit dhe moskonformitetit në krahasim me të rinjtë, përveç nëse përfshihet mirëqenia e tyre ekonomike. Megjithatë, dallimet globale në vlerat midis brezave mund të jenë dukshëm më të mëdha se dallimet brenda së njëjtës familje”.⁷ Paaftësia e “brezave të rritur për të kuptuar sjelljet e gjeneratave të reja mund të çojë në konflikte. Ndryshimet kulturore dhe konfliktet e lidhura me to mund të kontribuojnë gjithashtu në konfliktet midis brezave. Pabarazitë e bazuara në moshë dhe breza mund të krijojnë ndarje dhe konflikte sociale, të cilat mund të ndikohen nga ndryshimet aktuale shoqërore”.⁸ Studimi i teorisë së ciklit jetësor të Erik Erikson sugjeron se konfliktet midis brezave mund të lindin për shkak të fazave të ndryshme të zhvillimit psikosocial dhe diferencimit të profileve psikografike, të cilat janë evidente te secila fazë e ciklit jetësor dhe shoqëror. Kësisoj, studimet kanë theksuar disa nga shkaqet e konfliktit në mes të brezave, të cilat mund të jenë:

Vlerat e brezit: Çdo brez rritet në një kontekst unik social, ekonomik dhe kulturor, i cili formëson vlerat dhe besimet e tyre. Këto dallime në vlera mund të çojnë në përplasje midis brezave.

Ndryshimi social: Shoqëritë pësojnë ndryshime të rëndësishme me kalimin e kohës, si përparimet teknologjike, ndryshimet në normat kulturore dhe transformimet ekonomike. Këto ndryshime mund të krijojnë një hendek

brezash, pasi brezat e vjetër mund të luftojnë për t’u përshtatur me mënyrat e reja të të menduarit dhe të sjelljes.

Dinamika e pushtetit: Gjeneratat shpesh mbajnë nivele të ndryshme pushteti dhe ndikimi brenda shoqërisë. Ky çekuilibër i pushtetit mund të çojë në konflikte mbi burimet, vendimmarrjen dhe statusin social.

Hendeuku i komunikimit: Dallimet në stilet dhe preferencat e komunikimit mund të pengojnë komunikimin efektiv midis brezave. Keqkuptimet dhe keqinterpretimet mund të përkeqësojnë më tej konfliktet midis brezave”.⁹

Këta faktorë, por edhe faktorë të tjerë i hasim edhe te shoqëria jonë, të cilat manifestohen në dy aspekte: në familje, ku ekzistojnë dallime goxha të konsiderueshme në mes të brezave të vjetër dhe të rinj, madje një gjë e tillë vërehet edhe me dinamikën e jetës dhe migrimet, mos respektimi ndaj moshës së vjetër dhe dallime të tjera. Në aspektin e dytë, vërehet te puna dhe raporti kolegjial, ku të rinjtë, zakonisht moshat e vjetra i shohin pengesë dhe të vjetrit të rinjtë i shohin si të pa përvojë. Sociologët e shohin këtë fenomen në kuadër të ‘ageism’ ose diskriminimit në bazë të moshës, e cila vije si rezultat i faktorëve të shumtë, në mesin e tyre edhe këto të cilat i cekëm më lartë. Sa u përket pasojave, ato mund të reflektojnë në: raportet ndër njerëzore dhe ndër shoqërore, thellimin e konflikteve brenda familjes dhe rrethit social, mungesën e implikimeve të politikave publike, ndarjen dhe ndasitë, mungesën e komunikimit dhe të bashkëpunimit, rritjen e stresit dhe depresionit te gjeneratat e vjetra duke e parë vetën si pengesë apo të lënë pas dore, stagnimin e shoqërisë dhe krijimin e një modeli jo të mirë për gjeneratat e reja.

FEJA DHE KONFLIKTI I GJENERATAVE

Të kuptuarit e brezave na ndihmon të kuptojmë transmetimin e vlerave, formimin e normave shoqërore dhe ndikimin e grupeve të brezave në aspekte të ndryshme të zhvillimit të vetë shoqërisë. Kësisoj, feja mund të luajë një rol të rëndësishëm në aspektin e komunikimit të brezave dhe uljen e konflikteve. Feja është një nga elementët më të rëndësishëm të shoqërisë për të krijuar solidaritet shoqëror, kontroll shoqëror dhe për të zhvilluar jetën shpirtërore të individëve. Feja është “njohur prej kohësh si një “burim qytetar” i ndërveprimit shoqëror, duke ofruar një bazë për përvojat, identitetet dhe vlerat e përbashkëta që i bashkojnë njerëzit”.¹⁰ Në këtë segment, feja mund të luajë një rol me rëndësi në thyerjen e barrierave, uljen e dallimeve apo mospajtimeve ndërmjet gjeneratave apo brezave të rinj dhe të vjetër. Përmes leksioneve fetare, udhëzimeve, prijësit fetarë mund të ndikojnë që të rinjtë t’i shohin gjeneratat më të vjetra si resurs i nevojshëm për të ecur tutje dhe gjeneratat më të vjetra mund t’i shohin të rinjtë si ‘kapital social’ për të zhvilluar dhe emancipuar shoqërinë. Feja gjithashtu mund të ndikojë që hendeqet në mes të dy brezave të forcohen, të krijohet një kohezion social, dhe duke parë frikë respektin

ndaj Zotit dhe parimet e moralitetit, të dy brezat të bashkëpunojnë dhe krijojnë ura lidhëse në mes tyre, duke krijuar kështu një model social, një individ progresiv, një familje të shëndosh, një komunitet të fortë dhe një shoqëri stabile.

EDUKIMI, SFIDAT DHE E ARDHMJA

Zhvillimi i shoqërisë bashkëkohore përveç të mirave materiale dhe zhvillimeve të tjera në sfondin shkencor, informatikë dhe teknologjikë, ka krijuar edhe një lloj 'tjetërsimi' të njeriut, duke zbehur kështu raportet ndër shoqërore dhe duke krijuar një individualizëm tejet të theksuar. Brenga e njeriut modern do të jetë afilacioni apo nevoja për shoqëri, kjo për shkak se të rinjtë gjithnjë e më shumë janë duke krijuar një jetë individuale dhe janë duke kërkuar një jetë më të mirë. Një gjë e tillë nuk ndodhë vetëm në mjedisin tonë social, por në të gjithë botën. Në anën tjetër, shoqëria moderne përballet dukshëm me mplakje të popullsisë, e cila padyshim se do të jetë një ndër sfidat e kësaj shoqërie gjatë këtij shekulli. Sot, është më se i nevojshëm një edukim social, kulturor, fetar, progresiv, teknologjik konform nevojave bashkëkohore dhe në koherencë me kohën, në mënyrë që të ketë një gjeneratë, e cila do të fokusohet në respektimin, dinjitetin, progresin, bashkëpunimin me gjeneratat më të vjetra, do të promovon një barazi dhe drejtësi sociale, do të ketë fokus diversitetin etnik dhe kulturorë me qëllim të fuqizimit të kohezionit social, si mjet i një integrimi dhe gjithëpërfshirje sociale. Gjithsesi, në këtë kohë të kapitalizmit dhe globalizimit të proceseve duhet që vëmendja sociale të kthehet te familja si komponentë e shenjtë, si agjensë e socializimit, dhe siç thotë Parsons, te familja që konsiderohet se është një lloj fabrike, e cila prodhon personalitete njerëzore. Në këtë kontekst, është e nevojshme që të ulen hendeqet dhe dallimet e konfliktit në mes të brezave, dhe kjo përmes edukimit dhe emancipimit të shoqërisë, njëherësh duke u fokusuar: së pari, në komunikimin dhe dialogun e hapur në mes të brezave, duke respektuar njëri-tjetrin dhe duke krijuar hapësirë për mirëkuptim, ndihmesë dhe bashkëpunim. Së dyti, gjeneratat e ndryshme duhet pranuar diversitetin dhe dallimet e ndryshme brenda për brenda shoqërisë, sepse njerëzit janë të ndryshëm dhe kanë dallime në botëkuptime, vlera, kultura, norma apo besime. Përderisa ne respektojmë këtë diversitet, ne respektojmë vetën dhe shoqërinë e mjedisin social në të cilin jetojmë dhe veprojmë. Së treti, programet dhe iniciativat ndër breza si formë e trashëgimisë kulturore dhe sociale. Këtë formë shoqëria jonë e ka ruajtur me fanatizëm qysh herët dhe kjo formë ka vazhduar deri në ditët e sotme. Kjo është një komponentë e rëndësishme për ruajtjen e raporteve ndër shoqërore, fuqizimin e kohezionit social, respektin ndaj moshave dhe gjinive, etnive, grupeve sociale dhe të marginalizuara. Së katërti, edukimi dhe ndërëgjegjësimi si promovim dhe avokim për një të ardhme më të mirë,

sidomos në mjediset sociale në të cilat jetojmë, duke ndihmuar kështu në uljen e keqkuptimeve dhe në promovimin e mirëkuptimit midis brezave.

Prandaj, në shoqërinë bashkëkohore sot është më se e nevojshme që të gjithë akterët, qofshin institucional (përmes promovimit të politikave publike) qofshin organizata jo qeveritare, komuniteti dhe shoqëria e gjerë të promovon dhe avokon për inkurajimin e bashkëpunimit midis brezave, gjinive, grupeve etnike, fetare, kulturore apo komunitetit e cila mund të çojë në zgjidhje inovative dhe në një bashkëjetesë më harmonike për një të ardhme më të mirë.

Literatura

- Gunther, Johan: "Vendasit digjitalë dhe imigrantët digjitalë", Konet, Prishtinë, 2008.
 - LSE: "Religion bridges gap between boomers and millennials", botuar në <https://www.brunel.ac.uk/news-and-events/news/articles/Religion-bridges-gap-between-boomers-and-millennials>, dhe qasur gjatë muajit Korrik, 2024.
 - Maliqi, Nazmi: "Toleranca politike në funksion të paqes", FES, Shkup, 1999.
 - Mazreku, Q. Muhamet: "Sociologjia 11", Albas, Prishtinë, 2019.
 - McGuire B. Meredith: "Religjioni konteksti shoqëror", Logos – A, Shkup, 2007.
 - Mr. Edwards: "Intergenerational Conflict in Sociology: An Outline and Explanation", botuar në: <https://easysociology.com/sociology-of-family-relationships/intergenerational-conflict-in-sociology-an-outline-and-explanation/#:~:text=In%20the%20field%20of%20sociology,evolve%20and%20change%20over%20time> dhe qasur gjatë muajit Korrik, 2024.
 - Mr. Edwards: "The Concept of Generations in Sociology", botuar në: <https://easysociology.com/general-sociology/the-concept-of-generation-in-sociology/> dhe qasur gjatë muajit Korrik, 2024.
 - Scispace: "What are the causes of conflict between generations?", botuar në <https://typeset.io/questions/what-are-the-causes-of-conflict-between-generations-27g6jvlggd>, dhe qasur gjatë muajit Korrik, 2024.
-
- 1 Maliqi, Nazmi: "Toleranca politike në funksion të paqes", FES, Shkup, 1999, fq. 141.
 - 2 Mazreku, Q. Muhamet: "Sociologjia 11", Albas, Prishtinë, 2019, fq. 62.
 - 3 Mc Guire B. Meredith: "Religjioni konteksti shoqëror", Logos – A, Shkup, 2007, fq. 43.
 - 4 Mr. Edwards: "The Concept of Generations in Sociology", botuar në: <https://easysociology.com/general-sociology/the-concept-of-generation-in-sociology/> dhe qasur gjatë muajit Korrik, 2024.
 - 5 Po aty.
 - 6 Gunther, Johan: "Vendasit digjitalë dhe imigrantët digjitalë", Konet, Prishtinë, 2008, fq. 25.
 - 7 Scispace: "What are the causes of conflict between generations?", botuar në <https://typeset.io/questions/what-are-the-causes-of-conflict-between-generations-27g6jvlggd>, dhe qasur gjatë muajit Korrik, 2024.
 - 8 Po aty.
 - 9 Mr. Edwards: "Intergenerational Conflict in Sociology: An Outline and Explanation", botuar në: <https://easysociology.com/sociology-of-family-relationships/intergenerational-conflict-in-sociology-an-outline-and-explanation/#:~:text=In%20the%20field%20of%20sociology,evolve%20and%20change%20over%20time> dhe qasur gjatë muajit korrik, 2024.
 - 10 LSE: "Religion bridges gap between boomers and millennials", botuar në <https://www.brunel.ac.uk/news-and-events/news/articles/Religion-bridges-gap-between-boomers-and-millennials>, dhe qasur gjatë muajit korrik, 2024.

realizojë planin e tij në publik, ai e shpalli Kuranin fajtor për “krime kundër njerëzimit” dhe e realizoi djegien brenda kishës ku shërbente. Protestat u shtuan dhe vrasjet po ashtu, veç 150 të lënduarve pati edhe 30 të vrrarë, përfshirë edhe shtatë punëtorë të OKB-së³ dhe të dy ushtarëve amerikanë. Ndonëse u akuzua dhe u gjobit për keqpërdorim të titullit “doktor”, për keqtrajtim të fëmijëve, për shpërdorim të fondeve të kishës, për të dhunshëm e fanatik, natyrisht që gjeti edhe përkrahësit e tij islamofobë siç ishte vetë ai. Po atë vit, botoi edhe një polemikë “Islam is of the Devil”, ku nxirrte “britmat e luanit” për kinse rrezikun që i kanosej Amerikës nga myslimanët që “duan të imponojnë ligjin e sheriatit”!⁴ Këto qenë të mjaftueshme për të nxitur disa grupe fetare dhe për të vendosur çmime për kokën e tij.⁵ Më 22 prill 2011, Jones planifikoi një vizitë protestuese në Qendrën Islame të Michigan-it, por u arrestua dhe u burgos.⁶ Ndonëse famullia e kishës së Jones nuk kalonte 30 veta, shumë institucione shtetërore politike dhe kishtarë të Amerikës e dënuan si gjest të shëmtuar “të pa nevojshëm”, që krijon urrejtje ndërmjet popujve e besimeve.⁷

Në shkurt të vitit 2012, komandanti amerikan i trupave të NATO-s në Afganistan, John R. Allen, kërkoi falje pas lajmeve që trupat aleate kishin përdhosur disa kopje të Kuranit. Pas protestave të shumta, ai premtoi se do të nisë procesin hetimor dhe do të ndëshkojë fajtorët. Ndonëse raste të këtilla të ngjashme nuk kanë munguar, subjekti ynë sillet rreth mesazhit të djegies së një apo shumë librave në kuadër të së kaluarës historike.

Dihet se një patologji motivesh të ndryshme i shtynë grupet dhe individët e ndryshëm të djegin librat. Ato mund të jenë si një akt përbuzjeje për përmbajtjen ose autorin e librit, që synon të tërheqë vëmendjen e publikut të gjerë ndaj kësaj përmbajtjeje ose të fshehtë informacionin që përmban teksti në mënyrë që të mos bëhet publike, si për shembull ditarët ose regjistrat. Kur është fjala për Librin e Shenjtë, është akt i përbuzjes së një komuniteti të tërë. Nganjëherë realizohej nga autoritetet laike ose fetare, në përpjekje për të shtypur kundërshtuesit apo heretikët,

Tiranët gjatë historisë, nga Kina Perandorake deri te Stalini e Kastro, janë përpjekur të shuajnë në mënyrë parandaluese rebelimin, duke eliminuar tekstet subversive nga popullsia. Libra të tillë madje kanë rezultuar fatale për vetë autorët e tyre, por kjo histori është shumë më e vjetër dhe i përket periudhës antike.

pikëpamjet e të cilëve perceptoheshin si kërcënuese të rendit mbizotërues. Në raste, këto vepra të shkatërruara janë të pazëvendësueshme dhe djegia e tyre përbën një humbje të rëndë për trashëgiminë kulturore.

Për ata që e luftonin fjalën e shkruar, mënyra më e mirë për zhdokjen e librave ishte djegia e tyre në vende publike, në sheshe, ura, në afërsi të kishave, etj., që frekuentoheshin më së shumti nga njerëzit. Librat e djegura shndërroheshin në tym bashkë me “mendimet blasfemuese e heretike” që shpreheshin në to. Në vitin 1880, William Blades (1824-1890) botoi librin “The Enemies of Books” [Armiqtë e librit], libër që u ribotua sërish më 1881, 1888, 1902 dhe së fundmi në versionin digjital. Në kapituj të ndryshëm, ai diskuton mbi armiqtë e librave, si zjarri, uji, ngrohja, pluhuri, myku (lënia pas dore), grabitja dhe djegia. Nga kohët e lashta djegia e librave ishte një metodë censurimi. Si simbol i dijës dhe mendimit të lirë, përfaqësonte armikun e regjimeve diktatoriale dhe frymëzimet për rebelimin e njerëzve kundër shtypjes. Djegia e tij ishte një mënyrë efektive për kontrollimin e njerëzve përmes frikësimit, duke u mohuar atyre qasje në informacione. Ndonëse bibliotekat ndonjëherë janë dëmtuar aksidentalisht ose si pasojë e ndonjë fatkeqësie natyrore, shpesh janë shkatërruar qëllimisht si një formë e pastrimit kulturor.

Tiranët gjatë historisë, nga Kina Perandorake deri te Stalini e Kastro, janë përpjekur të shuajnë në mënyrë parandaluese rebelimin, duke eliminuar tekstet subversive nga popullsia. Libra të tillë madje kanë rezultuar fatale për vetë autorët e tyre, por kjo histori është shumë më e vjetër dhe i përket periudhës antike. Shembulli më i vjetër është i shënuar në Athinë, kur filozofi grek, Protagora, kishte shkruar tekste ku blasfemoheshin zotat paganë. Me vendim të udhëheqësisë së qytetit, në vitin 411 p.e.r., tekstet e tij u dogjën, kurse Protagora u dëbua nga Athina. Më pastaj është koha e dinastisë kineze së Qin Shi Huang-ut (213–210 pes), i cili njihet më mirë si perandori që filloi



ndërtimin e Murit Kinez. Nën urdhrat e tij librat digjeshin bashkë me autorët e tyre, në mënyrë që të ruante fronin.⁸ Thuhet se kjo ngjarje shkaktoi humbjen e shumë traktateve filozofike të njëqind shkollave të mendimit historik dhe filozofik.⁹

Gjatë periudhës romake, perandori Dioklecian (245-316) në vitin 297 të erës së re, urdhëroi të digjen të gjitha librat, bibliotekat, si dhe të mbyllen të gjitha shkollat të cilat paraqisni rrezik potencial “për stabilitetin e Perandorisë Romake”.¹⁰ Si grekët, ashtu edhe romakët, shpesh urdhëronin djegien e shkrimeve hebraike dhe të krishtera. Më pastaj, pas Këshillit të I-rë të Nikesë (325 e.s.), perandori romak Konstandini i Madh nxori një dekret kundër arianëve jo-trinitarë, i cili përfshinte një recetë për djegien sistematike të librave. Ai porosiste që çdo shkrim i Ariusit duhej t’i dorëzohej zjarrit, në mënyrë që “të zhdukej ligësia e mësimëve të tij” dhe të mos mbetej asgjë nga ajo që do ta kujtonte. Në rast se dikush do të zbulohej të ketë fshehur një shkrim të tij, do të dënohej me vdekje.¹¹ Në këtë kohë ishin prezent rreth 270 versione Ungjijsh, nga të cilët duhej të përzgjidheshin “Ungjijtë kanonikë” dhe të gjithë të tjerët të digjeshin, një “nevojë” që duhej realizuar më vonë edhe në mbretërinë visigot Flavius Reccared i I-rë i Spanjës (559-601), i cili u konvertua në katolik (587).¹²

Posedimi i Ungjijve jo-kanonikë e të pa autorizuar nga Kisha, konsiderohej vepër penale dhe dënohej me vdekje. Lufta më e ashpër u bë kundër “Ungjillit të Barnabës”, duke filluar me dekretin e Papa Damasusit (304-384), të Glasianit (496), të papa Hormisdasit (514-523), etj.. Të njëjtin fat poseduan edhe librat e nestorianëve.¹³ Peshkopi i zëshëm i Aleksandrisë – Athanasius në urimin e Pashkëve (381), u

kërkoj murgjve të shkatërronin të gjitha shkrimet e papranueshme për të lënë vetëm ato kanonike, të cilat sot përbëjnë “Beslidhjen e Re”.¹⁴ Më vonë, në Koncilin e Parë të Kostandinopojës (381), mbreti Theodos i I-rë solli vendimin për djegien e të gjitha librave të heretikëve të ashtuquajtura “pneumatoma”, siç vepruan më pas perandori Valentian i III-të dhe Marcijani (455) ndryshe nga mbreti Jovianus (361-364) që urdhëroi të digjet tërësisht biblioteka e madhe pagane e Antiokisë.

Gjendja mbeti relativisht e njëjtë edhe në tubimin kishtar të Lateranit në Romë (743), kur u morë vendimi që të gjitha tekstet teologjike të Adalbertit të zhduken tërësisht, ndërkohë që pas një shekulli (IX) kemi dokumentin e ruajtur në Arkivin e Vatikanit: “Response Nicolai I Papae ad consulata Bulgarorum”, sipas të cilit papa Nikolla i I-rë (858-867), këshillon Borisin bullgar që t’ia dorëzojë zjarrit të gjitha librat që ua kishin konfiskuar myslimanëve sarçenë, pasi i kishin detyruar të konvertoheshin në krishterim, sepse: “kuvendimet e këqija e prishin moralin e shëndoshë...” Është pikërisht ajo kohë kur skepticizmi i shumë sundimtarëve të Ballkanit ndaj Kishës, ishte orientuar ndërmjet Bizantit ose Romës dhe bëheshin orvatje për supermacinë fetare, duke shkaktuar konflikte të shumta e të ashpra ndërmjet tyre, me theks të veçantë kundër dijetarëve dhe librave, për çka na shpjegon në hollësi Maks Alfred Buri. Këtë fat patën edhe Bogumilët e Bosnjës në Serbi, të cilëve jo vetëm që ju digjin librat, por edhe ua pritnin gjuhën autorëve (1097).¹⁵ Burimet historike flasin se trevat e Perandorisë Bullgare mesjetare, ku bënë pjesë edhe shumë vise të Shqipërisë etnike, kanë pasur shumë myslimanë dhe më se një herë në Perandorinë e Bullgarisë janë djegur librat e tyre.¹⁶

Në shekullin XIII, me pushtimin mongol të Bagdadit (1219-1220), u shkatërrua “Shtëpia e Urtësisë” dhe u dogjën dhjetëra biblioteka dhe dhjetëra mijë libra. Këtë fat e pësoj edhe qyteti Rej (Persi), ku ishte një bibliotekë e madhe, e cila thuhej se kishte aq dorëshkrime me të cilat mund të ngarkoheshin rreth katërqind deve. Në Evropë papa Gërguri i IX-të kishte filluar fushatën kundër hebrenjve, duke ua djegur të gjitha librat e tyre teologjike (1236), urdhra që pasuan edhe gjatë viteve 1239 dhe 1244, kur në rrugët e Parisit “oficerët e ligjit” burgosën rabinët dhe dogjën 24 qerre me disa mijëra libra hebreje, të cilat ishin mbledhur nëpër vende të Evropës dhe ishin sjellë për t’u “grykuar” për shkatërrimin e Krishterimit. Deri në fundin e këtij shekulli, Edikti i Tuluzit në Francë (1299) ua ndaloi laikëve që të posedojnë dhe të lexonin tekstet e shenjta biblike, ndalesa që u bënë edhe në vende të tjera të Evropës mesjetare: Angli, Spanjë, Itali etj. Me ndërprerje të shkurta kjo situatë do të vazhdojë edhe në shekujt vijues, më e shënjuara prej të cilave ishte viti 1533, kur me urdhrin e papës, sheshi i Shën Markut u mbulua nga hiri i librave të djegura hebreje, përfshi edhe Talmudin.

Marsel Kash në “Historia e civilizimit”, do të shkruaj për periudhën e shekullit XV, kur u gjykuan me vdekje, apo u hodhën në burgje të errëta rreth pesë milion njerëz me urdhër të dekretit papnorë. Ai thotë se ndërmjet viteve 1481 dhe 1499, me vendimin e gjykatës së inkuizicionit u dogjën 1.020 njerëz, u çanë përgjysmë 6.860 dhe u torturuan për vdekje 97.023 njerëz. Edicioni i vitit 1911 të Enciklopedisë Britanike thotë se me urdhrin e gjykatës kishtarë, në Evropë u dogjën 350.000 dijetarë dhe njerëz të arsimuar. Në analet e historisë ka mbetur i shënuar rrëfimi i një të moshuar nga Granada e Spanjës, e cila në dhjetor të vitit 1499, me qëllim që t’i ruaj librat e saj nga xhelatët inkuizicionistë, u bëri lutje disa tregtarëve që udhëtonin me anije: “Ju lutem, këto libra medoemos t’i dërgoni diku. Dërgoni në universitet në Kajro ose në Fes, për to këtu nuk ka shpëtim.” Inkuizicionisti famëkeq i Spanjës, françeskani Francisko Ksimenes de Cisnerosi (1436-1517), nuk deshi të mjaftohet me dhunën që ua shkaktoi myslimanëve dhe hebrenjve, por urdhëroi të zhduken edhe të gjitha librat e tyre në Granadë. Kështu në sheshin “Bab ul-Ramle” të Granadës u tubuan dhe u dogjën

Në fundin e viteve të 1920 dhe 1930, kur në Azerbajxhan u miratua alfabeti i modifikuar latin, librat dhe dorëshkrimet e tjera që ishin botuar në alfabetin arab u dogjën, përfshirë ato mjekësore dhe historike.

më shumë se tetëdhjetë mijë libra, ndërsa në gjithë Granadën, gjatë aksioneve të kriminelit Ferdinand, janë djegur afër tetëqind mijë libra (1499). Në dramën e tij të vitit 1821 “Almansor”, shkrimtari gjerman Heinrich Heine, duke iu referuar djegies së librit të shenjtë mysliman (Kuranit), gjatë inkuizicionit spanjoll, ai shkroi: “Kur i digjnin ata librat, në fund digjnin edhe qeniet njerëzore”. Pas më shumë se një shekulli, librat e Heines ishin në mesin e mijëra vëllimeve që po digjnin nazistët në Berlin.¹⁷

Françeskani Diego de Landa (1524 – 1579) udhëtoi nëpër Meksikë ndërmjet viteve 1549 dhe 1562, kur Spanja ishte përfshirë në pushtimin e këtyre vendeve dhe konvertimin e kësaj popullsie indigjene në Krishterim. Në “Relacion de las cosas de Jukatan”, ai tregon për një seri djegiesh të librave në Jukatan që u realizuan atje gjatë vitit 1562.¹⁸ Ndonëse kodet Maya dhe libra të tjerë ishin të shkruara me “karakterë indianë” dhe nuk kuptuan gjë nga ato, ai nuk ngurroi të ngrite akuza se: “ato nuk përmbanin asgjë, por besëtytni dhe gënjeshtria të djallit, dhe ne i dogjëm...”¹⁹.

Kjo ishte mendësi që kishin përfituar nga situata në Evropë, pas themelimit të kishës së Anglisë, kur mbreti Henry i VIII-të (1491-1547) u shkëput nga Kisha Katolike dhe çoi në shënjestër katolikët e Anglisë nga protestantët. Gjatë periudhës Tudor dhe Stewart, protestantët që ishin besnikë të mbretërisë, sulmuan vendet fetare katolike në të gjithë Anglinë, duke djegur çdo tekst fetar që gjenin. Vetë mbreti i bëri presion publikut për të marrë pjesë në “spektakle” të tilla të djegieve të librave! Historiani Amerikan David Cressy thotë se: “gjatë shekujve XVI dhe XVII, djegia e librave u zhvillua nga një dukuri e rrallë në një rastësi, u zhvendos nga një procedurë e jashtme në një procedurë të brendshme dhe u ndryshua nga një shfaqje burokratike në një shfaqje thuajse teatrale”²⁰.

Në vitet 1520-1534, u persekutuan rreth 45 individë për shkrimet e tyre, përfshirë edhe Thomas Moore, që kishte ngritë zërin kundër protestantizmit në Angli dhe kërkonte të digjeshin librat dhe njerëzit, siç u veprua me protestantin e njohur Thomas Bilney.²¹ Në ditën e Krishtlindjeve të vitit 1549 pastaj, u bë një ndryshim në rrethin mbretëror, duke nxjerrë një urdhër për shkatërrimin e të gjithë librave shërbyese latine.²² Tetë vjet më pas (1557), në Kembrixh të



Anglisë, në mënyrë solemne u dogjën edhe eshtrat e reformatorëve (tanimë të mbytur) Martin Bucer (1491-1551) dhe Paul Fagius (1504-1549), bashkë me librat e tyre “heretike”. Pas shtatë vitësh (1564), u formula një indeks “Trident” i librave të ndaluara që përmbante rregulla (Regulae) censurimi dhe i dedikohej ndalimit të qarkullimit të librave të ndaluara. Më 1571, një indeks tjetër me emrin “Congregatio Indicis librorum prohibitorum” e themeloi papa Piu i V-të, në të cilën figuronin edhe emrat, si: Galileu, Bruno, Dekarti, Stendali, Spinoza, Balzaku, Zola, etj.. Djegiet e librave me karakter të ndryshëm, ishin bërë përditshmëri. Kishte raste kur botuesi ose shitësi i librave të ndaluara të dënohej me vdekje, siç ngjau me Pietro Longon, i cili në vitin 1588 u mbytur me urdhër të inkuizicionit në Venedik.

Krime të tilla janë manifestuar edhe nga blloku ortodoks. Një shembull ilustrues e kemi me Krimenë, ku në kryeqytetin Bahçesaraj, ishte një xhami dhe një bibliotekë e madhe me një fond prej disa dhjetëra mijëra librash. Në shekullin XVIII, gjatë konflikteve me ushtrinë osmane, rusët i kishin djegur pothuajse të gjitha objektet që u shërbyen myslimanëve, përfshi edhe bibliotekën e madhe të qytetit. Deri në prag të Revolucionit Francez (1789-1799), zyrtarët francezë e zbatonin ligjin kundër autorëve të teksteve blasfemuese duke i mbyllur në kështjellën-burg që gjendej në Bastiljë, një burg ku ishin mbyllur edhe veprat e Volterit, Rusosë, Holbahut etj..

Gjatë Luftës së vitit 1812, pas një sulmi britanik në Bladensburg, britanikët marshuan drejt Washingtonit (DC) për të pushtuar qytetin. Për hakmarrje të shkatërrimit të Port Doverit, ata urdhëruan shkatërrimin e disa ndërtesave publike në qytet, përfshirë Bibliotekën e Kongresit, të ngritur vetëm katërbëdhjetë vite më parë. Disa libra pastaj i përdorën për t'i vënë zjarrin Selisë së Kongreseve.²³

Pas 61 vjetësh (1873), në Nju Jork, u themelua “Society for the Suppression of Vice”, e cila synonte mbrojtjen e moralit të krishterë. Sekretari i kësaj shoqërie, Anthony Comstock (1844-1915), si aktivisti më i përkushtuar vlerësohet të jetë shkak për shkatërrimin e rreth 15 ton librash, dhe i afërsisht 4.000.000 fotografish. I gjithë ky material u konsiderua si “i shthurur” dhe të gjithë bashkëpunëtorët e tij lobuan me

sukses në Kongresin Amerikan për të vendosur “Ligjin Comstock”.

Në fundin e viteve të 1920 dhe 1930, kur në Azerbajxhan u miratua alfabeti i modifikuar latin, librat dhe dorëshkrimet e tjera që ishin botuar në alfabetin arab u dogjën, përfshirë ato mjekësore dhe historike.²⁴ Në konfliktin me Japoninë më 1936, Kina ka humbur rreth 2.5 milion vëllime nga 2.742.108 vëllime që kishte të regjistruar.²⁵

Më 10 maj të vitit 1933, në Berlin, në prezencën e 40.000 “spektatorëve” nazistët dogjën librat e autorëve hebrejë dhe shkrime të tjera të autorëve Mann, Brecht, Marx, Hemingway, London, etj, që konsideroheshin “jo gjermane” dhe të cilët ishin në listat e zeza të nazistëve. Në fillimin e konfliktit me Austrinë (1938), viktima e parë e konfliktit ishte plaçkitja e bibliotekave publike dhe private të Vjenës, një pasuri akademike e paçmueshme, shumica e të cilave ishin vjedhur nga austriakët në luftën paraprake! Gjermanët hodhën në flakë edhe 35 biblioteka të mëdha dhe dhjetëra të tjerë të vegjël në vendin e tyre, ndërkohe që në 14 bibliotekat e Varshavës, të gjitha librat u dogjën.

Djergia e librave është zakonisht një manifestim publik i urrejtjes. Për sa kohë që ka pasur materiale të konsideruara të shthurura, blasfemike ose politikisht jo korrekte, ka pasur përpjekje për t'i ndaluar ato. Ky veprim ka përfaqësuar një element censurimi mbi baza ideologjike dhe zakonisht ka rrjedhur nga një kundërshtim kulturor, fetar ose politik,²⁶ por rezultati i tyre ka qenë që shumë kryevepra me përmbajtje e njohuri universale e historike janë humbur përgjithmonë.

1 New Yorker, 30.05.2005.

2 MSNBC, 11.9.2010.

3 The New York Times, 1.04.2011.

4 ABC, 7.09.2010.

5 The Australian, 16.04.2011.

6 The Washington Post, 30.04.2011.

7 Sunshine News, 8.09.2010.

8 BBC News, 15.10.2012.

9 Th. Evans: “Great Wall of China”, 2006.

10 Journal of Library History, #2/1980.

11 Athanasius, 23 January 2010.

12 Gibbon:1782, f.1776–1789.

13 A. Grant: “The Nestorians”, 2018.

14 E.H. Pagels: “Beyond Belief”, 2003.

15 Wright: “Heretics”, 2011, f.198.

16 Handzic: “Islamizacija Bosne i Hercegovine”, Sarajevo, 1940.

17 The Guardian, 10. 09.2010.

18 The Washington Post, 13.11.2021.

19 Todorov: “The Conquest of America”, 1999, f.200.

20 The Sixteenth Century Journal, #36 (2)/2005, f.: 359–374.

21 Dickens: “The English Reformation”, 1989, f.293-301.

22 Huges & Larkin: “Tudor Royal Proclamations”, I, 1964

23 Smithsonian Magazine, 31.08.2017.

24 Azerbaijan International, Vol. 7:3, Vjeshtë 1999, f. 74-75.

25 P. Li: “Japanese War Crimes”, 2003, f. 281, 285.

26 United States Holocaust Memorial Museum, 5.03.2012.

Kriza e leximit dhe “hegjemonia” e teknologjisë

BRAKTISJA E LIBRIT, LEXIMI VIRTUAL MUNDËSI E RE APO NGECJE?

Imer Topanica

Skeptikët konstatojnë se vorbulla e injorancës tashmë e ka kapluar globin, qysh kur është vënë në përdorim masiv teknologjia informative dhe interneti. Sipas tyre, leximi i librit ka mbetur në margjina të listës së gjërave që duhet bërë. Dhe, nuk është tamam një injorancë dosido, por e kontrolluar nga grupe të fuqishme të interesit, meqë të gjithë lexojnë dhe mësojnë nëpërmjet kanaleve përafërsisht të njëjta, duke u bërë viktima të atyre që ofrojnë, fjala vjen, rrjetet sociale, ndërsa pavetëdjshëm futen nën ombrellën e një botëkuptimi, ku secili me secilin i ndanë, përafërsisht, vlerat e njëjta. Megjithatë, edhe sikur ta marrim të mirëqenë këtë këndvështrim, eksperiencia njerëzore na mëson se jo çdoherë risitë në shkencë dhe teknologji, bëhen vegla të atyre që kanë qëllime të këqija.

RETROSPEKTIVË

Një histori e rrëfyer si nëpër mjegull që i referohet periudhës së vonshme të Perandorisë Osmane, na mëson se si frika nga zhvillimi teknologjik, shpesh mund ta ngadalësojë zhvillimin e shoqërisë, e në variantin më të keq, edhe ta çojë atë drejt humnerës së prapambetjes. Rasti historik të cilit po i referohemi, ndërlidhet me shpikjen e makinës së shtypit që i atribuohet gjermanit Johannes Gutenberg (1397 - 3 shkurt 1468)¹, një teknologji revolucionare e kohës, të cilën myslimanët e përvetësuan me shumë, shumë vonesë.

Studiuesit të cilët janë grishur nga kjo vaki, ndonëse e pranojnë se iu mungojnë burimet primare, konstatojnë se kjo teknologji ishte e ndaluar për më shumë se një shekull në kohën e Perandorisë Osmane.



“...Sulltan Bajaziti II me të shpejt ndaloi shtypjen e çdo libri dhe urdhri i tij u përsërit nga Sulltan Selim I në 1515, ndërsa u cilësua si krim i rëndë që shpaguej me vdekje”, konstaton Caroline Finkel te libri i saj i njohur “Osman’s Dream: The History of the Ottoman Empire”²

Një pjesë e historianëve vënë në dukje se pikërisht ky “obskurantizëm” i osmanlinjve, bëri që shoqëria perandorake të zvetënohej, e të mbetej prapa me atë perëndimore, e për rrjedhojë edhe të ngelej si një relik në kapitujt e historisë.

Edhe sikur të mos ketë asgjë të vërtetë në këtë mes, mësimin që duhet ta nxjerrim nga kjo është se, jo çdoherë “fobia” nga e reja, mund të jetë e shëndoshë.

RIKTHIMI NË REALITET: A KA KRIZË LEXIMI?

Gjetjet e hulumtimeve të kryera nga organizata të ndryshme, vënë në dukje që shoqëria jonë, vijon të mos e kultivojë kulturën e leximit. Vitin e kaluar, në Ditën Botërore të Librit, Organizata ETEA dhe Shtëpia Botuese “Dukagjini”, publikuan të gjeturat e një hulumtimi, sipas së cilit, mbi 30% e kosovarëve të anketuar nuk kanë qenë në gjendje ta përmendin një libër të lexuar së fundmi.

- 31.29% e qytetarëve të Kosovës nuk dinë të përmendin asnjë libër të lexuar;

- 52.24% nuk arrijnë t’i listojnë tre tituj librash në total;

- 16.6 % e qytetarëve thonë se nuk lexojnë asnjë libër në vit;

- 38.3 për qind thonë se lexojnë vetëm 1-3 libra për vit.

Këto dhe shifra të tjera janë të dhëna alarmante, të cilat do të duhej të nxisnin mobilizimin e shoqërisë, e sidomos institucioneve. Politikat kulturore e sidomos arsimore, reflektojnë probleme, meqë brezat e rinj, më fort i ekspozohen një edukimi joformal, se sa që kultivohen nëpërmjet sistemit arsimor.

Këtë e vërtetojnë edhe të dhënat e Testit të Arritshmërisë, të publikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI).

Vitin e kaluar,
në Ditën
Botërore të
Librit,
Organizata
ETEA dhe
Shtëpia
Botuese
“Dukagjini”,
publikuan të
gjeturat e një
hulumtimi,
sipas së cilit,
mbi 30% e
kosovarëve të
anketuar nuk
kanë qenë në
gjendje ta
përmendin një
libër të lexuar
së fundmi.

“Arritshmëria në Gjuhën shqipe është %56.9, në Gjuhën angleze është %69.3, në Histori është %57.5, në Gjeografi është %56.8, në Matematikë është %43.1, në Informatikë është %47.4, në Fizikë është %46.5, në Kimi është %43,4 dhe në Biologji është %48.8” – janë disa nga rezultatet e këtij testi.

Të shumtët prej atyre që i komentuan këto rezultate, ishin të pajtimit se problemet e sistemit të arsimit, veç që janë të shumta, janë edhe të vjetra e të thella. Në një anë, vetë letërsia – si një “instrument” i cili i josh masat, e veçmas të rinjtë në kuptimin e kultivimit të shprehisë së leximit, nga institucionet tona përdoret në mënyrë të mbrapsht. Ky është një konstatim bukur i vjetër i përhapur edhe në mesin e studiuesve të letërsisë, por edhe shkrimtarëve.

“Sa e kam parë unë botën, poezia jepet shumëkund si një lloj territori didaktik, pa e ditur kurrë përse; duke insistuar që ajo të bëhet me zor pjesë e atij logosi edukativ në trajtën e një retorike të bezdisshme, që në rastin më të mirë prodhon një efekt të përgjithshëm kulturor. Ajo mësohet dhe nuk zhvillohet si shkathtësi perceptimi, përjetimi e njohjeje. Më vjen turp nga vetvetja dhe nga poezia, kur kujtoj se kam bërë edhe unë diçka përafërsisht të tillë” – konstaton me të drejt studiuesi Kujtim Rrahmani.³ Ndërsa e zgjerojmë gamën e këtij problemi, mund të shtojmë se, në shumicën e rasteve literatura letrare e cila vihet në funksion të didaktikës nëpërmjet sistemit tonë arsimor, është ideologjikisht e kontaminuar, e skicuar sipas mësimëve të vjetra të soc-realizmit dhe komunizmit, duke ua bërë kështu edhe më të huaj lëndën vocërrakëve tanë dhe, madje, edhe më të padëshiruar. Si mund të joshen nga një literaturë e përpiluar dhe përgatitur keq? Shtoja kësaj edhe “mërzinë” e shpjegimit të gramatikës, teoritë e thata, pa jetë, pa lojë, të cilat e përkeqësojnë edhe më keq situatën, pra, po e ri-përsërisim: si mund të presim që brezat e ri të “dashurohen” në libra?

“HEGJEMONIA” E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE DHE RRJETEVE SOCIALE

Të rinjtë sot operojnë lirshëm në hapësira virtuale, falë edhe njohjes së gjuhës angleze, e



cila iu imponohet, meqë është e lidhur ngushtë me zhvillimin e teknologjinë informative. Kjo, veç të tjerash, ua hapë edhe perspektivën, duke ua ofruar mundësitë që ata të lidhen më shpejt me tregun global, por në anën tjetër, i shkëputë dhe i izolon në planin lokal. Psikologët, andaj, rekomandojnë që prindërit të mbikëqyrin përdorimin e celularëve të mençur nga ana e fëmijëve, por, megjithatë, kjo shpeshherë rezulton e pamjaftueshme.

Në shumë vende të botës, shtetet e fuqishme, kanë hartuar strategji për mbrojtjen e fëmijëve nga të këqijat që i sjell teknologjia. Sigurisht, as strategjitë nuk është se garantojnë rezultate të pritura, por këto janë përpjekje të cilat askush prej nesh, nuk i ka menduar, e aq më pak t'i ketë iniciuar në planin e politikave arsimore e edukative.

Këta breza, duke qenë njohës më të mirë të anglishtes, se sa të shqipës, ata të paktët që i shpëtojnë “obskurantizmit” didaktik, priren të lexojnë më shumë në anglisht se sa në shqip. Nëse i kontrollojnë faqet e librarive dhe shtëpive botuese në Kosovë, sidomos llogaritë e tyre në rrjetet sociale, vëren që ato më të njohurat, më shumë ekspozojnë libra nga autorë të huaj apo përkthime të tyre, se sa letërsi vendore. Letërsia e autorëve vendorë, veçmas atyre që janë të gjallë, qëndron shumë, shumë larg vitrinave të këtyre institucioneve kulturore.

Kështu përfundojmë te një konstatim se, problemi është shumë më kompleks se sa që mendojmë.

“PËRGJIGJA NUK ISHTE LIBRI”⁴

Një botues nga Kosova, pas mbylljes së panairit të sivjetmë të librit, në një artikull të publikuar në një të përditshme tonën, analizoi deri në detaje vijimësinë e këtij eventi kulturor.

Ai me dëshpërim pranoi se “ky ishte edicioni më i dështuar i organizuar që prej origjinës së tij në Kosovë nga e njëjta shoqatë e, pothuajse, edhe nga po të njëjtit persona.” Fjala është për Berat Armagedonin, i cili edhe vetë është autor i disa librave studimor. Ai jep një ogur të keq edhe për vitin e ardhshëm, parashikon që ai të jetë edhe më i keq...

ZGJIDHJA?

Ndërsa i kemi parasysh të gjitha këto pengesa që i përmendëm më sipër, duke mos e lënë mënjanë edhe një kryesoren: personaliteti i mësimdhënësit, roli i tij në vetëdijësimin dhe mbjelljen e dëshirës të nxënësit për lexim, çfarë mund të bëjmë më tepër, kur ky i fundit ka armiq shumë të sofistikuar: telefonin e mençur, rrjetet sociale, lojërat virtuale etj.?

Duhet t'i studiojmë shoqëritë e zhvilluara, modelet që ato i ofrojnë në planin e sistemeve edukative, të përgatisim kadro që i përvetësojnë njohuritë adekuate dhe më pas, të përpiqemi ta mbjellim te brezat e ardhshëm dëshirën për nxënie të dijës, për librin dhe leximin.

A kemi autoritet moral e intelektual që i nxitë instrumentet e shtetit ta jetëson këtë vizion? A kemi entitet politik që e ka atë? Jo! Hë për hë, edhe këtu qëndrojmë keq. Por duhet të përpiqemi, sidomos ne myslimanët... fundja, për ne, ky është xhihadi i këtij shekulli!

1 https://sq.wikipedia.org/wiki/Johannes_Gutenberg

2 https://www.goodreads.com/book/show/361130.Osman_s_Dream

3 Kujtim Rrahmani: antropoetika; AIKD, Prishtinë, 2008, f – 9.

4 <https://www.epokaere.com/pergjigja-nuk-ishte-libri/>

Dokumentet arabe në arkivat shqiptare (2)

Mr. Vehbi Shatri

DORËSHKRIMET ARABE NË ARKIVAT SHQIPTARE

Nga Arkivi Qendror i Shqipërisë, veçojmë dorëshkrimin në fushën e letërsisë “Lejla dhe Mexhnuni”. Në fondin (koleksione dorëshkrimesh osmane, arabe e perse), dosja 383, ruhet një dorëshkrim që përmban historinë e dashurisë mes Lejlës dhe Mexhnunit.¹

Teksti origjinal i fragmentit të Defterit të Rumelisë, nr. 12, të vitit 1452, me këtë titull “Hasha-i pashay-i A'azam-i rumeli begi der vilazet-i uskup ve zelec ve vilk ili ve vilazet-i arnavid-arnavud”.² Teksti është shkruar në 60 fletë letre me përmasa 180 x 135 mm, në osmanishte me alfabet arab. Autori i veprës është Muhamed Fuzuli, i cili e shkroi atë në vitin 1219 h / 1804, dhe është bërë një kopje shtesë nga Ismail, i biri i Hysejnit. Libri trajton historinë e një dashurie të pamundur mes Lejlës dhe Kajsit, i ashtuquajtur Mexhnun (i çmendur), përshtatur në osmanisht sipas origjinalit të shkrimtarit pers Nizami Ganjavi.

Po ashtu një kontribut të çmueshëm e ka bërë edhe orientalisti nga Shqipëria, Ermal Bega, që në arkivin e tij personal ka tubuar rreth 100 libra dhe dorëshkrime të vjetra, kryesisht me shkrim arab, që i përkasin lëmenjve dhe fushave të ndryshme, në përgjithësi islame.

Pjesa më e madhe e dorëshkrimeve kanë data sipas kalendarit hënor-hixhri dhe në këtë mënyrë mund të përcaktojmë cilës kohë i përket saktësisht një shkrim.


KLASIFIKIMI I DORËSHKRIMEVE NË ASPEKT KOHOR

Pjesa më e madhe e dorëshkrimeve kanë data sipas kalendarit hënor-hixhri dhe në këtë mënyrë mund të përcaktojmë cilës kohë i përket saktësisht një shkrim. Gjithashtu si përcaktues më të mirë të kohës janë kalendarët që shpesh janë edhe të zbukuruar me vijëzime.³

Dorëshkrimet në gjuhët orientale, të cilët na bëjnë të kuptojmë më shumë për atë periudhë janë gjithashtu vizatime të armëve të ndryshme të asaj periudhe, ndarja e trashëgimisë, kodi juridik i dënimeve, rregullat e sjelljes së fëmijëve në osmanishte me shkronja arabe, etj.. Dorëshkrim mbi misticizmin, mbi lumturinë pas vdekjes, për krijimin e botës dhe sekretin e krijimit, shpjegime për magjitë, etj., i bashkëngjitën dorëshkrimeve të periudhës osmane, të cilat janë sikur dhe shumica prej tyre me alfabet arab.

Në një periudhë më të vonshme, prej së cilës numërohen rreth 150 njësi bibliotekare që mbajnë vullën e sundimtarëve të Shkodrës, Mustafa dhe Karamahmut Pashë Bushatlliu, i shtohen pasurisë së dorëshkrimeve në gjuhët orientale.

Dorëshkrimet në gjuhën perse, arabe dhe osmane, që mbartin arkivat e Shqipërisë dhe Kosovës si dhe Shkupit, janë fonde të pa



eksploruara mirë, të cilat do të jenë në të ardhmen në fokus të gjuhëtarëve, historianëve, studiuesve të fesë, kulturës dhe të artit për të zbuluar më shumë, apo duke thyer teori apo mendësi për këtë periudhë.

Në Agjencinë Shtetërore të Arkivave në Prishtinë, te fondet personale, ndër to është edhe Fondi Jusuf Lata i Deçanit, i cili ishte roje i Manastirit të Deçanit.

Përmbajtja e materialit: Libra, dorëshkrime në gjuhën osmane që flasin për të kaluarën historike, dorëshkrime në gjuhën arabe me përmbajtje fetare.⁴ Materiali u ble më 14.11.1986, në kutinë e parë gjendet lista e materialit arkivor nga Jusuf Lata.⁵

Fjalor terminologjik në gjuhën osmane me alfabet arab; Ungjilli në gjuhën osmane me alfabet arab; Mevlud – dorëshkrim në gjuhën osmane me alfabet arab; Gramatikë arabe në gjuhën osmane me alfabet arab; Libër gjeografie në gjuhën osmane me alfabet arab; Shpjegime të haditheve, dorëshkrim i shkruar në vitin 1196 h; libër fikhu – shpjegime të rregullave islame shkruar nga Muhamed Halusi në gjuhën arabe; Libër për jetën e Muhamedit në gjuhën serbe; Libër për llojet e shkrimeve arabe; Libër me sqarime për sheriatin – ligjin islam; Gramatikë e gjuhës arabe, pjesa e parë dhe shpjegime të haditheve të Muhamedit; Abetare e arabishtes për nxënës të gjuhës arabe, përfundon me numrin rendor 12. Prishtinë më 11 mars 1986. Koleksioni është i rregulluar.

Një ndër institucionet që ruan këtë thesar është edhe Arkivi i Kosovës, Biblioteka Kombëtare Universitare e Kosovës dhe Arkivi si dhe Biblioteka e Bashkësisë Islame të Kosovës, të cilat kanë një koleksion të dorëshkrimeve islame-orientale në veprave të plota të pabotuara më parë.

KLASIFIKIMI I TYRE NË ASPEKTIN TEMATIK

Ashtu si dorëshkrimet, edhe dokumentet arabe, të cilat gjenden në bibliotekat dhe arkivat tona, i përkasin tematikave të ndryshme. Duke filluar nga libri i shenjtë Kurani, një kopje prej të cilit e mbante Mustafa i biri i Sasuh, viti i kopjimit 711h – 1311m; “Tefsir mealimu et tenzil min sure Merjem ila Nas”, që është komentim i pjesëve të Kuranit nga kaptina Merjem, e deri tek ajo e fundit Nas. Po ashtu filozofi dhe tesavuf, gjuhësi dhe letërsi, shkencë shoqërore, shkencë nga mjekësia, e shumë të tjera, të cilat i gjejmë edhe në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës.⁶

SHPJEGIMI I PËRMBAJTJES SË TYRE

Trashëgimia kulturore islame – orientale në trojet shqiptare ka një zanafillë të vjetër, atë e gjejmë në sirtarët e arkivave dhe bibliotekave tona. Në to ka dorëshkrime të rralla e të vjetra, dhe si të tilla janë një pasuri intelektuale të çmueshme, që shënojnë kohën, vendin, ekzistencën e tyre në periudha të hershme.

Një ndër institucionet që ruan këtë thesar është edhe Arkivi i Kosovës, Biblioteka Kombëtare Universitare e Kosovës dhe Arkivi si dhe Biblioteka e Bashkësisë Islame të Kosovës, të cilat kanë një koleksion të dorëshkrimeve islame-orientale në formën e veprave të plota të pabotuara më parë. Tanimë disa nga to janë të botuara në botën arabe, disa nga to i gjejmë edhe të përkthyer në

Në kohërat e përparme ishte e pamundur që në shtëpitë e shqiptarëve myslimanë të mos kishte më shumë se një kësi lloji “qitapi” – libra e dorëshkrime islame, të vendosura dhe të ruajtura me kujdes në raftet e shtëpive shqiptare, përveç atyre që gjendeshin nëpër xhami, teqe e medrese, etj..

gjuhën shqipe. Ato janë në gjuhën arabe, turke, perse dhe shqipe, kryesisht me grafi arabe. Numri i përgjithshëm i dorëshkrimeve islame-orientale që ruhen në Arkivin e Kosovës arrin në 69 kodekse ose 100 vepra në dorëshkrim. Në arkivin e Shqipërisë gjithashtu gjendet numër i konsiderueshëm i dorëshkrimeve, të cilat shumica nga to edhe janë të digjitalizuara. Fat i mirë i këtyre dokumenteve dhe dorëshkrimeve, është digjitalizimi i tyre.

Këto dorëshkrime janë përshkruar dhe kopjuar jo vetëm nga autorë të njohur arabë, turq, persianë, por edhe nga autorë vendas, shqiptarë. Është me rëndësi se këto dorëshkrime janë ruajtur me një fanatizëm dhe vetëdije të lartë, të trashëguara brez pas brezi dhe padyshim se përbëjnë një nga kontributet e mëdha të popullit shqiptar. Ato njashtu kanë vlerë dhe rëndësi të madhe për vetë shqiptarët.

Vlen të theksohet se në Arkivin e Kosovës mund të gjenden dokumente që datojnë nga shekulli XIII. Ndërsa dorëshkrimi më i vjetër është fjalori persisht-arabisht: “Tuhfe-i Sibjân”, i botuar në vitin 1437.⁷ Në Kosovë sot ruhen ende një numër i rëndësishëm i dokumenteve dhe i koleksioneve të dorëshkrimeve orientale, shumë të ndryshme për nga përmbajtja, prejardhja dhe vlera shkencore – artistike, të cilat përbëjnë një pjesë të trashëgimisë historike të kombit shqiptar.⁸ E tërë kjo për faktin se gati gjashtë shekuj, Kosova ishte pjesë përbërëse e Perandorisë Osmane, apo thënë nën administrimin osman. Kosova, në këtë trashëgimi të këtyre dokumenteve dhe dorëshkrimeve që nga shekulli XV e deri në shek. XX, si nga sasia, ashtu edhe nga përmbajtja, mund të jetë një nga vendet më të pasura në rajon.

Po ashtu vlen të theksohet se një numër i dokumenteve të vjetra ruhen në biblioteka private, në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, në Institutin e Mbrojtjes së Monumenteve të Kulturës në Prizren, në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, në xhamitë dhe teqetë tona. Po ashtu, dokumente dhe dorëshkrime arabe orientale, gjejmë edhe te familjet e imamëve e hoxhallarëve.

Dokumentet dhe dorëshkrimet e mbetura, si numër, përfaqësojnë një pjesë fare të vogël të asaj pasurie intelektuale që ka ekzistuar ose që ka qarkulluar gjithandej në vendin tonë, një pjesë shkrime-vepra origjinale të autorëve të huaj, po ashtu dhe shqiptarë.

Dorëshkrimeve dhe autografe apo atyre të kopjuara nga origjinali, u është kushtuar kujdes i veçantë. Kjo shihet nga shënimet, vulat dhe firmat që në faqet e këtyre dorëshkrimeve i kanë vënë pronarët e tyre.⁹



Në dorëshkrimin unik “Sherh rahati el kulub” shpjegim i veprës “Qetësim i zemrave”, që ruhet në Arkivin e Kosovës, të Pir Muhamed efendiut nga Prishtina, shkruan se ky dorëshkrim ishte marrë me vete gjatë shpërnguljes së popullatës shqiptare të Prishtinës më 1680 për në Serez (Greqi), dhe atje ky dorëshkrim kishte mbetur për afro një shekull, derisa disa tregtarë të Prishtinës, dashamirës të kulturës e kishin blerë këtë vepër të çmueshme dorëshkrim dhe e kishin kthyer në bibliotekën e Medresesë së Prishtinës.

Në kohërat e përparme ishte e pamundur që në shtëpitë e shqiptarëve myslimanë të mos kishte më shumë se një kësi lloji “qitapi” – libra e dorëshkrime islame, të vendosura dhe të ruajtura me kujdes në raftet e shtëpive shqiptare, përveç atyre që gjendeshin nëpër xhami, teqe e medrese, etj.. Edhe sot, në shtëpitë shqiptare myslimane, falë kujdesit të individëve me kulturë dhe vetëdije historike mbi vlerat fetare islame dhe tradicionale, mund të gjenden dokumente dhe dorëshkrime islame.

Dorëshkrimi i Kuranit fisnik, pronë e së cilit ishte Sinan Pasha e më pastaj Elmas Spahijaj, dhe në fund kalon pronë e h. Rrahmanit nga Malisheva e Gjilanit. Kurani dorëshkrim, i përket vitit 1200 sipas kalendarit hënor, ndërsa 1768 sipas kalendarit diellor.


Ndonëse ish-sistemi komunist dhe lufta e fundit në Kosovë, ashtu siç është tentuar të zhdukë çdo kulturë tonë, është mundur ta zhdukë edhe këtë pasuri kulturore të kombit tonë.

Kronologjia e dorëshkrimeve arabe në Arkivin e Kosovës fillon me fjalorin arabisht-persisht “Tuhfe-i Sibjân”, i kopjuar në vitin 143/7¹⁰, kurse më i riu është dorëshkrimi unikat-autograf në gjuhën arabe i ish-myftiut të Prizrenit, Rrustem ef. Shporta, me titull “Risale fi bejani Esmail-lahi te’ala ve esmai nebijjina alejhis-selam ve esmai xhemi’i-lenbijjai-lmedhkureti fi-l-Kur’ani-l’adhim”, i shkruar më 1925. Këtu mund të themi se kemi më të vjetrin dhe më të riun. Numri i përgjithshëm i dorëshkrimeve arabe që ruhen në Arkivin e Kosovës arrin në 69 kodekse ose në 100 vepra dorëshkrim.

Të gjitha këto dorëshkrime që ruhen edhe sot në arkiva apo edhe në biblioteka tona, janë dëshmi për trashëgiminë kulturore që nga periudha të hershme, të cilat mund të shërbejnë edhe si një bazë e mirë për të ndriçuar probleme të ndryshme të kohës.

PËRFUNDIMI

Dokumentet dhe dorëshkrimet arabe janë të një rëndësie të veçantë për vendin tonë, ngase ato kanë të bëjnë me historinë dhe kulturën tonë të hershme, pasi që disa prej këtyre shkrimeve janë të shkruara me shkronja arabe apo osmane, ndërsa fjalët janë shqipe. Numri i dokumenteve dhe dorëshkrimeve arabe është shumë i madh dhe se përpunimi i tyre me angazhime individuale është i pamundur prandaj,



duhet që të angazhohen institucionet gjegjëse dhe të merren me përpunimin e tyre. E duke u mbështetur në atë që kemi gjetur atëherë dhe duke e kuptuar rolin dhe rëndësinë e këtyre dokumenteve dhe dorëshkrimeve duam që për institucionet tona dhe për gjeneratat e ardhshme të studentëve të parashtrijmë edhe disa sugjerime: Grumbullimin e dokumenteve dhe dorëshkrimeve arabe, dhe jo vetëm, që janë në duart e individëve të ndryshëm. Institucionet tona duhet që të gjejnë forma dhe mekanizma të ndryshëm që të nxisin popullatën për dorëzimin e këtyre dokumenteve dhe dorëshkrimeve që ata posedojnë. E kjo për arsye se mund të ketë dokumente apo dorëshkrime që janë shumë të rëndësishme, qoftë në aspekt individual apo institucional.

- 1 Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave.
- 2 Iljaz Rexha, Vendbanime dhe popullsia Albane e Kosovës, sipas defterëve osmane. CD.
- 3 Shembulli i zbërthimit të viteve nga hixhri në miladi: 1253x0.97 +622=1837.
- 4 Arkivi i Kosovës, Udhërrëfyes, 2004, 41.
- 5 ASHAK, Fondet Personale e familjare, nr. Inentar. 137. IV.Rafti.3/c. Sasia 2 Kuti.
- 6 Huluntim në Bibliotekën Kombëtare Universitare të Kosovës, më 27.03.2018, Prishtinë.
- 7 Huluntim në Bibliotekën Kombëtare Universitare të Kosovës, më 27.03.2018, Prishtinë.
- 8 Po aty.
- 9 Po aty.
- 10 Po aty.

Vështrim historik mbi ekonominë osmane në trevat shqiptare gjatë shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX

MA. Agon Krasniqi

Ekonominë në trevat shqiptare gjatë viteve 1800-1840, e kishte prioritet ekonominë agrare. Kjo nënkuptonte që në trevat shqiptare të dominonte ekonomia bujqësore. Përpos bujqësisë, kemi edhe blegtorinë,¹ kryesisht në qytetet si Ulqini, Zadrima, Bregu i Matit, Rugovë, Junikë, Podgor, etj.. Në qytete si: Manastiri, Shkupi, Janina, Prizreni, Shkodra, Gjirokastra, Peja, Prishtina, Elbasani, Berati, Tirana, Tetova, Korça, Kruja, Dibra, Selaniku, Preveza, ekzistonte edhe ekonomia zejtare. Përpos këtyre kemi edhe tregtinë, si dhe esnafe që kishin kaluar në aspektin manufakturor.² Mbi situatën ekonomike në vilajetet shqiptare pasqyrë jep edhe Mulleri (raporti i tij), ku tregon për kulturën bujqësore, megjithatë raporti i tij vihet në dyshim nga Ami Boue.³ Në anën tjetër u zbatua edhe sistemi i çifligjeve, sistem ky që kishte të bëjë me posedimin e pronësisë së tokës. Përmes saj u krijuan edhe çifligjet si familje dhe çifligarët si udhëheqës të pronave. Në kuadër të kësaj reforme agrare, statistikat e vitit 1910, tregojnë se toka e punuar në Vilajetin e Kosovës, gjatë vitit 1910 ka qenë: 10.61%, në Manastir 7.30% dhe në Selanik 6.21%. Këto të dhëna mund të konsiderohen si pjesërisht të sakta, megjithatë toka më e punueshme shihet se ka qenë në Kosovë.⁴

Ekonominë ishte e përqendruar kryesisht në qytete, për këtë arsye masën dermuese të popullsisë qytetare e përbënin zejtarët dhe

Në qytetet si Shkodra, Prizreni, Elbasani dhe Peja kemi prodhimin e stolive nga ari dhe argjendi. Në vitet e 30-të të shek. XIX, kemi edhe rolin e organizatave esnafore të zejtarëve.

tregtarët. Në mesin e zejtarëve në Shqipëri, që e kishin të përqendruar punishten e tyre në qytete, prodhimi i tyre ishte i fokusuar në përpunimin e metaleve, artikujve të veshmbathjeve, prodhimin e artikujve ushqimorë, prodhimin e lëndëve të drurit. Në qytetet si Shkodra, Prizreni, Elbasani dhe Peja kemi prodhimin e stolive nga ari dhe argjendi. Në vitet e 30-të të shek. XIX, kemi edhe rolin e organizatave esnafore të zejtarëve. Këto organizata ruajtën monopolin e prodhimit të vet, megjithatë në vitin 1841, me ndërhyrjen e shtetit osman, u larguan disa nga monopolet esnafore, për prodhime të caktuara. Përpos tradicionales kemi edhe hapjen e firmave, të njohura si firmat shkodrane, që u hapën në Shqipërinë Veriore, Qendrore dhe në Kosovë. Nga këto firma, kemi edhe hapjen e agjencive tregtare në qytetet si Durrës, Tiranë, Prizren, Pejë, Ulqin, Tivar, Shkup, etj.. Gjatë viteve 40-të dhe 50-të, të shek. XIX, mori hov edhe ekonomia monetare, çka ndikoi në shturjen e esnafeve.⁵ Ekonomia monetare ndikoi në zhvillimin e zejtarisë dhe tregtisë së jashtme. Nga viti 1842 gjer në vitin 1888, numri i punishteve zejtare dhe tregtare u rrit në këto përmasa: Në Shkodër nga 2600 sa ishte në vitin 1842, shkoi në 3500, në Prizren nga 950 në 1560, në Korçë nga 480 në 840, në Berat nga 680 në 820, në Elbasan nga 580 në 730, Tiranë nga 610 në 720, në Tetovë nga 450 në 610, në Prishtinë nga 380 në 530, etj.. Po ashtu u ngrit edhe numri i dyqaneve. Përpos saj, u



ngrit edhe tregtia me vendet e huaja, ku ndërmjet viteve 1842-1892, kemi një lëvizje tregtare të produkteve katër herë më të lartë. Kjo ndikoi që të kemi frekuentim të shpeshtë të anijeve nga Austro-Hungaria dhe Italia, anijet Pulia dhe Adria. Këto anije frekuentonin portet e Shëngjinit, Durrësit, Vlorës, Sarandës, Prevezës. Eksporti i produkteve nga trevat shqiptare në vendet evropiane ka qenë në rritje me fillimin e ekonomisë monetare. Shembulli shihet edhe në eksportin e produkteve bujqësore, ku nga 6 milion franga ari eksport në vitin 1850, kemi ngritje dyfish, pra me një eksport prej 12 milion franga ari në vitin 1898.⁶

Rol të rëndësishëm kishin edhe tregjet në qytetet e vilajeteve. Forma e tregjeve ishte e ngjashme me pazaret. Ato quheshin bezistane.⁷ Në Prizren kishim 4 bezistane që

përbënin tregun e qytetit: Şadırvan, Arasta, Tabahana ve Bajdarhana.⁸ Këto bezistane kishin një numër të madh dyqanesh, ku bëhej tregti e vazhdueshme, çka shënonte një gjallëri ekonomike në vilajetin e Prizrenit. Vetëm në vitin 1866, në këto katër bezistane të Prizrenit kishte 1091 dyqane.⁹ Në anën tjetër në sanxhakun e Prishtinës kishte 3690 godina, ku në to gjendeshin 500 dyqane.¹⁰

Tregtia e brendshme dhe e jashtme ishte nga faktorët primar të lidhjeve ekonomike ndërmjet vendeve. Në aspektin e tregtisë së brendshme, tregtia bëhej brenda vilajeteve, kryesisht ishte e ndërlidhur me tradicionalen e tregtisë osmane, përmes bezistaneve, një model klasik i zhvillimit të tregtisë, përmes modelit të dyqaneve dhe shitjes ditore. Ky model ishte një tregti ndërmjet tregtarit dhe konsumatorit. Në anën tjetër, tregtia e jashtme, kishte për qëllim eksportin dhe importin përmes marrëveshjeve që realizoheshin nga vilajetet dhe vendet e tjera. Kjo dallohet edhe me ngritjen e linjës teliferike mes Janinës dhe Prevezës, për një rrjet komunikues ekonomik. Transporti që bëhej më së shpeshti në vilajetin e Janinës përmblote produktet si: grurë, elb, tërshëra, lesh, peshk, djathë, duhan, gjalpi, sapun, lëkura delesh, vaj ulliri.¹¹ Statistikat e mëposhtme tregojnë për eksportin dhe importin në Artë, Janinë, Prevezë.

Marrëdhëniet tregtare i shohim në masë të madhe mes trevave shqiptare. Shembulli është mes Prizrenit dhe Shkodrës. Gjer në vitin 1870, kishte një bashkëpunim të madh tregtar mes këtyre dy vilajeteve.¹²

Importi dhe eksporti gjatë kësaj periudhe ndërmjet vilajeteve shqiptare bëhej me osmanët, austro-hungarezët, italianët, francezet, rumunët, etj.¹³ Statistikat e mëposhtme tregojnë për importin e Prizrenit gjatë vitit 1864, bazuar në raportin anglez.

Rol të rëndësishëm ka edhe aspekti bankar. Banka osmane që ishte hapur në vitin 1856 në Stamboll, vazhdoi t'i hapte degët e saj në vilajete. Kështu u hapën degët e bankës osmane në katër vilajetet shqiptare. Vlen të theksohet se në bankat osmane kishte filluar edhe përdorimi i parasë letër, e quajtur Kaime-i Nakdiye – i Mutebere, qysh nga viti 1840. Kjo para u përdor edhe në trevat shqiptare dhe gjitha vendet ku sunduan osmanët. Pas degës së bankës qendrore, u hapën edhe degë të bankës Ziraat, bankë bujqësore osmane, ku kryheshin veprime krediti.¹⁶ Shembull banka Ziraat në Prishtinë kishte kapital prej 2.000.000 kurush. Të ardhurat vjetore ishin 96.087 kurush, ndërsa shpenzimet vjetore 31.893 kurush, në anën tjetër në arkën e jetimëve ishin 132.480 kurush.¹⁷ Rol të rëndësishëm në aspektin e ekonomisë

Viti	Importi	Eksporti
1862	38.000	14.000
1863	64.000	16.000

Tabela nr.1: Transporti në Artë

Anije	Vlera e ngarkesave
173	8.559

Tabela nr.2: Tregtia e Prevezës me Janinën (1863-64).

kishte edhe hapja e hekurudhës Selanik-Shkup-Mitrovicë, që lehtësoi rrjetin tregtar.¹⁸ Nga hapja e hekurudhës shohim se u lehtësua edhe rrjeti i bartjes si mineraleve të nxjerra nga minierat. Në periudhën e Abdylhamitit II, më së shumti minerale të nxjerra kishte në Selanik. Në Kosovë u nxorën 2 argjenda, 1 bakër, 1 antimuan dhe 1 zink. Në Prishtinë u nxor edhe krom nga ortakëria e Matalon efendiut dhe Shukri beut.¹⁹

Në procesin e ekonomisë monetare, kemi edhe fillimin e epokës industriale. Kjo u shënuar me hapjen e fabrikave. Nga ndërmarrjet më të rëndësishme industriale në Shkodër ishin fabrika e sapunit, cigareve, makaronave, tullave, mullinjve, shtypshkronja, fabrika e uthullës, verës, etj.. Në vitin 1870 në Korçë u hap furra moderne për prodhimin e gëlqeres, fabrika e miellit. Në Prishtinë u hapën dy fabrika të miellit, në vise të tjera të vilajetit të Kosovës u hapën fabrika sapuni, birrës, miellit, tullave, tjegullave, gajtanit, pëlhurave, etj.. Gjatë kësaj kohe shohim edhe ndikimin e investimeve të huaja. Në vitin 1875, Shoqëria Angleze “Mejers”, mori për shfrytëzim minierat e Selenikës, ku kjo u trashëguar në vitin 1891 nga shoqëria frënge “Societe des bitumes de Selenitza”.²⁰ Në vitin 1904 shoqëria italiane “Vismara” mori në shfrytëzim pyjet e Mirditës. Po ashtu ndikimi u pa edhe me hapjen e fabrikave, në përgjithësi në katër vilajetet shqiptare.²¹ Austro-Hungaria dhe Italia në fundin e shekullit XIX, e kontrolluan tregun e Shqipërisë. Në bazë të të dhënave ekonomike të viteve 1901 – 1904 – 1905, Austro-Hungaria kishte në kontroll $\frac{3}{4}$ e import-eksportit që bëhej nga Shkodra. Pas saj, vendin e dytë e zinte Italia, pastaj Mali i Zi, Franca. Po ashtu kontrollin e vendosën edhe firmat austro-hungareze, ku kontrollonin $\frac{2}{3}$ e import – eksportit që bëhej nga porti i Durrësit. Pas saj ishte edhe Anglia, Italia, Egjipti, Rusia dhe Franca. Përpos konkurrencës tregtare përmes tregtisë së lundrimit, kemi

Armë	50000 funta
Hekur	28000 funta
Mëndafsh	833 funta
Lëkurë kordoven	13500 funta
Lëkur deleje	5000 funta
Lëkurë lepuri	6600 funta
Dyll	100 funta
Lesh	15268 funta
Mallra të tjera	8200 funta
Total: 127.501 funta	

Tabela nr.3: Importi i Prizrenit në vitin 1864.¹⁴

edhe konkurrencën bankare mes fuqive të mëdha në aspektin ekonomik. Në vilajetin e Shkodrës u hapën shtëpi bankare të Triestës, ndërsa bankat evropiane të Francës, Gjermanisë, Anglisë, Italisë jepnin kredi përmes agentëve të tyre. Në vitin

Mallrat koloniale	6900 funta
Ari dhe fije varaku	3300 funta
Hekur dhe Qelik	1100 funta
Pambuk	23090 funta
Mëndafsh	150
Lesh	4350
Kripë	7055
Artikuj të lëkurës	100
Mallra të ndryshme	270
Total: 46.315 funta	

Tabela nr.4: Eksporti i Prizrenit (1864).¹⁵

1906 u hapën degët bankare italiane të shoqërisë tregtare të lindjes (Societa Comerciale d’ Oriente).²² Kështu ndikimi ekonomik i fuqive të mëdha ishte shumë i lartë. Kjo shihet edhe te bashkëpunimi ndërmjet shqiptarëve me ShBA-të, ku kishte bashkëpunim të industrisë së tekstilit në dhjetë vitet e para të shekullit XX.²³

Në vitin 1912, në aspektin industrial, kishim këto fabrika me motor: Fabrikë mullinj drithi 26, fabrika vaji 4, fabrika sapuni 2, fabrika lëkurësh 2, fabrika tisazhi 2, fabrika cigaresh 2, fabrikë makaronash 1, shtypshkronja 5, sharra mekanike 7. Në total 50 fabrika me motor.²⁴ Viteve të mëparshme numri i fabrikave ishte më i lartë, megjithatë gjatë vitit 1912, si rezultat i luftërave të vazhdueshme filloi mbyllja e fabrikave.

Si rezultat që trevat shqiptare ishin pjesë e osmanëve, në vendimet e Konferencës së Lozanës, u vendos që edhe Shqipëria të paguante një pjesë të borxhit osman. Kështu faktori ndërkombëtar ndërhyri në çështjen e borxhit osman, pas shkatërrimit të këtij shteti (1923). Shqipëria u detyrua të paguante 1.633.233 kurush borxh osman apo 1.3 % nga shuma totale.²⁵

- 1 Aliriza Selmani, “Ekonomia dhe shoqëria në rrethin e Gjilanit në gjysmën e dytë të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX”. Revista Kosova, nr. 35/36, (Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2011/2012), 143.
- 2 Aleks Buda., et. al. Historia e Popullit Shqiptar II, Rilindja Kombëtare vitet 30 të shek. XIX – 1912. (Tiranë: Toena, 2002, 38.
- 3 Bedrush Shehu, “Një raport i Mullerit për Kosovën në vitin 1838”. Revista Kosova – Kosovo, nr.5, (Prishtinë: Enti i Historisë së Kosovës, 1976), 57.
- 4 Milovan Obradović, Reforma agrare dhe kolonizimi në Kosovë (1918-1941), (Prishtinë: Instituti i Historisë, 2005), 30.
- 5 Buda., et. al, Historia e Popullit Shqiptar II, 44-46.



- 6 Buda., et. al, Historia e Popullit Shqiptar II, 48-50.
- 7 Bezistan (Bedesten – bezzâzistan): ishte vendi ku zhvillohej tregu, një objekt ku hapën dyqanet, i mbyllur, me tregje dy krahërore. Shih: Semavi Eyice, “Bedesten”, Diyanet Islam Ansiklopedisi, cilt 5, (Istanbul: Diyanet Yayin Vakiflari, 1992), 302.
- 8 Fetnan Derviş, XVIII – XIX Yüzyillarda Prizren: Siyasi ve Sosyo – Ekonomik Tarihi. (Istanbul: Istanbul Universitesi, 2007), 80; Enver Dukagjini, “Vetitë politiko-administrative të Prizrenit”, Revista Kosovo - Kosova, nr. 3, (Prishtinë: Enti i Historisë së Kosovës, 1974), 19.
- 9 Derviş, XVIII – XIX Yüzyillarda Prizren, 81.
- 10 Skender Rizaj, “Ekonomia dhe Shoqëria e Kosovës në gjysmën e dytë të shekullit XIX sipas burimeve osmane, angleze dhe shqiptare”. Revista Kosova – Kosovo, nr.5, (Prishtinë: Enti i Historisë së Kosovës, 1976), 14.
- 11 Ilber Ortayli, Studime Osmane, (Tiranë: Fan Noli, 2021), 141.
- 12 Derviş, XVIII – XIX Yüzyillarda Prizren, 83.
- 13 Derviş, XVIII – XIX Yüzyillarda Prizren, 103.
- 14 Rizaj, “Ekonomia dhe Shoqëria e Kosovës”, 21.
- 15 Rizaj, “Ekonomia dhe Shoqëria e Kosovës”, 22.
- 16 Buda., et. al, Historia e Popullit Shqiptar II, 50.
- 17 Rizaj, “Ekonomia dhe Shoqëria e Kosovës”, 15.
- 18 Ibrahim Yilmazçelik ve Sevim Erdem, Selanik-Mitroviçe - Zibefçe Demiryolu Hattı Boyunca İşletilen Madenler, (Ankara: Gece Kitaplığı, 2018), 369.
- 19 Yilmazçelik ve Erdem, Selanik-Mitroviçe – Zibefçe, 400.
- 20 Nina Smirnova, Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX, (Tiranë: Ideart, 2004), 34.
- 21 Buda., et. al, Historia e Popullit Shqiptar II, 52-53.
- 22 Buda., et. al, Historia e Popullit Shqiptar II, 299-300.
- 23 Ali Aslan, Osmanli Arnavutlarinin ABD'de Sosyal, Siyasi ve Ekonomik faaliyetleri (1870-1912). Siyasal Bilgiler Fakultesi Dergisi, VI/1, 2021, 57.
- 24 Buda., et. al, Historia e Popullit Shqiptar II, 55; Hasan Banja, Ekonomia e Shqipërisë në rrjedhat e historisë të shekullit XX, (Tiranë: Emal, 2017), 57.
- 25 Përpos Shqipërisë, borxh paguanin edhe këto vende: Turqia 84.597.495 kurush, Italia 243200 kurush, Bullgaria 1.776.354 kurush, Greqia 11.054.534 kurush, Mbretëria Serbo – Kroate – Sllovene 5.435.597 kurush, Siria dhe Libani 11.108.858 kurush, Palestina 3.284.429 kurush, Jordania 733.610 kurush, Iraku 6.772.142 kurush, Salltanati Nexhid (Arabi) 129.150 kurush, Hixhazi 1.499.518 kurush, Provinca Asir 26.138 kurush, Jemeni 1.182.104 kurush, Maani 128.728 kurush. Në total 129.605.090 kurush. Nedim Dikmen, “Osmanli diğ borçlarinin ekonomik ve siyasi sonuçlari”, (Atatürk Üniversitesi İktisadi Ve İdari Bilimler Dergisi, cilt 19, sayı 2, 2005), 152.

Yjet e Evropianit, praktikues të Islamit

Kasim Gërbeshi

Në këtë kampionat u prezantua edhe Kombëtarja e Shqipërisë, e cila mori pjesë për herë të dytë, por megjithëse nuk korri suksese në fazën e grupeve duke u eliminuar shumë herët, si një arritje e suksesshme e Kuqezinjve.

Kampionati Evropian i Futbollit është një event i rëndësishëm sportiv, ku marrin pjesë shumë kombëtare evropiane, prezantohen lojtarë të stërvitur dhe të përgatitur maksimalisht.

“Euro 2024” ka përfshirë 24 shtete dhe ka marrë vëmendjen edhe jashtë kontinentit tonë, si një event i jashtëzakonshëm sportiv. Këto ditë pamë çaste të bukura në aspektin sportiv, edukativ si dhe festë, gëzime e fitore. Mirëpo si pasojë e humbjeve, ka sjellë dëshpërime, mërzi dhe lot. Në këtë kampionat u prezantua edhe Kombëtarja e Shqipërisë, e cila mori

pjesë për herë të dytë, por megjithëse nuk korri suksese në fazën e grupeve duke u eliminuar shumë herët, si një arritje e suksesshme e Kuqezinjve, sidomos kulturën e lartë sportive të tifozërisë mbarë shqiptare. “Euro 2024” përfundoi me një finale spektakulare ndërmjet Spanjës dhe Anglisë, dhe me një fitore të bukur për Kombëtaren e Spanjës me rezultat 2-1.

EVROPA MULTIETNIKE DHE MULTIRACORE

Kontinenti Evropian, është kontinent i ngjyrosur me plot ngjyra nga aspekti fetar, kombëtar e racor. Në një kampionat siç është





Kampionati Evropian, çdo lëvizje, veprim apo edhe angazhim të lojtarëve do të bëhej doemos viral, duke u bërë kryefjala e disa ditëve, apo edhe duke dedikuar lajme dhe minuta televiziv për veprimet e tyre. Lojtarë të shumtë, preferojnë që para çdo ndeshje të tyre, t'i praktikojnë disa nga ritualet fetare të fesë që ata i përkasin. Të gjithë kemi shikuar një ndeshje, ku lojtarë të ndryshëm, bëjnë kryqin, prekin vijën e bardhë të fushës duke e konsideruar atë si të shenjtë, apo edhe duke i ngritur duart që të bëjnë dua.

Mirëpo për ta luftuar dukurinë e urrejtjes fetare si dhe atë nacionale e racore, Shtëpia e Futbollit Evropian, ka kampanjanën “Thuaj jo Racizmit”, kampanjë kjo që lufton shkeljen e të drejtave të njeriut në kontinentin Evropian.

Lojtarët që i përkasin fesë islame, ishin shembulli më i mirë gjatë këtij kampionati, si në fushën e gjelbër, ashtu edhe jashtë saj, duke treguar mentalitet, moral dhe respekt të jashtëzakonshëm.

“Racizmi, diskriminimi dhe intoleranca nuk kanë vend në futboll”, është thënë nga presidenti i UEFA-s, Aleksander Čeferin.¹

Shtëpia e futbollit evropian, UEFA, ndër vite ka moton “Jemi një”, e cila aludon barazi racore, nacionale dhe religjioze dhe pjesëmarrje pa dallime, duke u angazhuar në luftën kundër racizmit, konfliktet nacionaliste, si dhe ato religjioze. Andaj kanë lansuar edhe kampanjën “FootbALL”² (Futbolli për të gjithë), duke luftuar këto dukuri ndarëse në shoqëri. Pjesë e kësaj kampanje janë edhe lojtarët të cilët përfaqësojnë komunitetin mysliman në futbollin evropian.

KUSH ISHIN YJET E EVROPIANIT PRAKTIKUES TË ISLAMIT?

Lojtarët që i përkasin fesë islame, ishin shembulli më i mirë gjatë këtij kampionati, si në fushën e gjelbër, ashtu edhe jashtë saj, duke treguar mentalitet, moral dhe respekt të jashtëzakonshëm.

Yje të kombëtarëve të ndryshme janë praktikues të fesë islame, këtë gjë mund ta vërtetojmë ndërmjet sjelljeve, prezantimit të tyre në konferenca, si dhe nga jeta e tyre jashtë futbollit. Në Kampionatin Evropian, “Euro 2024”, vëmendjen më të madhe e kanë pasur disa yje, të cilët shkëlqyen në fushën e gjelbër, ndërsa ndërkohë është kuptuar edhe se i përkasin fesë islame, por pa i penguar e diskriminuar duke qenë shembull me respektin, etikën dhe moralin e tyre në fushë, si dhe jashtë saj. Te tillë ka pothuajse në çdo ekip të kombëtarëve si:



Ousmane Dembele, (Francë) Arda Guler (Turqi), Nedim Bajrami (Shqipëri), Xherdan Shaqiri (Zvicër) Ilkay Gundogan (Gjermani) etj..

Në këtë shkrim do të cekim disa kuriozitete, biografi, si dhe histori të bukura të dy lojtarëve specifik, të cilët ishin ndër lojtarët më të mirë në “Euro2024”.

ANTONIO RÜDIGER - GJERMANI

Antonio Rüdiger, është një lojtar profesionist gjerman, i cili luan në repartin e mbrojtjes. Futbollisti me prejardhje nga shteti Afrikan, Sierra Leone, shtet ky që vijnë prindërit e tij, është lindur dhe rritur në Berlin të shtetit të Gjermanisë. Karrierën e tij si futbollist e filloi në klubin VfB Stuttgart II në vitin 2011. Suksesin më të madh të karrierës së tij e shënoi në vitin 2022, ku u transferua nga skuadra angleze, Chelsea, drejt skuadrës spanjolle, Real Madrid.³

Rüdiger, duke shfrytëzuar autoritetin e tij si një ndër mbrojtësit më të mirë në botë gjatë viteve të fundit,⁴ i është përkushtuar edhe kampanjës së UEFA-s, në luftimin ndaj racizmit si dhe intolerancës fetare dhe kombëtare, duke u bërë edhe ambasador i kësaj kampanje. Kjo gjë erdhi pasi që lojtari gjermano-afrikan, ndër vite ishte akuzuar edhe për pjesëmarrje në organizime të ndryshme terroriste. Mirëpo pas publikimit të vërtetës, kjo gjë u mohua, duke lënë të kuptohet që është një qytetar i rëndomtë në shtetin e Gjermanisë, i cili është i përkushtuar në ritualet fetare të Islamit.

Pas publikimit të së vërtetës, avokatët e lojtarit, së bashku me Federatën e Futbollit Gjerman, vendosën që t'i padisin mediumin “AP” (Associated Press), gjithashtu edhe gazetarin e tyre për shpifje si dhe tentim të prishjes së imazhit të tij. Këtë gjë e ka bërë të ditur vetë lojtari gjermano-afrikan në një intervistë për mediumit gjigant DW.⁵



LAMINE YAMAL - SPANJË

Njëri ndër yjet e “Euro2024”, i cili edhe arriti ta fitojë këtë kampionat, pikërisht ishte edhe adoleshenti i njohur Lamine Yamal (Nasraoui Ebana). Ylli i ri spanjoll vije nga academia e futbollit Katalunas të Barcelonës, ndonëse ende i ri në moshë, ka arritur të jetë në ndër yjet e futbollit botëror, duke shënuar gol dhe duke debutuar në ndeshje të ndryshme të mëdha. Ai ishte gjithashtu asistuesi i njëjës prej golave të bukur në finale, ndaj Anglisë, në të cilën, kombëtarja spanjolle u shpall zyrtarisht kampione e Evropës. Yamal theu edhe rekorde, duke u bërë lojtari më i ri i cili ka luajtur ndonjëherë në ndonjë Kampionat Evropian.⁶

Yamal vjen nga në familje refugjate në shtetin

Njëri ndër yjet e “Euro2024”, i cili edhe arriti ta fitojë këtë kampionat, pikërisht ishte edhe adoleshenti i njohur Lamine Yamal (Nasraoui Ebana). Ylli i ri spanjoll vije nga academia e futbollit Katalunas të Barcelonës, ndonëse ende i ri në moshë, ka arritur të jetë në ndër yjet e futbollit botëror, duke shënuar gol dhe duke debutuar në ndeshje të ndryshme të mëdha.

Lamine Yamal është shumë i ri, mirëpo talenti i tij i madh, ka bërë që shumë media botërore të “shpërthejnë” me lajme për të. Ndërsa bashkëlojtarët e tij te klubi i Barcelonës, si dhe te Kombëtarja Spanjolle, kanë vënë në pah edukatën e tij të madhe.



e Spanjës, prindërit e adoleshentit vijnë nga Maroku dhe Bata, Guineja Ekuatoriale. Lojtari spanjoll-maroken, është njëri ndër lojtarët që praktikon fenë islame dhe kjo gjë është bërë e famshme në mediumet të ndryshme evropiane, pasi që duke pasur parasysh moshën e tij të re, lojtari në fjalë, asnjëherë nuk ka publikuar identitetin e tij fetar. Mirëpo ai as një moment nuk është i vetëm dhe gjithmonë është i shoqëruar me ndonjë zyrtarë të klubit, andaj është kuptuar se 17-vjeçari është praktikuesi i Islamit.

Duke pasur parasysh porosinë fetare islame, për t'u kujdesur dhe respektuar prindërit, familjen si dhe të afërmit, Yamal, ka arritur që në moshë shumë të re, të përkujdeset për prindërit e tij, duke i pensionuar ata para kohe dhe duke ua siguruar atyre të ardhura vetëm nga aktivizimi i tij si futbollist profesionist. Përveç kësaj, ylli spanjoll, është shumë i afërt me gjyshërit e tij, ku edhe nuk është kursyer aspak duke i blerë atyre në shtëpi luksoze, në zemër të Spanjës, në Barcelonë.⁷

Për shkak të moshës së tij, ai nuk është njëri ndër lojtarët startues, mirëpo që nga viti 2023, Yamal kishte arritur të jetë pjesë e shumë ndeshje me klubin e tij. Ndërsa në Kampionatin Evropian, selektori spanjoll, ishte shprehur se ka besim të plotë tek ylli i skuadrës së tij, duke i dhënë hapësirë të shkëlqejë në arenën e futbollit evropian, ku edhe arriti të shënoi gola vendimtare dhe duke i ndihmuar Kombëtares së tij që të shpallen kampion të këtij event. Yamal para çdo ndeshje, ngritë duart lartë dhe kërkon ndihmën e Krijuesit, kjo gjë është vërejtur edhe në ndeshjen e fundit, ku lojtari në fjalë, ishte fokusuar nga fotoreporter dhe kameraman të shumtë dhe pamja ishte pikërisht kur djaloshi i ri bënë dua para fillimit të ndeshjes së madhe. Lamine Yamal është shumë i ri, mirëpo talenti i tij i madh, ka bërë që shumë media botërore të “shpërthejnë” me lajme për të. Ndërsa bashkëlojtarët e tij te klubi i Barcelonës, si dhe te Kombëtarja Spanjolle, kanë vënë në pah edukatën e tij të madhe. Mesfushori Pedri, i cili është bashkëlojtarë i yllit spanjoll te Barcelona dhe te Kombëtarja e Spanjës, në konferencë për media ka thënë se është spektakulare të luash futboll, veçanërisht kur në skuadër ke Yamalin, i cili është në djalosh i mirë si në fushë, ashtu edhe jashtë saj.⁸

- 1 <https://www.uefa.com/news-media/news/0232-0f8e332fbdfd-0fa4c62d12ec-1000--no-toracism-say-uefa-champions-league-uefa-europa-league/>
- 2 <https://www.uefa.com/news-media/news/0282-18347853d50c-a7dc7e9a6e33-1000--uefa-launches-football-programme-to-highlight-importance-of/>
- 3 <https://www.transfermarkt.com/antonio-rudiger/profil/spieler/86202>
- 4 <https://www.radiotimes.com/tv/sport/football/best-defenders-world/>
- 5 <https://www.dw.com/en/germany-star-r%C3-%BCdiger-slams-islamist-gesture-allegation/a-68675281>
- 6 <https://www.uefa.com/euro2024/ncës/028f-1b593529fcc2-02d376d78144-1000--lamine-yamal-s-record-breaking-euro-spain-star-poised-to/>
- 7 https://www.sport-es.translate.google.com/notice/opinion/lamine-yamal-sigue-rocafonda-104075420?_x_tr_sl=es&_x_tr_tl=en&_x_tr_hl=en&_x_tr_pto=sc
- 8 <https://www.barcablaugranes.com/2024/6/9/2-4174651/pedri-loving-playing-èith-nico-èilliams-and-lamine-yamal-for-spain>

**MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM MINISTRIN E KULTURËS DHE TURIZMIT TË TURQISË,
Z. MEHMET NURI ERSOY I SHOQËRUAR NGA KRYETARI I DIJANET-IT, DR. ALI EF. ERBASHI**

Më 25 korrik 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim ministrin e Kulturës dhe Turizmit të Turqisë, z. Mehmet Nuri Ersoy, i cili shoqërohej nga kryetari i DIJANET-it të Turqisë, dr. Ali Erbash dhe nga drejtori i Përgjithshëm i Vakëfeve të Turqisë, z. Sinan Aksu.

Myftiu Tërnavë fillimisht u uroi mirëseardhje mysafirëve në

institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës, e më pas, përmes tyre shprehu falënderimet e tij dhe të institucionit që ai drejton për përkrahjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm që kanë me Bashkësinë Islame të Kosovës, në realizimin e projekteve me rëndësi të trashëgimisë kulturore e fetare të Kosovës. Ai tha se DIJANET-i dhe Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfeve kanë kontribuar jashtëzakonisht

shumë në restaurimin e objekteve të trashëgimisë fetare në Kosovë.

Në anën tjetër, ministri Mehmet Nuri Ersoy, shprehu gatishmërinë e plotë për të thelluar bashkëpunimin në fusha të ndryshme kulturore e fetare me interes për dy popujt dhe për të krijuar ura të reja bashkëpunimi me Bashkësinë Islame të Kosovës dhe institucionet e tjera të Kosovës.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM POLITIKANIN NGA AUSTRIA, Z. MAG RALF DRACK

Më 4 korrik 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim këshilltarin dhe politikanin nga Austria, z. Mag Ralf Drack, i cili shoqërohej nga Nikol Berisha, ligjërues në fushat e kompetencave digjitale dhe mediatike në Universitetin e Klagenfurtit.

Temë boshte e këtij takimi ishte toleranca fetare, integrimet dhe vlerat evropiane.

Myftiu Tërnavë, me këtë rast, përmendi kontributin e Bashkësisë Islame të Kosovës në fushën e tolerancës dhe bashkëjetesës fetare në vend. Ai tha

se ndonëse ne jemi një vend i vogël, botës i japim shembullin më të mirë për tolerancë ndërfetare. Ai nuk la pa përmendur edhe aktivitetet e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe kontributin e këtij institucioni në fushën humanitare, përmes Shoqatës Humanitare "Bereqeti".



MYFTIU TËRNAVA VIZITOI KËSHILLIN E BI-SË SË KLINËS

Më 1 korrik 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, në vazhden e takimeve të rregullta me anëtarët dhe administratën e Këshillave, zhvilloi një takim në Këshillin e BI-së së Klinës. Gjatë këtij takimi, Myftiu Tërnavë, kërkoi nga administrata dhe nga anëtarët e Këshillit që të shtojnë angazhimin e tyre në shërbim të besimtarëve tanë, ngase këtë e kemi amanet nga i Madhi Zot. Ai ofroi përkrahjen e plotë të Kryesisë së BIK-ut



për projektet dhe iniciativat që janë në dobi të besimtarëve.

U VU GURTHEMELI I QENDRËS SË MJEKËSISË FAMILJARE NË GURAKOC



Më 1 korrik 2024, falë donacionit të siguruar nga Bashkësia Islame e Kosovës, në Gurakoc të Istogut, u vu gurthemeli i Qendrës së Mjekësisë Familjare.

Në këtë ceremoni qenë të pranishëm kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë, kryetari i Komunës së Istogut, z. Ilir Ferati, si dhe stafi mjekësorë i kësaj Qendre.

Myftiu Tërnavë, fillimisht falënderoi kryetarin Ferati për gatishmërinë dhe bashkëpunimin e treguar për gurthemelin e kësaj Qendre. Ai tha se Bashkësia Islame e Kosovës, do të vazhdojë edhe në të ardhmen ndërtimin e Qendrave të tjera. “Ne si Bashkësi Islame do të vazhdojmë edhe në të

ardhmen të ndërtojmë Qendra të tjera në gjithë vendin, në mënyrë që sadopak t’ju shërbejmë qytetarëve në përmirësimin e gjendjes shëndetësore të tyre.”

Ai falënderoi mjekët dhe infermierët anekënd Kosovës për punën madhore të shenjtë që bëjnë në raport me shëndetin e qytetarëve.

Ndërkaq, kryetari i Komunës së Istogut, z. Ilir Ferati, tha se në këtë Qendër të Mjekësisë Familjare, trajtohen mbi 3000 banorë të fshatrave përreth, dhe se ka qenë tejet e nevojshme që të ndërtohet një objekt i ri, i cili do t’i plotësojë kushtet dhe do ta përmirësojë infrastrukturën shëndetësore. Ai falënderoi Bashkësinë Islame të Kosovës për sigurimin e

donacionit, duke uruar kështu edhe banorët për këtë objekt të ri.

Doktoresha kryesore e kësaj Qendre, dr. Ganimete Ferati, tregoi për kushtet në të cilat kanë punuar në objektin e vjetër. Ajo tha se tashmë me këtë objekt të ri, ne do ta kemi edhe më të lehtë punën dhe shërbimin ndaj qytetarëve. “Ne këtu ofrojmë gjitha shërbimet e nevojshme, duke filluar prej kontrolleve të përgjithshme e deri tek ato më të specializuara. Vetë fjala objekt i ri, për ne është një motivim për punë edhe më të mëdha” – tha ndër të tjera dr. Ferati.

Bashkësia Islame e Kosovës këtë donacion e ka siguruar nga Bejt Zekat nga Kuvajti, më konkretisht nga bamirësi Al Haxhiri.

MYFTIU TËRNAVA VIZITOI KËSHILLIN E BI-SË SË ISTOGUT

Më 1 korrik 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, vizitoi Këshillin e Bashkësisë Islame të Istogut, në të cilin takoi administratën dhe anëtarët e këtij Këshilli.

Gjatë këtij takimi u bisedua për sfidat dhe angazhimet që ka Këshilli i BI-së së Istogut, për të cilat Myftiu Tërnavë, ofroi përkrahjen e vazhdueshme të Kryesisë. Ai tha se Bashkësia Islame e Kosovës mbete e përkushtuar për ngritje të cilësisë së punës, për çka tha se do të ofrojmë



përkrahjen e nevojshme sa herë që kërkohet një gjë e tillë.

MYFTIU TËRNAVA VIZITOI KËSHILLIN E BI-SË SË PEJËS

Më 1 korrik 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, vizitoi Këshillin e Bashkësisë Islame të Pejës, në të cilin u prit nga kryetari, Musli ef. Arifaj, administrata dhe anëtarët e këtij Këshilli.

Kryetari Arifaj e njohu për së afërmi Myftiun Tërnavë me gjendjen faktike të Këshillit, si dhe me punët dhe angazhimet e këtij Këshilli. Myftiu Tërnavë, ndërkaq, shfrytëzoi rastin që të flasë në pak fjalë për rolin, kontributin dhe angazhimin që duhet ta kenë



hoxhallarët në shoqëri. Ai tha se të Zotit dhe porosive të Pejgamberit a.s., amanetin që e kemi marrë mbi supet duhet ta çojmë në vend. tona, atë të kumtimit të drejtë të fjalëve

MYFTIU TËRNAVA VIZITOI KURSIN E KURANIT “MEHMET AKIF ERSOY” NË PEJË



Më 1 korrik 2024, gjatë vizitës së zhvilluar në qytetin e Pejës, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, vizitoi edhe kursin e Kuranit “Mehmet Akif Ersoy”.

Gjatë kësaj vizite Myftiu Tërnavë u njoh për së afërmi me kushtet që ofron kjo qendër për mësimin e Kuranit. Ai përgëzoi nxënësit që mësojnë Kuranin, duke kujtuar kështu mësimet e Pejgamberit a.s., në të cilat flitet për vlerën dhe rëndësinë që ka mësimi i Kuranit.

MYFTIU TËRNAVA PARALAJMËROI PADI PËR SHPIFJET NDAJ BIK-UT

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka paralajmëruar padi ndaj shpifësve, të cilët shpifin se BIK-u ka marrë para nga Serbia. Me këtë rast, ai ka sfiduar të gjithë që nëse dikush argumenton një gjë të tillë, personalisht ai do t'i rrënojë këto xhami, mirëpo ka thënë se janë shpifje dhe gënjeshtër të kulluara.



“Nuk ka ndodhë dhe nuk do të ndodhë kurrë që BIK-u të marrë para nga Serbia, prandaj ky njeri do të ndiqet penalisht. E sfidojë atë zotërinë dhe çdokënd tjetër në Kosovë që nëse argumentojnë një gjë të tillë, unë personalisht do t'i rrënojë ato xhami. Mirëpo kjo është shpifje, është çmenduri”, ka thënë Myftiu Tërnavë ndër të tjera.

Deklarata e plotë e Myftiut Tërnavë në lidhje me shpifjet ndaj Bashkësisë Islame të Kosovës:

Ne menduam se sistemi ateist-komunist iku dhe shkoi, mirëpo fatkeqësisht kanë mbetur disa neo-komunist, të cilët gjithherë e kanë primare fyerjen dhe shpifjen në raport me fenë, mirëpo në raport edhe me shqiptarinë tonë. E them me plotë përgjegjësi se nuk ka ndodhë, nuk po ndodhë dhe nuk do të ndodhë kurrë asnjëherë që Bashkësia Islame e Kosovës të marrë para nga Serbia. Por, e sfidojë atë zotërinë atje, e sfidojë dhe i them kështu me përgjegjësi të plotë, nëse ai dhe kushdo qoftë në Kosovë pinjollë të tij, kanë vetëm një argument në lidhje me atë çfarë kanë deklaruar, unë haptazi deklaroj sot se unë do të marrë buldozerin dhe do t'i rrënojë ato dy xhami, edhe tek ajo në ‘Veternik’ edhe kjo këtu në ‘Ma’. Mirëpo, kjo është shpifje, është çmenduri që vije nga një person i papërgjegjshëm.

Elhamdulillah na e kemi shtetin, mirëpo sikur të kemi si duhet shtetin e së drejtës, atëherë ai kishte me përfunduar në Prokurori për të dhënë llogari, për shpifjen që e ka bërë, për gënjeshtër që e ka bërë. Unë i ftoj edhe xhamatët e të dy xhamive të përgatisin në

bashkëpunim me avokatët që vinë nga këto dy xhami lëndën, ta çojmë në Prokurori dhe të ndjekin penalisht këtë njeri, këtë gjë do ta bëjë edhe vetë Bashkësia Islame e Kosovës, që ai të japë përgjegjësi para organeve tona, për shpifje për rrena të kulluara që i drejtohen Bashkësinë Islame të Kosovës.

Duhet të pasur në hatër të gjithë që Bashkësia Islame e Kosovës është e shëndoshë, nuk ka virus brenda saj, qëndron eprore si çdoherë para qytetarëve si një Bashkësi Islame që është e organizuar jashtëzakonisht mirë, është stoike, është e pathyeshme në raport me kontributin që ka dhënë, që jep dhe që do të japë për mirëqenien e popullit tonë. Në veçanti për kontributin e Bashkësisë Islame të Kosovës për çlirimin e vendit dhe pavarësinë e vendit tonë, kur dihet që qëllimi final i Serbisë ishte të shkatërronte çdo gjë që ishte islame. Si institucion kemi pësuar më së shumti kur na është rrënuar infrastruktura e Bashkësisë Islame mbi 218 xhami, selia e Bashkësisë Islame, arkiva 600-vjeçare dhe shumë objekte përcjellëse duke përfshirë edhe shtëpi të imamëve. Sigurisht që kanë rënë shëhidë për mos të vdekur kurrë 37 imamë, të cilët kanë ujitur këtë tokë me gjakun e tyre për të pasur një mirëqenie të mirë të popullit tonë dhe të mos kemi këso mbeturina që me deklarata të tilla të mundohen të hedhin baltë mbi pastërtinë shpirtërore, morale e kombëtare që ka pasur dhe do të ketë në vazhdimësi kombi ynë dhe në veçanti Bashkësia Islame e Kosovës.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYETARIN E KËSHILLIT TË BI-SË SË LUGINË SË PRESHEVËS, NEXHMEDIN ADEMIN



Më 2 korrik 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim kryetarin e Këshillit të Bashkësisë Islame në Luginë të Preshevës, Nexhmedin Ademi.

Gjatë këtij takimi u diskutua për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit dhe rezultatet nga bashkëpunimi i deritanishëm, që po rezultojnë të jenë tejet të frytshme. Këshilli i Bashkësisë Islame në Luginë të Preshevës që funksionon në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës së fundmi është bërë me objekt punues, duke i mundësuar të shtrijë aktivitetet fetare në këtë pjesë.

Për këtë çështje, me kërkesë të Myftiu Tërnavë, Bashkësia Islame e Kosovës, ka kërkuar fonde për t’iu ndihmuar në blerjen e këtij vakëfi, për çka u realizua me sukses.

“Ne para pak kohe, kemi pas një aksion dhe kemi kërkuar prej besimtarëve tonë që të ndihmojnë Këshillin e Preshevës atje për të siguruar një infrastrukturë, e cila do të jetë në shërbim të vëllezërve dhe motrave tona atje. Dëshirojë të falënderojë besimtarët tanë që kanë tubuar 118 mijë euro për të ndihmuar me sigurimin e këtij objekti”, tha Myftiu Tërnavë.

Kryetari i KBI-së në Luginë të Preshevës, Nexhmedin Ademi, falënderoi

Bashkësinë Islame të Kosovës, që siç e quajti ai është ruajtësi më i madh i identitetit fetar dhe kombëtar në atë pjesë.

“Nuk është hera e parë, por çdoherë keni qenë dhe po vazhdoni të jeni në shërbim të besimtarëve të Preshevës”, tha ai.

Muaj më parë, Bashkësia Islame e Kosovës dhe besimtarët myslimanë kanë mbështetur iniciativën për sigurimin e një objekti punues për Këshillin e Bashkësisë Islame në Preshevë. Tashmë, ky objekt është në posedim të këtij Këshilli dhe do të jetë në shërbim të besimtarëve atje.

MYFTIU TËRNAVA VIZITOI KËSHILLIN E BI-SË SË MITROVICËS

Më 3 korrik 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, vizitoi Këshillin e Bashkësisë Islame të Mitrovicës, në të cilin takoi administratën dhe anëtarët e këtij Këshilli.

Kryetari i Këshillit, Ekrem ef. Avdiu, shfrytëzoi rastin që ta njoh Myftiun Tërnavë me punët dhe angazhimet e Këshillit, duke shprehur kështu falënderimet e tij për përkrahjen e vazhdueshme të Myftiut Tërnavë dhe të Kryesisë për projektet e Këshillit.

Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë, i falënderoi anëtarët e Këshillit dhe nëpërmes tyre tërë imamët për mundin



dhe angazhimin e tyre, e më pas kërkoi nga ta që ta shtojnë angazhimin e tyre në shërbim të besimtarëve tanë, duke

ua kujtuar atyre se një gjë të tillë e kemi amanet nga i Madhi Zot.

MYFTIU TËRNAVA VIZITOI SHKOLLËN VERORE “SYNO DHE NGRIHU” NË MITROVICË

Më 3 korrik 2024, gjatë vizitës së tij në Mitrovicë, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar edhe nga bashkëpunëtorët e tij, vizitoi shkollën verore “Syno dhe ngrihu”, e cila është organizuar nga Departamenti i Gruas dhe Departamenti i të Rinjve.

Myftiu Tërnavë përgëzoi mualimet për punën e tyre në edukimin e nxënësve, si dhe inkurajoi nxënësit që të mësojnë edhe më shumë, duke ua kujtuar vlerën dhe rëndësinë që ka mësimi në fenë islame.

Përveç mësimet të rregullt, gjatë këtij kursi veror do të mbahen edhe ligjërata



me tema të ndryshme, siç janë: “Qasja me të tjerët”, “Familja, prehe dhe qetësi”, “Zgjedhja e shoqërisë”, “Qasja me të tjerët”, etj..

MYFTIU TËRNAVA VIZITOI KËSHILLIN E BI-SË SË SKENDERAJT

Më 3 korrik 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, vizitoi Këshillin e BI-së së Skenderajt, në të cilin takoi administratën dhe anëtarët e Këshillit.

Myftiu Tërnavë, falënderoi anëtarët e Këshillit dhe nëpërmes tyre tërë imamët për punën dhe angazhimin e tyre në mbarëvajtjen e jetës fetare në Skenderaj. Ai ofroi përkrahjen e plotë të Kryesisë së BIK-ut për projektet dhe iniciativat që janë në dobi të besimtarëve.



MYFTIU TËRNAVA VIZITOI KËSHILLIN E BI-SË SË DRENASIT



Më 3 korrik 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, me bashkëpunëtorë, vizitoi KBI-në e Drenasit, në të cilin u prit nga kryetari Valon ef. Bequku, administrata dhe anëtarët e këtij Këshilli.

Myftiu Tërnavë, pasi u njoh me punët dhe aktivitetet e Këshillit, shfrytëzoi rastin që t'i përgëzoi imamët dhe anëtarët e Këshillit për kontributin e tyre dhënë për mbarëvajtjen e jetës fetare. Ai tha se Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, mbetet e përkushtuar që të jetë pranë kërkesave të Këshillit të Drenasit për përmirësimin e kushteve infrastrukturore.

MYFTIU TËRNAVA VIZITOI NXËNËSIT E AKADEMISË SË KURANIT “HIFDH KIDS”

Më 4 korrik 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, vizitoi nxënësit e Akademisë së Kuranit “Hifdh Kids”.



Hafëzet, Rineta dhe Fatime Nitaj, së bashku me një grup prej 75 nxënësish e mirëpritën Myftiun Tërnavë, me të cilin biseduan për tema të ndryshme, duke i parashtruar kështu pyetje të shumta lidhur me Kuranin, xhamitë, atdheun dhe fenë e bukur islame.

Myftiu Tërnavë përgëzoi hafëzet për punën e tyre madhore me fëmijë, ndërsa fëmijët i porositi që ta vazhdojnë rrugëtimin e tyre të artë që kanë nisur, atë të mësimin përmendsh të Kuranit fisnik. Ai i këshilloi fëmijët që t'i respektojnë prindërit, mësuesit dhe mbarë shoqërinë, të mësojnë e të arrijnë në jetë, ta duan kombin, në mënyrë që nesër t'i shërbejnë atij në çdo profesion që ata zgjedhin.

Në fund, ai premtoi përkrahjen e vazhdueshme për këtë Akademi, në mënyrë që kjo të avancojë edhe më shumë.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYETARIN E KOMUNËS SË OSMANGAZIT TË BURSËS

Myftiu Tërnavë priti në takim kryetarin e Komunës së Osmangazit të Bursës

Më 5 korrik 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim kryetarin e Komunës së Osmangazit të Bursës, z. Erkan Aydin.

Gjatë këtij takimi u diskutua për ndihmat dhe përkrahjen e vazhdueshme që ka dhënë shteti i Turqisë për Kosovën në përgjithësi, por edhe për Bashkësinë Islame të Kosovës në veçanti. Ai shfrytëzoi rastin që të shprehë falënderimet e tij dhe të institucionit që ai drejton për këtë përkrahje. Myftiu Tërnavë tha se Bashkësia Islame e Kosovës mbetet e përkushtuar që të vazhdojë bashkëpunimin me organizatat turke, gjithnjë për të mirën e qytetarëve dhe besimtarëve tanë.



KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS MBAJTI MBLEDHJEN E RREGULLT



Më 18 korrik 2024, me pjesëmarrjen e anëtarëve të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, u mbajt mbledhja e rregullt e kësaj Kryesie, të cilën e hapi dhe e kryesoi kryetari i saj, Myftiu Naim ef. Tërnavë.

Myftiu Tërnavë fillimisht falënderoi anëtarët e Kryesisë për punën dhe angazhimin e tyre të dhënë për mbarëvajtjen e jetës fetare në vend, e më pas kërkoi nga ta që ky angazhim të shtohet edhe më tej.

Kryesia gjatë kësaj mbledhje diskutoi për raportin e Haxhit – 2024 dhe të Kurbanit – 2024, e të cilat pas diskutimeve dhe analizave të tyre nga personat përgjegjës, i miratoi me vota unanime.

Myftiu Tërnavë me këtë rast i vlerësoi si tejet të suksesshme organizimin e haxhit dhe të kurbanit.

U PËRURUA XHAMIA “PIRINAZ” NË PRISHTINË

Më 25 korrik 2024, me pjesëmarrjen e kryetarit të Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiut Naim ef. Tërnavë, ministrit të Kulturës dhe Turizmit të Turqisë, z. Mehmet Nuri Ersoy, kryetarit të DIJANET-it të Turqisë, dr. Ali Erbash, drejtorit të Përgjithshëm të Vakëfeve të Turqisë, z. Sinan Aksu dhe një numri të besimtarëve, në Prishtinë u bë përrurimi i xhamisë “Pirinaz”, e cila së fundmi është restauruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfeve të Turqisë.

Duanë me rastin e përrurimit të kësaj xhamie e bëri kryetari i DIJANET-it, dr. Ali Erbash.



Gjatë kësaj dite, Myftiu Tërnavë së bashku me delegacionin e lartë nga Turqia, vizituan edhe xhaminë

“Alaudin” në Prishtinë, e cila është restauruar nga po e njëjta Drejtori.

U PËRURUA XHAMIA “MAHMUT PASHA” NË GJAKOVË



Më 25 korrik 2024, me këndim të Kuranit fisnik, filloi ceremonia e përrurimit të xhamisë “Mahmut Pasha” në Gjakovë. Në këtë ceremoni, përveç një numri të besimtarëve, morën pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, me bashkëpunëtorë, ministri i Kulturës dhe Turizmit të Turqisë, z. Mehmet Nuri Ersoy, kryetari i DIJANET-it të Turqisë, dr. Ali Erbash, kryetari i Komunës së Gjakovës, z. Ardian Gjinit, drejtori i Përgjithshëm i Vakëfeve të Turqisë, z. Sinan Aksu, si dhe ambasadori i Turqisë në Kosovës, z. Tunç Angili.

Në fjalën e tij para të pranishmëve, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë,

vlërësoi lart bashkëpunimin e Bashkësisë Islame të Kosovës me DIJANET-in e Turqisë në ruajtjen e trashëgimisë kulturore islame në Kosovë. Ai tha se vendi ynë fatkeqësisht mbeti nën mëshirën e atyre që nuk kishin mëshirë dhe këtu pësuan edhe xhamitë. Por, i Madhi Zot, ka bërë nasib që këto xhami të jenë këtu dhe falë ndihmës së miqve tanë t'i rregullojmë dhe t'i forcojmë ndoshta edhe më shumë seç kanë qenë.

Në fjalën e tij para të pranishmëve, ministri Mehmet Nuri Ersoy, tha se po ndjehet tejet krenar me punën që është bërë në ruajtjen e trashëgimisë kulturore në Kosovë. Ai tha se Kosova është vend

i rëndësishëm dhe historia e saj është shumë e lashtë. “Kosova për ne është një vend shumë i rëndësishëm. Çdo punë që bëhet së bashku është një hap drejt unitetit dhe prosperitetit, andaj edhe ne jemi krenarë me çdo sukses të vëllezërve tanë kosovarë, – potencoi ndër të tjera ministri Ersoy.

Kryetari i Komunës së Gjakovës, z. Ardian Gjini, falënderoi për këtë mbështetje të pastër, me të cilën sipas tij, përfiton Gjakova dhe trashëgimia e saj.

Gjatë vizitës në Gjakovë, delegacioni turk vizitoi edhe Medresenë e Gjakovës.

DELEGACIONI NGA TURQIA SË BASHKU ME MYFTIUN TËRNAVA VIZITUAN XHAMINË QENDRORE

Më 25 korrik 2024, delegacioni nga Turqia në përbërje të ministrit të Kulturës dhe Turizmit, z. Mehmet Nuri Ersoy, kryetarit të DIJANET-it të Turqisë, dr. Ali Erbash, drejtorit të Përgjithshëm të Vakëfeve, z. Sinan Aksu, të shoqëruar nga Myftiu Naim ef. Tërnavë dhe bashkëpunëtorët e tij, vizituan Xhaminë Qendrore në Prishtinë, e cila është duke u ndërtuar nga shteti i Turqisë.

Gjatë kësaj vizite, delegacioni u njoh për së afërmi me punët e kryera deri më tani në ndërtimin e kësaj xhamie, e për të cilat u shprehën të kënaqur.



KONFERENCA E NËNTË BOTËRORE E FETVASË “FETVAJA DHE NDËRTIMI MORAL NË NJË BOTË PËRSHPEJTUESE”

Më 29 korrik 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga shefi i kabinetit të tij, Besim ef. Mehmeti, mori pjesë në Konferencën e Nëntë Botërore të Fetvasë “Fetvaja dhe ndërtimi moral në një botë përshpejtuese”, e cila po mbahet në Kajro dhe është organizuar nga Sekretariati i Përgjithshëm i Myftinive në Botë.

Në këtë Konferencë, të mbajtur nën patronatin e presidentit të Egjiptit, Abdulfetah es Sisi, po marrin pjesë dijetarët, myfti dhe ministra nga më shumë se 104 shtete.

Konferenca u hap nga myftiu i Egjiptit, dr. Shevki Allam, i cili, vuri theksin e veçantë në rëndësinë e kësaj konference, duke marrë parasysh sfidat dhe vështirësitë me të cilat po ballafaqohet bota në fushën e moralit në të gjitha sferat e jetës, e kjo si rezultat i përshpejtimit të jetesës dhe zhvillimeve globale.

Në emër të kryeministrit të Egjiptit, Mustafa Medbulit, të pranishmit i përshëndeti ministri i Vakëfëve të Egjiptit, dr. Usama el Ezheri, i cili theksoi se institucionet e Egjiptit në të gjitha sferat në përgjithësi, e në veçanti institucionet fetare, qëndrojnë të bashkuara dhe të unifikuara pas institucionit më të lartë fetar në Egjipt, atij të Azharit dhe



kryetarit të saj shejhut, dr. Ahmed Tajjib, si përfaqësuesi i të gjithë myslimanëve të Egjiptit në botë.

Gjatë fjalimit të tij, ai, në emër të të gjitha institucioneve fetare islame të Egjiptit, dënoi përleshjen dhe nënçmimin e profetit Isa a.s., gjatë hapjes së Lojërave Olimpikë në Paris, duke theksuar se çfarëdo përleshje dhe nënçmim i vlerave fetare kishtarë dhe përleshja e cildo profet është i ndaluar dhe i dënuar nga pjesëtarët e besimit islam, para atyre të krishterë.

Gjatë këtyre dy ditëve në vijim, Konferenca do të fokusohet në tri akse kryesore: “Ndërtimi moral në Islam dhe roli i fetavës në forcimin e tij”; “Fetvaja dhe realiteti global, idetë dhe

parimet” dhe “Fetvaja dhe përballja me pengesat dhe sfidat e ndërtimit moral për një botë në përshpejtim”.

Përveç këtyre, aktivitetet e Konferencës, do të përfshijnë edhe mbajtjen e tri punëtorive me titujt: “Drejt formulimit të një karte etike të fetvasë për zhvillimet në fushat e shkencave eksperimentale, natyrore dhe shoqërore”; “Intelegjenca artificiale dhe aplikimet e saj në shkencat e Sheriatit në përgjithësi dhe shkencat e fetvasë në veçanti” dhe “Monitorimi dhe analiza e problemeve të përmbajtjes fetare dhe fetvasë në platformat digjitale dhe mjetet e inteligjencës artificiale”.

KRYEIMAMI SAHITI PRITI NË TAKIM DREJTORIN E KIPRED-IT, Z. LULZIM PECIN

Më 30 korrik 2024, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, ka prituri në takim përfaqësuesit e shoqërisë civile të iniciativës “Karvani Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë”, në krye me drejtorin ekzekutiv të KIPRED-it, z. Lulzim Pecin.

Kryeimami Sahiti fillimisht iu uroi mirëseardhje mysafirëve, e më pas i njohu ata me përkushtimin e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës për promovimin e paqes, mirëkuptimit dhe bashkëjetesës së ndërsjellë ndërmjet komuniteteve të ndryshme etnike dhe fetare në Kosovë. Ai tha se ne mbesim të gatshëm për të kontribuar në këtë drejtim, duke ndarë kështu përvojat tona në marrëdhëniet ndëretnike dhe ndëretare për ndërtimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe më harmonike.

Nga ana e tij, z. Peci, falënderoi kryeimamin Sahiti për përkrahjen e



tij, duke thënë se mbështetja e këtij projekti nga ana e Bashkësisë Islame të Kosovës, i jep peshë edhe më të madhe misionit të tyre, duke shprehur kështu gatishmërinë e tyre që të vazhdojnë bashkëpunimin për të arritur vizionin e përbashkët, që Kosova të përjetohet si një shtëpi e çdo qytetari që jeton në këtë vend.

Iniciativa “Karvani Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë”, ka për qëllim që të nxisë dialogun, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve të ndryshme etnike dhe fetare, si dhe të kontribuojë në forcimin e bashkëjetesës ndëretnike në Kosovë.

U MBAJT TAKIMI ME BASHKATDHETARËT TANË

Më 31 korrik 2024, Drejtoria e Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, organizoi pritjen për bashkatdhetarët tanë, që jetojnë dhe veprojnë në mërgatë. Ky takim, tashmë tradicional, u mbajt në Medresenë “Alauddin” në Prishtinë dhe në të morën pjesë përfaqësues të xhamive dhe besimtarë të shumtë nga diaspora.

Takimet e tilla shërbejnë për shkëmbimin e përvojave dhe bashkëpunimit

fetar ndërmjet vendeve ku jeton mërgata jonë.

Drejtori i Diasporës në Kryesinë e BIK-ut, Ekrem ef. Simnica, tha se roli i imamëve në diasporë është i jashtëzakonshëm. Ai tha se përmes tyre po edukohen në frymën islame të rinjtë e shumë të që jetojnë atje.

Një fjalë përshëndetëse para të pranishmëve, në emër të Myftiut Tërnavë, e mbajti sekretari i përgjith-

shëm i Kryesisë së BIK-ut, Ahmet ef. Sadriu, i cili çmoi lart kontributin e bashkatdhetarëve tanë ndaj atdheut në përgjithësi, por edhe ndaj institucionit të Bashkësisë Islame në veçanti.

Këtë takim e përshëndetën edhe përfaqësuesit e qendrave dhe unioneve në diasporë si: Vahidin Behluli nga Austria, Mehas Alija në Zvicra, Musa Mulaj nga Belgjika etj.



PËRFUNDOI AKSIONI I SHPËRNDARJES SË MISHIT TË KURBANIT

Më 10 korrik 2024, në depot e Shoqatës Humanitare Bamirëse “Bereqeti”, arriti edhe kontingjenti i fundit me mish kurbani, i therur nga Bashkësia Islame e Kosovës. Rreth 20 mijë kurbane janë therur dhe janë shpërndarë nga Bashkësia Islame e Kosovës, apo thënë më ndryshe 240 ton mish kurbani është bilanci përfundimtar nga therja e organizuar e kurbaneve.

Mishi i kurbanit ka mbërritur në Kosovë dhe është shpërndarë te secila kategori e shoqërisë, duke filluar nga jetimët, rastet sociale, invalidët e luftës, si dhe kategori të ndryshme të shoqërisë.

Më 3 korrik 2024, janë dhuruar afër 60 ton mish kurbani në Mitrovicë, Ferizaj, Gjilan, Kaçanik dhe Han të Elezit.

Më 6 korrik 2024, 20 ton mish nga kontingjenti i radhës janë shpërndarë në komunitet Pejë, Klinë, Viti dhe Kamenicë.

Më 8 korrik 2024, 40 mijë kilogram mish kurbani u shpërndanë te kategori të ndryshme në Skenderaj, Drenas, Lipjan, Shtime, Rahovec, Malishevë, Suharekë, Fushë Kosovë dhe Obiliq.

Më 9 korrik 2024, Prishtina, Gjakova, Deçani dhe Istogu ishin katër komunitet e radhës, të cilat përfituan mishin e kurbanit.

Përfituesit u shprehën tejet falënderues ndaj besimtarëve dhe “Bereqetit”. Ky mish, përveç te qytetarët nevojtarë, u shpërnda edhe te organizatat e ndryshme, siç janë Hendikos, Organizata e Veteranëve të Luftës, familjet e dëshmorëve etj.

Ndërsa kontingjenti i fundit me mish kurbani, u shpërnda në Podujevë, Gorë, një pjesë e vogël për Junik dhe në Medresenë e Prizrenit.

Kjo dhuratë me mish kurbani është shpërndarë në çdo pjesë të Kosovës. Një pjesë tejet e vogël është dhuruar edhe për Medresenë “Alauddin” në Prishtinë me paralelet e saj në Gjilan dhe Prizren. Me anë të këtij mishi kurbani furnizohen me mish edhe dy gjellëtoret humanitare të “Bereqetit” në Pejë dhe Mitrovicë, të cilat përgatisin çdo ditë ushqim për afër 500 persona.

Ky mish i kurbanit po ashtu shfrytëzohet për organizime të ndryshme fetare dhe kombëtare, ku veç të tjerash përgatiten edhe iftare përgjatë muajit Ramazan dhe organizime të tjera.

Nga mishi i kurbanit që besimtarët myslimanë nga Kosova dhe diaspora i janë bashkuar organizimit të Bashkësisë Islame të Kosovës është shpërndarë në çdo cep të Kosovës, pa lënë anash asnjë qytet dhe asnjë fshat në Kosovë.

I gjithë procesi i therjeve të kurbaneve është monitoruar nga Komisioni i Bashkësisë Islame të Kosovës, ku përveç saj është monitoruar edhe nga certifikuesit “Hallall” të thertores.



MOMENTE NGA PËRURIMI I XHAMISË “PIRINAZ” NË PRISHTINË



MOMENTE NGA PËRURIMI I XHAMISË “MAHMUT PASHA” NË GJAKOVË



DITURIA ISLAME • Nr. 405 GUSHT 2024